



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 183

Tiranë – E enjte, 9 tetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 6, datë 2.10.2025	Për delegimin e kompetencave për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Mjedisit, si dhe disa rregulla mbi përfaqësimin ligjor.....	22631
Vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2024-5505 (210), datë 14.5.2024	Me objekt shfuqizimin e plotë të akteve administrative të marrjes së tokës në pronësi për Telha Loçka dhe kthimin e tokës prej 4800 m ² në emër të pronarit shtet.....	22632
Vendim i Bordit të Mbikëqyrjes Publike nr. 43, datë 30.9.2025	Për miratimin e rregullores “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”.....	22658
Vendim i Bordit të Mbikëqyrjes Publike nr. 44, datë 30.9.2025	Për miratimin e rregullores “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë së audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit”.	22673
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 57, datë 1.10.2025	Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin e pjesëmarrjes influcuese (të tërthortë) në kapitalin aksionar të “Bankës Amerikane të Investimeve” sh.a.....	22699
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Zenel Mustafaraj.....	22699

**URDHËR****Nr. 6, datë 2.10.2025****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
PËR PËRFAQËSIMIN LIGJOR TË
MINISTRISË SË MJEDISIT, SI DHE
DISA RREGULLA MBI PËRFAQËSIMIN
LIGJOR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave Sekretarit të Përgjithshëm, për lëshimin e autorizimeve për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Mjedisit në proceset gjyqësore në të cilat është palë në gjykim.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Mjedisit, kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat objekti i padisë ka lidhje me institucionin e varësisë, lëshohen në emër të nëpunësit të institucionit të varësisë, që do të përfaqësojnë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit të varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadia.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristë dhe, sipas rastit, në bashkëpunim me strukturat teknike, si dhe përfaqësues nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Mjedisit, nëpërmjet autorizimit përkatës.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Mjedisit në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, u jep të drejtë përfaqësuesve të autorizuar të kryejnë çdo veprim

procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

6. Përfaqësuesit e caktuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon pjesëmarrjes së tyre e, veçanërisht, kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e interesave të institucionit të Ministrisë së Mjedisit.

7. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Mjedisit të caktojnë një person përgjegjës si pikë kontakti, për të shkëmbyer çdo informacion të nevojshëm, si dhe njoftim për ecurinë e ndjekjen e proceseve gjyqësore, në Ministrinë e Mjedisit.

8. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Arkiv-Protokollit për vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme, me qëllim paraqitjen e tyre konform ligjit, në cilësinë e provave materiale për proceset gjyqësore.

9. Ky urdhër nuk cenon vlefshmërinë e autorizimeve të lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për proceset gjyqësore në të cilat ky institucion ka qenë palë dhe që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Urdhri i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 258, datë 17.11.2021, “Për delegimin e kompetencave përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe disa rregulla mbi përfaqësimin ligjor”, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Sektori i Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Arkiv-Protokollit, institucionet e varësisë së Ministrisë së Mjedisit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj**



Lidhja nr. 1

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/INSTITUCIONI I VARËSISË)

Nr..... prot.

Tiranë, më _____.____.

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN GJYQËSORE ME PALË:

Paditës:

E paditur: ...

Objekti: ...

Në mbështetje të neneve 64–77 të Kodit Civil; të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile; të nenit 14, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar; dhe të urdhrit të ministrit të Mjedisit nr. ..., datë ..., “Për delegimin e kompetencave për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Mjedisit, si dhe disa rregulla mbi përfaqësimin ligjor”,

VENDOSA:

Autorizimin e ... dhe/ose..., për të përfaqësuar Ministrinë e Mjedisit, së bashku ose veç e veç, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, në të gjitha seancat gjyqësore të procesit me nr. ... akti, pranë Gjykatës...

Përfaqësuesi ka të drejtë të përgatitë, nënshkruajë e depozitojë të gjitha aktet e nevojshme procedurale para gjykatës, në përputhje me ligjin dhe në interesin e ligjshëm të palës, Ministria e Mjedisit, të cilën përfaqëson, deri në marrjen e formës së prerë të vendimit.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT TE VARËSISË)

VENDIM**Nr. 00-2024-5505 (210), datë 14.5.2024****NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol Sadushi	kryesues;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Enkelejda Metaliaj (Softa)	anëtare;
Gentian Medja	anëtar,

më datë 14.5.2024, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen administrative nr. 31001-01635-00-2016 akti, që u përket palëve:

PADITËS: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë (*Prefekti i Qarkut Tiranë*)

I PADITUR: Telha Loçka

PERSON I TRETË: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë (*ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë*)

Faqe | 22632

Shoqëria “Coca-Cola Bottling” sh.p.k.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes

OBJEKTI: Shfuqizimin e plotë të akteve administrative të marrjes së tokës në pronësi për Telha Loçka dhe kthimin e tokës prej 4800 m² në emër të pronarit shtet.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, ndryshuar me ligjin 58/2012, “Kodi i Procedurës Administrative”, ligji nr. 33/2013, datë 21.3.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS
SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Gentian Medja, dëgjoi pretendimet e palës paditëse rekursuese përfaqësuar nga avokati Hekuran Skuqi, që kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të



Apelit dhe pushimin e gjykimit; dëgjoi pretendimet e Avokaturës së Shtetit, përfaqësuar nga avokat Abaz Deda, që kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pranimin e plotë të padisë; dëgjoi pretendimet e personit të tretë shoqëria “Coca-Cola Bottling” përfaqësuar nga avokat Gerhard Velaj, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në datën 9.9.2013, Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, në mbështetje të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe të VKM-së nr. 1269, datë 17.9.2008, mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k., me nr. 1291 prot., datë 18.11.2009.

2. Referuar kërkesës së mësipërme, shoqëria “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k. ka kërkuar fillimin e procedurave për vlerësimin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore për AMTP-në pa numër, datë 20.4.1993, të lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, i fshatit Yrshek, Tiranë, në favor të familjes së shtetasit Telha Mersin Loçka, duke pretenduar se toka e trajtuar me këtë akt në favor të familjes Loçka, është ndarë në kundërshtim me ligjin, pasi sipërfaqja prej 2800 m² ka mbivendosje me pronën e saj, ku kjo e fundit ushtron aktivitetin.

3. Shoqëria “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në bazë të kontratës për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët (*Joint Venture*) të datës 23.4.1993, të lidhur ndërmjet dy investitorëve të huaj (shoqëria amerikane CCEC dhe shoqërisë italiane A.C.I.E.) dhe shoqërisë shqiptare me kapital shtetëror, Invest PF.

4. Shoqëria Invest PF është themeluar në bazë të urdhrit nr. 88, datë 26.8.1992, të ministrit të Bujqësisë, me kapital tërësisht shtetëror. Qëllimi i krijimit të shoqërisë Invest PF është pjesëmarrja me dy shoqëritë e huaja të përmendura më lart në shoqërinë CCBS. Në bazë të kontratës së datës 23.4.1993 dhe vendimit nr. 257, datë 22.6.1992, të Këshillit të Ministrave, shteti shqiptar, nëpërmjet shoqërisë Invest PF, i ka dhënë CCBS-së, në formën

e kontributit në natyrë, të drejtën e përdorimit të një sipërfaqeje toke prej 48.000 m², për një afat prej 99 vjetësh. Kjo tokë do të përdorej nga CCBS për ndërtimin e fabrikës së prodhimit dhe ambalazhimit të pijeve freskuese joalkoolike.

5. Me procesverbalin e datës 8.4.1992, nga komisioni përkatës i përbërë nga përfaqësues të investitorit dhe zyrës së kadastrës, urbanistikës, seksionit të bujqësisë etj., është përcaktuar si shesh ndërtimi i objekti të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese Coca-Cola, sipërfaqja e tokës “arë” prej 5 ha, në përdorim të N.B “17 Nëntori”.

6. Me vendimin nr. 455, datë 29.10.1992, të Këshillit të Ministrave, është miratuar sheshi i ndërtimit të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese Coca-Cola me sipërfaqe 4.8 ha, ndërsa në datë 17.3.1993, nga Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë Këshillit të Rrethit është miratuar leja e ndërtimit nr. 2-1. Përfundimisht, objekti është regjistruar në ZVRPP, në ZK 2679, Mëzes, vol. 14, faqe 122, me nr. pasurie 14/30, me sipërfaqe 14.500 m². Me regjistrimin në ZVRPP, shoqëria “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k. është vënë në dijeni se në sipërfaqen e tokës prej 5 ha, të cilën e ka në përdorim, ishin regjistruar disa tituj pronësie në emër të disa subjekteve lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Yrshek, Komuna Kashar.

7. Familja bujqësore e z. Telha Loçka, duke qenë një familje bujqësore, që ka dorëzuar tokë për krijimin e ish-ndërmarrjes bujqësore, në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, dhe të VKM-së nr. 452, datë 17.10.1992, “Për rristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, ka përfutur sipërfaqen 2800 m² të llojit tokë “arë”, me nr. ngastre 14/13, të ndodhur në fshatin Yrshek, si dhe sipërfaqen 2000 m² e llojit tokë “arë”, me nr. ngastre 12/2. Me qëllim trajtimit të kësaj toke janë lëshuar, përkatësisht, akti i marrjes së tokës në pronësi nr. s’ka, datë 20.4.1993, dhe akti i marrjes së tokës në pronësi nr. 422, datë 20.4.1993. Këto pasuri janë regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Nga certifikata për vërtetim pronësie rezulton se sipërfaqja e tokës e llojit “arë” prej 2800 m² është regjistruar me numër pasurie 14/13, ndodhet në fshatin Mëzez, Tiranë, zona kadastrale nr. 2679. Sipas vërtetimit të datës 20.3.1993, Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit Yrshek ka vërtetuar se ky komision i ka ndarë familjes Loçka dhe të paditurit Telha Loçka parcelën nr. 14, e cila ndodhet në



sektorin Mëzes të ish-N.B “17 Nëntori”. Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Komunës Kashar ka sqaruar se sipërfaqja e tokës, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi në favor të palës së paditur, ndodhet në sektorin Mëzes të ish-NB “17 Nëntori”.

8. Siç u përmend më sipër, mbi bazën e kërkesës së shoqërisë “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k., Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë ka shqyrtuar vlefshmërinë ligjore të akteve të marrjes së tokës në pronësi, datë 20.4.1993, për sipërfaqen 2800 m² dhe 2000 m², në emër të z. Telha Loçka.

9. Me vendimin nr. 58, datë 9.9.2013, ky komision ka vendosur shfuqizimin e plotë të aktit të marrjes së tokës në pronësi të familjes bujqësore të përfaqësuar nga z. Telha Loçka dhe kthimin në pronësi të shtetit të tokës me sipërfaqe 4800 m² sipas AMTP-së.

10. Në datë 16.9.2013, pala paditëse prefekti i Qarkut Tiranë i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 402, datë 20.1.2014, ka shpallur moskompetencën lëndore të saj dhe dërgimin e akteve për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

11. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2267, datë 12.5.2014, ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Shfuqizimin pjesërisht të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. s’ka, datë 20.4.1993, dhe akti i marrjes së tokës në pronësi nr. 422, datë 20.4.1993, në emër të të paditurit Telha Mersin Loçka dhe kthimin e pasurisë së llojit tokë arë, me sipërfaqe 2800 m² me nr. pasurie 14/13, vol. 4, faqe 177, e ndodhur në Mëzes, Tiranë, në emër të pronarit shtet. Rrëzimin e kërimit për sa i përket shfuqizimit të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. s’ka, datë 20.4.1993, dhe akti i marrjes së tokës në pronësi nr. 422, datë 20.4.1993, në emër të të paditurit Telha Mersin Loçka dhe kthimin e pasurisë së llojit tokës arë, me sipërfaqe 2000 m² me nr. pasurie 12/2, e ndodhur në Mëzes, Tiranë, në emër të pronarit shtet, si të pabazuar në prova. ...”*

12. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se toka e përfutur nga familja e të paditurit nuk mund të ishte objekt ndarje sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, për shkak se me vendimin nr. 455, datë 29.10.1992, të Këshillit të Ministrave është miratuar sheshi i ndërtimit të fabrikës për prodhimin e pijeve freskuese Coca-

Cola, me sipërfaqe 4.8 ha, pjesë e së cilës është dhe sipërfaqja e tokës së përfutur prej të paditurit, ndërsa më datë 17.3.1993, Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë Këshillit të Rrethit ka miratuar lejen e ndërtimit nr. 2-1. Sipas gjykatës, regjimi juridik i kësaj sipërfaqeje toke, në çastin e ndarjes së saj nga Komisioni i Ndarjes së Tokës, ka qenë tokë “trual”, për shkak se për të ishte miratuar një leje ndërtimi. Në këtë prizëm, Komisioni i Ndarjes së Tokës nuk ka pasur të drejtë për të ndarë një sipërfaqe toke, e cila nuk ka qenë objekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

12.1. Në çështjen objekt gjykimi ka rezultuar se i padituri në çastin e ndarjes së tokës, ka qenë banor i fshatit Yrshek, ndërsa nga vërtetimi i datës 20.3.1993, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit Yrshek rezulton se ky komision u ka ndarë familjes Locka dhe të paditurit Telha Loçka, parcelën nr. 14, e cila ndodhet në sektorin Mëzez të ish-N.B “17 Nëntori”. Nga shkresa nr. 758/1 prot, datë 6.5.2010, e Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Komunës Kashar, rezulton se sipërfaqja e tokës, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi të palës së paditur, ndodhet në sektorin Mëzes të ish-N.B. “17 Nëntori”. Nga certifikata për vërtetim pronësie të lëshuar në emër të të paditurit, rezulton se sipërfaqja e tokës arë me numër pasurie 14/13 ndodhet në fshatin Mëzez. Të gjitha këto prova shkresore, në vlerësim të gjykatës, rrëzojnë prapësimin e palës së paditur, se sipërfaqja e tokës bujqësore ndodhet në fshatin Yrshek. Pala e paditur ka përfutur një sipërfaqe toke arë, duke mos qenë banor i fshatit Mëzez. Në vlerësim të gjykatës, ky përfitim bie ndesh me VKM-në nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, dhe më VKM-në nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”.

12.2. Gjykata ka vlerësuar se duhet vendosur shfuqizimi i AMTP-së, pjesërisht, për sa i përket sipërfaqes prej 2800 m² që ndodhet në parcelën 14/13. Ndërsa për sipërfaqen prej 2000 m² që ndodhet në parcelën me nr. 12/2, Gjykata ka çmuar se nga ana e palës paditëse nuk është paraqitur ndonjë provë që të vërtetojë se kjo parcelë dhe kjo sipërfaqe përfshihet në parcelën nr. 14 që është në përdorim të personit të tretë, shoqërisë “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k. Në këto rrethana, gjykata ka vlerësuar se duhet vendosur që të detyrohet pala e paditurit të kthejë në favor të shtetit sipërfaqen e



tokës arë prej 2800 m², sipas përshkrimit në aktin e marrjes së tokës në pronësi.

12.3. Gjykata e ka gjetur të pabazuar prapësimin e palës së paditur se vendimi nr. 50, datë 9.9.2013, i Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, bie ndesh me vendimin nr. 29, datë 31.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese, pasi ka një vendim gjyqësor të formë së prerë, vendimin nr. 2270, datë 25.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur detyrimi i Këshillit të Rrethit Tiranë të bëjë regjistrimin e sipërfaqes së tokës në regjistrat e pasurisë së paluajtshme në emër të të paditurit. Në vlerësim të gjykatës, nga përmbajtja e vendimit nr. 2270, datë 25.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se objekt gjykimi nuk ka qenë vlefshmëria e titullit të pronësisë por e drejta për regjistrim e kësaj pasurie. Në këtë kuptim, nuk është marrë një vendim gjyqësor i formës së prerë në lidhje me vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e titullit të pronësisë (akti i marrjes së tokës në pronësi).

12.4. Gjykata e ka gjetur të pabazuar prapësimin e palës së paditur se gjatë procedimit administrativ, i cili ka zgjatur për katër vjet, është shkelur e drejta për t'u informuar, për t'u dëgjuar, si dhe parimi i kontradiktoritetit. Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e procedurës prek thelbin e aktit dhe shkakton pafuqinë juridike të tij. Për këtë shkak, legjislatori ka përdorur termin *"shkelje flagrante"*, duke dashur të klasifikojë nën këtë kriter vetëm ato shkelje që cenojnë drejtpërdrejt aktin dhe përbëjnë ves të pakthyeshëm. Nga pala paditëse është paraqitur shkresa nr. 952 prot., datë 15.4.2013, dhe dëftesa e komunikimit postar e nënshkruar nga Telha Loçka, me të cilën njoftohet pala e paditur për procedimin administrativ. Për rrjedhojë, në vlerësim të gjykatës, është respektuar e drejta e informimit. Përveç kësaj, nga ana e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, në vendimin nr. 58, datë 9.9.2013, është bërë përshkrimi i fakteve të pasqyruara në vendimin nr. 2270, datë 25.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sa më sipër, gjykata ka çmuar se palës së paditur i është krijuar mundësia për të parashtruar kundërshtimet e saj, në lidhje me këtë procedim, si dhe provat mbi faktet e konstatuara të veprimtarisë administrative. Gjykata ka vlerësuar se në zbatim të nenit 40, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, pavarësisht shkeljeve procedurale, pasojat juridike do të ishin të njëjta dhe të atilla që

do të sillnin marrjen e vendimit nr. 58, datë 9.9.2013, të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë prefektit të Qarkut Tiranë.

13. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, ka ushtruar ankim pala paditëse, prefekti i Qarkut Tiranë, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të padisë.

14. Ndaj këtij vendimi, më datë 26.5.2014 ka paraqitur ankim pala e paditur Telha Loçka, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e plotë të padisë, duke parashtruar ndër të tjera, se me vendimin nr. 2270, datë 25.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur detyrimi i Këshillit të Rrethit Tiranë të bëjë regjistrimin e sipërfaqes së tokës në regjistrat e pasurisë së paluajtshme në emër të trashëgimtarëve të të ndjerit Myslym Loçka dhe Pëllumb Pëllumbi, në zbatim të të cilit, pala e paditur është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie. Duke qenë se ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, pala paditëse ka shkelur parimin e sigurisë juridike, në referencë të vendimit nr. 29, datë 31.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese. Shteti shqiptar nuk ka qenë pronar i sipërfaqes së tokës mbi të cilën është ngritur godina e shoqërisë "Coca-Cola Bottling Shqipëria" sh.p.k., pasi kjo sipërfaqe toke ka qenë në pronësi të trashëgimtarëve të Myslym Loçkës. Nga pala paditëse janë shkelur nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës si dhe neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Kodi i Procedurave Administrative.

15. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 2363, datë 20.7.2016, ka vendosur: *"Lëni në fuqi të vendimit nr. 2267, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë..."*

16. Gjykata Administrative e Apelit e ka gjetur të pabazuar pretendimin e palës së paditur, se gjatë procedurës administrative nuk është zbatuar parimi i kontradiktoritetit. Pala paditëse rezulton që të ketë respektuar detyrimet ligjore në procedurën administrative të zhvilluar për verifikimin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të palës së paditur. Ajo është njoftuar mbi këtë procedurë dhe i është dhënë mundësia që të parashtrojë pretendimet e saj. Pavarësisht nga ky fakt, në procedurën e verifikimit të titujve të pronësisë, KVTP-ja verifikon dhe konkludon, por është gjykata e cila vendos në lidhje me vlefshmërinë e titullit të pronësisë objekt i verifikimit, mbi bazën e padisë që paraqitet nga prefekti. Në këto rrethana, Gjykata Administrative e



Apelit e ka gjetur këtë pretendim të ngritur në ankim të pabazuar në prova dhe në ligj dhe si të tillë të papranueshëm.

16.1. Gjykata ka gjetur të pabazuar pretendimin e ngritur në ankim se gjatë procedurës administrative nuk janë njoftuar anëtarët e familjes bujqësore dhe se ata nuk përmenden fare në vendimin e Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Në një procedurë të tillë, detyrimi për të njoftuar pjesëtarët e familjes bujqësore është një detyrim i gjykatës, përpara së cilës shtrohet për zgjidhje çështja e vlefshmërisë apo pavlefshmërisë së titullit të pronësisë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka thirrur në gjykim, të gjithë anëtarët e familjes bujqësore e për rrjedhojë ky pretendim rezulton të jetë i pabazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë ai është i papranueshëm. Vendimi i KVTP-së nuk sjell pasojë, në lidhje me pavlefshmërinë e titullit të pronësisë por i jep të drejtën dhe detyrimin prefektit të Qarkut që t'i drejtohet gjykatës me padi për kundërshtimin e AMTP-së.

16.2. Gjykata ka gjetur të pabazuar pretendimin e ngritur nga pala e paditur në lidhje me pavlefshmërinë absolute të vendimit të KVTP-së nr. 50, datë 9.9.2013, bazuar në vendimin nr. 29 datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese, si një pretendim i cili del jashtë kontekstit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 29/2010. Në këto rrethana edhe ky pretendim rezulton të jetë i pabazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë i papranueshëm.

16.3. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar, se, me të drejtë, në përputhje të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke anuluar AMTP-në nr. s’ka, datë 20.4.1993, dhe nr. 422, datë 20.4.1993, në emër të të paditurit Telha Loçka, vetëm për sipërfaqen prej 2800 m² (me nr. pasurie 14/13, vol. 4, faqe 177, e ndodhur në Mëzes, Tiranë, në emër të pronarit shtet), sipërfaqe e cila rezulton se Komisioni i Ndarjes së Tokës e ka disponuar në kundërshtim me ligjin. Ndërsa për sipërfaqen prej 2200 m², e cila sipas AMTP-së ka numër pasurie (parcele) 12/2, kërkesa e paditësit prefekti i Qarkut Tiranë, me të drejtë, është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë si e pabazuar në prova.

17. Kundër vendimit nr. 2363, datë 20.7.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka ushtruar

rekurs, më datë 29.7.2016, pala e paditur Telha Loçka, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e padisë. Në rekurs ka pretenduar ndër të tjera, se:

- Vendimet e rekursuara përmbajnë shkelje procedurale dhe materiale, të cilat kanë ndikuar në keqinterpretimin e fakteve dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta.

- Në themel, çështja fokusohet në probleme të zbatimit të gabuar të ligjit nr. 9948/2008, në bazë të të cilit pala paditëse ka nisur një procedurë hetimore administrative për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore, për krijimin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore në pronësi të familjes bujqësore të z. Telha Loçka.

- Gjykatat ka vlerësuar se shkaku për shfuqizimin e AMTP-së të familjes bujqësore rekursuese, lidhet me mungesën e kompetencës së Komisionit të Ndarjes së Tokës Bujqësore të Fshatit Yrshek, i cili nuk mund të dispononte në lidhje me sipërfaqen e tokës në fshatin Mëzez.

- Komisioni vendor ka proceduar me hetim administrativ të një AMTP-je dhe, për rrjedhojë, disponuar mbi një sipërfaqe toke mbi të cilën pronarë janë anëtarët e familjes bujqësore, konkretisht Telha Loçka, Hava Loçka, Çlirim Loçka dhe Fatjon Loçka (e vërtetuar kjo me certifikatën e përbërjes familjare të vitit 1991). Prefektura ka marrë një vendim për 3 shtetas (Hava Loçka, bashkëshortja e Telha Loçka dhe Çlirim e Fatjon Loçka, fëmijët) që i zhvesh nga e drejta e pronësisë dhe ato nuk përmenden fare në këtë vendim dhe as nuk janë konsideruar ndonjëherë si pjesë e këtij procesi.

- Gjykata nuk mund të vendoste të shpronësonte këta shtetas, pa i thirrur në gjykim dhe pa dëgjuar argumentet e tyre në mungesë të procedimit administrativ. Për të paditurit Hava Loçka, Çlirim Loçka dhe Fatjon Loçka nuk është ezauruar rruga administrative dhe as kanë qenë pjesë e procesit gjyqësor.

- Pala paditëse, në procedimin administrativ, ka shkelur rëndë Kushtetutën e Shqipërisë, KEDNJ-në, KPA-në, KPC-në, parimin e procesit të rregullt ligjor, si parim kushtetues i një rëndësie themelore, si dhe parimin e sigurisë juridike.

- Janë tejkaluar kufijtë e përgjithshëm kohorë të përfundimit të procesit administrativ, parashikuar këto në nenin 49. KPA-ja, duke vazhduar një



procedim për rreth 4 vjet, ndërkohë që ligji e ka parashikuar 3 muaj. Është shkelur rëndë parimi i sigurisë juridike që përmban edhe parimin e sigurisë administrative.

- Gjatë këtij procesi administrativ, që ka zgjatur 4 vjet, është shkelur e drejta për t'u informuar, sepse pala e paditur/rekursuese nuk është informuar se ndaj tij po zhvillohet një proces hetimor administrativ, duke u shkelur neni 56 i KPA-së. Në këtë mënyrë nuk është dëgjuar pala e paditur/rekursuese, në mënyrë që t'i jepej mundësia të mbrohej apo të sillte argument përpara se pala paditëse të merrte vendim përfundimtar, duke shkelur po ashtu edhe parimin e kontradiktoritetit. Gjykata e Apelit, në shqyrtimin e çështjes, e ka anashkalluar këtë pretendim dhe nuk vërteton përmbajtjen e aktit administrativ dhe komunikimin që i është bërë palës së paditur/rekursuese.

- Shoqëria “Coca-Cola” dhe MZHETS-ja, si ortakë e saj, nuk disponojnë asnjë dokumentacion qoftë dhe fillim prove me shkresë, që të justifikojë pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme objekt gjykimi. Ndërkohë, i padituri është një nga pronarët legjitimë të sipërfaqes së tokës, ku zhvillon aktivitetin prodhues e tregtar shoqëria “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k.

- Megjithëse z. Telha Loçka është pronar i ligjshëm i një sipërfaqeje toke prej 2100 m², që prej vitit 1993 (për të cilën gjykatat kanë vendosur t'i kthehet pronarit shtet), ai nuk ka mundur të gëzojë të drejtat e ushtrimit të së drejtës së pronësisë. Kjo pamundësi ka ardhur si pasojë e vendosjes mbi pronën e bashkëpronësisë Loçka të objektit të shoqërisë “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

A. Mbi nysjen e procedurës së gjykimit njëses

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), i përbërë nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, mori në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi më datë 11.5.2023. Pavarësisht se rekursi i palës paditëse është paraqitur më datë 29.7.2016, para ndryshimeve të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në vitin 2021, ai u shqyrtua sipas dispozitave procedurale që janë në fuqi aktualisht, në lidhje me ritin e gjykimit, përbërjen e trupës gjykuese dhe mënyrën e disponimit nga Gjykata e Lartë. Veprimi i ligjit procedural në kohë rregullohet nga dispozita tranzitore e ligjit nr. 49/2021, ku është parashikuar, se: “1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe

procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera; 2. Rekursi e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.”

19. Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GJEDNJ”), në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se njëtrajtshmëria e zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (shih çështjen “Chapman v United Kingdom” vendim i GJEDNJ-së, datë 18.1.2001), duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së.

20. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me përdorueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore nomofilatike (shih çështjen “Lupaș and Others v. Romania”, ap. nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006 XV). Ajo ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të së njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ-ja konkludon se ajo që përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana: *së pari*, nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike; *së dyti*, nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe proceduralë, që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë; *së treti*, nëse këta mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave (shih çështjen “Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë”, kërkesa nr.



11260/10, seksioni i 5-të i GJEDNJ-së, vendim nr. 11.4.2019, paragrafi 40).

21. Kolegji konstaton se në paditë me objekt shfuqizim të aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP), të paraqitura nga prefekti (ASHK), ka pasur qëndrime të ndryshme të trupave të Kolegjit Administrativ lidhur me ndërgjyqësinë pasive dhe llojin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në rast të konstatimit të formimit të parregullt të saj. Natyra e ndërgjyqësisë pasive, në rastet e padive për pavlefshmëri të titujve të pronësisë, duket se ka gjetur hapësirën e precedentit jurisprudencial pranë Kolegjit, ndonëse pa një vendimmarrje njëse por nga ana tjetër, e kundërta ka ndodhur me llojin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në rastet e mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë së detyrueshme, të pakonstatuar nga gjykatat e faktit, në gjykimet e kësaj natyre.

22. Që në vitin 2017, Kolegji ka pranuar ekzistencën e praktikave të ndryshme gjyqësore, në lidhje me formimin e rregullt të ndërgjyqësisë në paditë me objekt deklarimin e pavlefshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga Komisionet e Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë prefektit të Qarkut dhe, me vendim të datës 13.6.2017, ka kaluar çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore. Pavarësisht kësaj vendimmarrjeje, për çështjen konkrete, nuk u arrit një qëndrim i unifikuar, për shkak se pala rekursuese, në seancë gjyqësore, nuk u qëndroi pretendimeve të parashtruara në rekurs (*shih vendimin nr. 00-2023-3142 (128), datë 7.4.2023 i KAGJL-së, palë paditëse Ylli Zeqiri*).

23. Në harkun kohor 2020–2023, që përkon me periudhën e rifunksionalizimit të Gjykatës së Lartë, gjykata ka mbajtur një qëndrim jurisprudencial, sipas të cilit padia kundrejt aktit të marrjes së tokës në pronësi, sikurse çdo padi tjetër kundërdrejtuar titullit të përbashkët të pronësisë së bashkëpronarëve, krijon detyrimisht bashkëndërgjyqësi pasive të detyrueshme, sipas paragrafit të dytë të nenit 162 të KPC-së. Sipas këtij qëndrimi argumentohet se kryetari i familjes ka tagra të zakonshme administrimi dhe përfaqësimi në lidhje me bashkëpronarët e tjerë (*shih vendimet nr. 00-2020-739, datë 27.10.2020, nr. 00-2021-1592, datë 21.10.2021, nr. 00-2022-1667, datë 18.7.2022, nr. 00-2021-1789, datë 15.11.2021, nr. 00-2022-2252, datë 6.10.2022 00-2021-1788, datë 15.11.2021, nr. 00-2022- 2252, datë*

6.10.2022, nr. 00-2023-1439, datë 13.4.2023 të KAGJL-së). Një qëndrim tjetër, i izoluar (*shih vendimin nr. 00-2021-904, datë 27.5.2021, të Kolegjit Administrativ*) pranon se kryetari i familjes ka të drejta të jashtëzakonshme për përfaqësimin e të gjithë bashkëpronarëve në rastet kur paditet nga të tretët, përfshirë padinë për anulimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, sikurse ka edhe mendime të mbetura në pakicë ku mbahet qëndrimi se bashkëndërgjyqësia në familjen bujqësore nuk është e detyrueshme (*shih vendimin nr. 00-2022-2701, datë 17.10.2022, vendimin nr. 00-2023-1439 (138), datë 13.4.2023, të KA-së*).

24. Kolegji konstaton se në çështje të ngjashme me rastin në gjykim ka pasur qëndrime të ndryshme edhe në raport me natyrën e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, në drejtim të mënyrës së zbatimit të nenit 63, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, kur konstatohet mosformim i drejtë i ndërgjyqësisë pasive. Lidhur me këtë çështje, Kolegji nuk ka arritur të ruajë uniformitetin në zbatimin e nenit 63, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, duke prodhuar vendimmarrje të ndryshme mbi mënyrën e zbatimit të ligjit procedural. Në disa qëndrime është vlerësuar se parimi i taksativitetit detyron zbatimin *ad litteram* të kësaj dispozite, duke mos lejuar Kolegjin të disponojë prishjen e dy vendimeve përfundimtare të gjykatave më të ulëta dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për shkak të mosrespektimit të bashkëndërgjyqësisë pasive të detyrueshme (*shih vendimin nr. 00-2022-2701 (357), datë 17.10.2022, i KA-së*). Sipas këtij qëndrimi, argumentohet se në këtë rast, Kolegji mund të disponojë vetëm prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, duke kthyer çështjen për rishqyrtim në këtë gjykatë (*vendimi nr. 00-2017-2704 (823), datë 31.7.2017, i KA-së*). Një qëndrim tjetër i Kolegjit, në mbështetje të parimit të garantimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe në funksion të procesit të rregullt, ka pranuar se neni 63, shkronja “ç”, i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, nuk pengon Kolegjin të kthejë çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë edhe kur bëhet fjalë për vendime përfundimtare të dy gjykatave të faktit, në rastet kur evidentohet mosformim i drejtë i ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme, e cila nuk ka arritur të identifikohet në dy shkallë gjykimi (*shih vendimin nr. 00-2022-2252 (337), datë 6.10.2022 i KA-së*).



25. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 62(a)(2) të ligjit nr. 49/2012, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, më datë 11.5.2023, në dhomë këshillimi, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për njësim pyetjet:

“1. Në paditë administrative me objekt kundërshtimin e ligjshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga prefekti (sot sukseduar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës), a duhet të thirren në cilësinë e të paditurit të gjithë përfituesit e aktit të marrjes së tokës në pronësi, apo mjafton të thirret vetëm kryefamiljari?”

2. Në ato raste kur gjykatat administrative kanë shqyrtuar në themel padinë, e cila paraqitet me bashkëndërgjyqësi pasive të detyrueshme të parregullt, a mundet Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të prishë të dyja vendimet dhe ta kethejë çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë?”

32. Pas zhvillimit të disa seancave gjyqësore, Kolegji vendosi përfundimisht në lidhje me këtë çështje në seancën e datës 14.5.2024.

B. Lidhur me pyetjen e parë

- Në paditë administrative me objekt kundërshtimin e ligjshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga prefekti (sot sukseduar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës), a duhet të thirren në cilësinë e të paditurit të gjithë përfituesit e aktit të marrjes së tokës në pronësi, apo mjafton të thirret vetëm kryefamiljari?

26. Në gjykimin administrativ, në përputhje me nenin 1(2) të ligjit nr. 49/2012, veprojnë rregullat e procesit civil sipas KPC-së, për aq sa ato janë në përputhje me rregullat e parashikuara për këtë natyrë të posaçme gjykimi. Instituti procedural i ndërgjyqësisë është i lidhur me marrëdhënien procedurale të krijuar mes palëve në procesin gjyqësor, duke caktuar pozitën e tyre procedurale në gjykim dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin prej saj. Palët në procesin gjyqësor administrativ gëzojnë të drejta dhe detyrime në raport me gjykatën dhe njëra-tjetrën, në përputhje me pozitën procedurale që gëzojnë në proces. Ndërgjyqësia, si rregull, ndjek parimin e disponibilitetit, duke u paraqitur si origjinale kur ajo krijohet në kohën e ngritjes së padisë, dhe e mëvonshme kur ajo ndryshon në raport me dinamikën e shtrirjes së hetimit gjyqësor (shih nenin 161 të KPC-së). Parimi i disponibilitetit në formimin e ndërgjyqësisë, gëzon vëmendje të veçantë nga ana e gjykatës si garant i respektimit të procesit të rregullt ligjor, pasi ligji ngarkon me detyrime gjykatën në drejtim të orientimit të palëve,

me qëllim efektivitetin e gjykimit dhe marrjen e masave procedurale, kur ndërgjyqësia është e detyrueshme.

27. Ndërgjyqësia në procesin gjyqësor mundet të jetë *ndërgjyqësi kryesore*, e cila përbëhet nga rrethi i palëve, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet procesi. Ndryshe kjo ndërgjyqësi njihet si *palët në kuptimin e ngushtë*, pasi në mënyrë të drejtpërdrejtë, ato fitojnë apo konfirmojnë të drejta ose u shuhen të drejta, apo marrin përsipër detyrime nga vendimi gjyqësor përfundimtar. Duke qenë se procesi gjyqësor zhvillohet në emër, apo kundër tyre, në varësi nga pozita aktive, apo pasive procedurale, me të cilën janë legjitimuar proceduralisht në proces, gjykata me vendim përfundimtar mundet t'u njohë të drejtat apo t'i ngarkojë ato me detyrime.

28. Procesi gjyqësor njihet edhe bashkësinë apo kategorinë e ndërgjyqësve dytësorë, e cila njihet si *ndërgjyqësia dytësore*, të cilët kanë një pozitë procedurale të ndryshme nga ndërgjyqësit kryesorë. Ata marrin pjesë në proces në kushte të caktuara (shiko nenet 191, 192 dhe 193 të KPC-së) dhe sipas skenarëve proceduralë të caktuar nga ligji, parashikime të cilat kanë për qëllim të mundësojnë aksesin në gjykatë edhe për personat që kanë interes mbi çështjen duke u ofruar një mundësi reale dhe e drejta për t'u dëgjuar para se gjykata të shprehë me një vendim, i cili në mënyrë indirekte do të mund të ndikojë në të drejtat e tij në të ardhmen. Ndryshe nga ndërgjyqësit në kuptimin e ngushtë, ndërgjyqësit dytësorë lidhen indirekt nga produkti përfundimtar i procesit gjyqësor, nuk mundet të ngarkohen me detyrime nga vendimi përfundimtar dhe nuk mundet të ngarkohen me shpenzime gjyqësore. Ata, gjithashtu nuk mund të disponojnë mbi objektin e mosmarrëveshjes, të zgjidhin çështjen me pajtim, të thërrasin ndërgjyqës të tjerë në gjykim dhe kanë të drejtë të kushtëzuar apeli apo rekursi. Gjithashtu, këta ndërgjyqës, në kuptimin e gjerë nuk mundet të paraqesin kundërpadi, apo të zgjerojnë objektin e mosmarrëveshjes.

29. Pozicionin e palës ndërgjyqëse në gjykim mund ta ketë një person i vetëm (paditësi, i padituri, ndërhyrësi kryesor) ose disa persona së bashku. Pjesëmarrja e shumë personave në gjykim quhet bashkëndërgjyqësi (*litisconsortium*), pra bashkëndërgjyqësia është një formë e shfaqjes së ndërgjyqësisë në gjykim, ku njëra ose të dyja palët, përbëhen nga dy ose më shumë personave. Doktrina juridike ka identifikuar



bashkëndërgjyqësinë aktive, kur pjesëmarrja e shumë personave krijohet në anën e palës paditëse, atë pasive kur pjesëmarrja e shumë personave krijohet në anën e palës së paditur dhe ajo e përzier kur krijohet në të dyja palët. Nga përmbajtja e neneve 161 e 162 të KPC-së, vihet re se ekzistojnë dy kategori të ndryshme të llojeve të ndërgjyqësisë: *ndërgjyqësia e detyrueshme* dhe *ndërgjyqësia fakultative*. Doktrina ka pranuar se bashkëndërgjyqësia është e detyrueshme, kur formimi i saj nuk varet nga vullneti i palës ndërgjyqëse, por nga fakte jashtëprocedurale, sikurse detyrimi i sanksionuar në ligj për zhvillimin e procesit nga ose ndaj shumë personave dhe natyra e marrëdhënieve juridike që është në konflikt.

30. Në rastin e ndërgjyqësisë së detyrueshme, personat fizikë apo juridikë janë së bashku në të njëjtën pozitë procedurale, si pasojë e parashikimit të ligjit, apo natyrës juridike të mosmarrëveshjes, apo marrëdhënies juridike civile/administrative që ato kanë krijuar me njëri-tjetrin. Në këto raste, nëse paditësi nuk ka thirrur në gjykim të gjithë ndërgjyqësit e nevojshëm apo të detyrueshëm, padia është me të meta, pasi ai ka detyrimin ligjor të thërrasë në gjykim çdo subjekt, mbi të cilin vendimi ka efekt direkt në kuptimin që të drejtat e tij preken direkt nga kjo vendimmarrje duke qenë titullar apo bashkëtitullar i së drejtës që kontestohet gjyqësisht. Parimi i disponibilitetit të palës paditëse kufizohet vetëm tek e drejta për të bërë të vlefshëm në emrin e tij procesin apo jo, apo thënë ndryshe e drejta për të ngritur padi apo jo, pasi në këto raste rrethi i ndërgjyqësve përcaktohet jo nga vullneti i palës për t'ia kundërdrejtuar padinë një subjekti të caktuar apo nga vendimmarrja e gjykatës, por vetëm nga ligji dhe natyra juridike e marrëdhënies. Gjykata, në këto raste, në zbatim të nenit 161 të KPC-së, ngarkohet që të zbatojë ligjin procedural, në mënyrë që askush të mos lejohet që në emrin e tij të bëjë të vlefshme të drejtat e dikujt tjetër (shiko nenin 95 të KPC-së) dhe nga ana tjetër të mos lejojë që askush të gjykohej pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar (nenin 33 dhe 42 të Kushtetutës).

31. Nga ana tjetër, të gjitha marrëdhëniet e tjera që formohen ndërmjet bashkëndërgjyqësve në procesin gjyqësor civil, apo administrativ, janë lloji i bashkëndërgjyqësisë fakultative, ku rrethi i personave që bashkohen në një pozitë procedurale varet nga e drejta dhe fakulteti që ligji i njeh paditësit për të vendosur se kujt ia kundrejtton pretendimet në padi, apo thënë ndryshe është rrjedhojë dhe

përditësim i parimit të disponibilitetit maksimal të padisë. Këtu gjykata ka kryesisht rol pasiv dhe për thërritjen e palëve kryesore apo dytësore në proces iniciativën e kanë palët. Gjykata ushtron autoritet procedural vetëm në verifikimin e plotësimit apo jo të kriterëve ligjorë të krijimit dhe shtimit të ndërgjyqësisë dytësore fakultative. Jurisprudenca ka pranuar në mënyrë të qëndrueshme se ndërgjyqësia dytësore, nuk mundet të jetë pjesë e ndërgjyqësisë së detyrueshme, pasi në këtë kategori subjektsh bëhet fjalë vetëm për palët në kuptimin e ngushtë, me të gjitha karakteristikat e treguara më lart.

32. Siç u përmend më sipër, formimi i ndërgjyqësisë, në ligjin procedural më së pari parashikohet si e drejtë e palës paditëse dhe më tej rregullohet në ligj në mënyrë të detajuar, duke ngarkuar me detyra gjykatën për të legjitimuar një ndërgjyqës në gjykim apo jo. Si rrjedhojë logjike e disponibilitetit maksimal të padisë, pala paditëse në rastin e ndërgjyqësisë fakultative, mundet të përcaktojë lirisht se kush janë palët të cilave ai do t'u kundrejttojë pretendimet e tij. Në rastin e ndërgjyqësisë së nevojshme apo të detyrueshme, palës paditëse i mbetet vetëm vlerësimi, nëse do të ngrejë padi apo jo, pasi rrethi i ndërgjyqësve pasivë përcaktohet nga ligji apo nga natyra juridike e marrëdhënies që lidh këto palë. Nga kjo analizë mundet të konkludohet për çdo çështje, nëse është respektuar apo jo një ndër prezumimet procedurale për vlefshmërinë e procesit gjyqësor civil apo administrativ, sikurse është prezumimi i ndërgjyqësisë së rregullt (*shiko vendimet nr. 00-2014-2030 (330), datë 6.4.2014, nr. 00-2017-2175 (788), vendimi nr. 00-2017-2613 (829), datë 31.10.2017 të KA-së, palë paditëse Tefta Daci, nr. 00-2021* 1337, datë 21.7.2021*).

33. Në gjykimin administrativ, në përputhje me nenin 1(2) të ligjit nr. 49/2012, veprojnë rregullat e përgjithshme të formimit të ndërgjyqësisë të parashikuara në KPC, megjithatë natyra specifike e këtij gjykimi e ngarkon gjykatën administrative me detyrimin e respektimit të legjislacionit të posaçëm në çdo tipologji gjykimi administrativ, ku jo rrallë herë shfaqet domosdoshmëria e pjesëmarrjes së personave të caktuar, në gjykim, në pozitën e palës së paditur ose personit të tretë, përgjithësisht sipas parashikimit *ad litteram* në ligjin e posaçëm. Mënyra e veçantë e të konceptuarit të procesit gjyqësor administrativ, buron nga qëllimi i tij dhe karakteristikat e veçanta që mbart vendimmarrja e



organeve të administratës publike, në ndryshim nga veprimtaria e individëve privatë. Qëllimi i procesit gjyqësor administrativ është të sigurojë mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike. Kjo mënyrë e të konceptuarit të procesit gjyqësor administrativ, ku përgjithësisht, objekt gjykimi është veprimtaria administrative e organeve publike, vë këtë të fundit në pozitë procedurale të palës së paditur si subjekti, i cili me veprimet apo mosveprimet e tij, pretendohet se ka shkelur të drejtat ligjore dhe ndaj të cilit drejtohet kërkitimi palës së dëmtuar. Nga ana tjetër, me zhvillimin e shoqërisë është rritur ndjeshëm edhe funksioni rregullator i shtetit në shumë fusha të jetës ekonomike dhe shoqërore, i cili me veprimtarinë e tij ndërhyr duke krijuar, ndryshuar apo shuar marrëdhënie juridike të caktuara. Ushtrimi i këtyre funksioneve, nga njëra anë krijon të drejta për disa subjekte ndërsa, potencialisht, mund të cenojë të drejta të subjekteve të tjera, që nuk janë drejtpërdrejt palë në kuptimin e ngushtë në marrëdhënien juridike administrative të krijuar. Në këtë kundërshti e larmi interesash që karakterizojnë gjykimin administrativ, është e zakonshme që një subjekt të jetë përfitues i një dobie juridike që rrjedh nga zbatimi i aktit administrativ i cili lidhet natyrshëm përmes interesit personal dhe aktual me subjektin përfitues të kësaj të drejte që krijohet nga zbatimi i tij, por ky interes aktual prej së drejtës së krijuar përmes një akti administrativ, eventualisht mund të jetë në kundërshtim me atë të pretenduar nga individ i paditës që ankohet në gjykatë. Në rastin klasik të një gjykimi administrativ për kundërshtimin e një akti administrativ që ka krijuar një të drejtë, e cila kundërshtohet si e paligjshme, interesi që mbart pala përfituese nga akti do të përkohë pikërisht me ruajtjen e aktit të lartpërmendur dhe lënien e tij në fuqi. Përkundrazi, shfuqizimi i aktit do të kishte efekte negative ndaj tij, sepse do të sillte si pasojë shuarjen e së drejtës së fituar. Në këtë shembull të sipërpërmendur, tejet të hasur në mënyrën e kompozimit të interesave procedurale të palëve në gjykimin administrativ, shtrohet për diskutim kapaciteti ligjor i palëve për të qenë “aktor procedural” të procesit gjyqësor. Në raste të tilla, është e domosdoshme pjesëmarrja në proces e subjektit përfitues nga akti administrativ, i cili kundërshtohet, interesat e të cilit janë në

kundërshti direkte me ato të paditësit, për shkak të qenies në rendin juridik të aktit administrativ dhe gjykata duhet të ushtrojë të gjitha mjetet procedurale të njohura nga ligji për të arritur këtë qëllim. Në këtë kuptim, mund të ketë raste të posaçme brenda natyrës së gjykimit administrativ, ku është e domosdoshme “përshtatja procedurale” e palëve, që preken nga efektet e zbatimit të aktit, me qëllim garantimin e efektivitetit të gjykimit.

34. Në ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, u njoh e drejta familjeve anëtare të ish-kooperativave bujqësore, të shkëputen nga kooperativa duke marrë në pronësi tokën bujqësore që u takon nga tërësia e subjektit ku ishin bërë pjesë. Ligji parashikoi se toka bujqësore u jepet në pronësi ose në përdorim personave juridikë a fizikë, vendës, pa shpërblim, nën tiparet e një “reformë agrare”. Sasia dhe vendi ku do të jepej toka, përcaktohej, sipas rregullimeve të posaçme ligjore, nga komisioni i tokës. Me anë të këtij ligji, toka shtetërore u tjetërsua nga organet publike në favor të individëve, të cilët ishin banorë të fshatit dhe rezultinin të regjistruar në zyrën e gjendjes civile të fshatit në fjalë, më datë 1.8.1991 (për tokat e ish-kooperativave bujqësore), ose 1.10.1992 (për tokat e ish-ndërmarrjeve bujqësore), sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore.

35. Duke iu referuar mënyrës së shpërndarjes së tokës, sipas ligjit nr. 7501/1991 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si VKM-ja nr. 255, datë 2.8.1991, që përcaktonin se toka i shpërndahej familjes në bazë të numrit të frymëve dhe një norme të caktuar për frymë, duket qartë që përmes këtij ligji është krijuar një “bashkëpronësi në pjesë” ndërmjet anëtarëve që kanë qenë në përbërje të familjes më datë 1.8.1991 ose më 1.10.1992, e krijuar sipas një mënyre origjinale të fitimit të pronësisë, ku shteti nëpërmjet një akti administrativ, u kaloi në bashkëpronësi tokë bujqësore anëtarëve të familjeve me banim në fshat. Në këtë lloj bashkëpronësie, të gjithë anëtarët që kanë qenë pjesë e kësaj familje, në momentet e sipërcituara, janë bashkëpronarë të të gjithë sipërfaqes së tokës së përfituar dhe pjesa takuese e secilit është në përpjesëtim me normën për frymë.

36. Procesi i shpërndarjes së tokës bujqësore për çdo familje u konceptua nga legjislacioni i kohës në një mënyrë të tillë, ku secila familje pajisej me aktin e marrjes së tokës në pronësi, i cili lëshohej nga Komisioni i Ndarjes së Tokës i secilit fshat në favor



të të gjithë anëtarëve të familjes, por duke dalë në emër të kryefamiljarit. Në këtë mënyrë është krijuar *ipso lege* regjimi juridik i bashkëpronësisë mbi tokën bujqësore ndërmjet anëtarëve të familjes që kanë qenë pjesë përbërëse e saj në datat e sipërpërmendura. Sipas ligjit nr. 7501/1991 dhe ateve nënligjore në zbatim të tij, nuk rezulton që kryefamiljari të ketë një cilësi të posaçme në kuadër të marrëdhënies juridike të pronësisë së fituar nga ky ligj. Nga ana tjetër ai paraqitet si subjekt me të drejta të barabarta me anëtarët e tjerë të familjes në kuptim të së drejtës së pronësisë së fituar.

37. Natyra juridike e akteve të marrjes së tokës në pronësi ka qenë objekt trajtimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë mbajtur qëndrimin se aktet e marrjes së tokës në pronësi janë akte administrative të një natyre individuale. Me nxjerrjen e këtyre akteve konkretizohet veprimtaria e organit të përcaktuar nga ligji për kryerjen e procesit të ndarjes së tokës bujqësore, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj. Ligjvënësi u ka dhënë të drejtë organeve të krijuara me ligj të posaçëm që me anë të këtyre akteve të disponohet mbi të drejtën e pronësisë së tokës bujqësore nga pronë shtetërore në pronë private. Me anë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar, shteti, përmes organeve të përcaktuara me rregullimin ligjor të posaçëm, u jep tokë bujqësore në përdorim ose pronësi individëve sipas kategorive të caktuara në ligj, kundrejt disa kriterëve të përcaktuara, pa pasur parasysh pronësitë e mëparshme në këto toka bujqësore, me kushtin që nëse përdorimi i tokës bujqësore nuk bëhet sipas destinacionit të saj, personit që ka përfutur i hiqet e drejta e përdorimit të saj. Në këtë mënyrë, organet kompetente për dhënien e akteve të marrjes së tokës në pronësi janë veshur me pushtet shtetëror dhe kjo natyrë disponimi merr karakterin e së drejtës publike. Mosmarrëveshjet që burojnë nga aktet e marrjes së tokës në pronësi, që kanë të bëjnë me kundërshtimin e tyre, janë të natyrës administrative, pavarësisht natyrës civile të pasojave që akti i dhënies së tokës në pronësi apo përdorim ka sjellë për palët e interesuara. Këto akte, pavarësisht se në thelb krijojnë pasoja që kanë të bëjnë me të drejta civile, siç është edhe e drejta e pronësisë, janë akte të nxjerrra nga organet e përcaktuara me ligj për të ushtruar në interesin publik pushtetin e tyre të dhënë nga ligji, në lidhje me ndarjen e tokës bujqësore (*shih*

vendimin nr. 2, datë 19.2.2014, dhe 10.3.2014 të KBGJL-së).

38. Në vijim të dinamikës që krijoi fitimi i pronësisë mbi tokën bujqësore nga zbatimi i ligjit nr. 7501/1991, u miratua ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, i cili hyri në fuqi më datë 15.8.2008. Qëllimi i këtij ligji është verifikimi i vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9948, datë 17.7.2008, në bazë të nenit 17/2 të këtij ligji, komisionet e tokës, krijuar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, pushuan së funksionuari dhe kompetencat e tyre iu kaluan Komisionit Qeveritar të Tokës dhe Komisioneve Vendore të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë. Ky ligj parashikoi mekanizmat administrativë dhe gjyqësorë për verifikimin e ligjshmërisë së akteve administrative përmes të cilave u fitua toka bujqësore, sipas ligjit nr. 7501/1999. Sipas nenit 10, të ligjit nr. 9948/2008, i ndryshuar, kur komisioni vendor vëren se titulli i pronësisë mbi tokën është dhënë në kundërshtim me dispozitat ligjore i paraqet gjykatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ. Prefekti është subjekti që autorizohet nga ligji për të vënë në lëvizje gjykatën në lidhje me deklarin e pavlefshmërisë së aktit të marrjes së tokës në pronësi, shfuqizimin i tij dhe kthimin e pronës në pronësi të shtetit.

39. Kolegji ka qenë konsequent në lidhje me mjetin procedural që duhet përdorur nga prefekti në këto procese gjyqësore, i cili është padia. Pavarësisht parashikimit të shprehur të nenit 10 të ligjit nr. 9948/2008, i cili, nga pikëpamja gjuhësore, përcakton se prefekti i drejtohet gjykatës me kërkesë, në thelb pretendimet e tij për shfuqizimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi dhe kthimin e tokës në pronësi të shtetit, ky organ i administratës shtetërore mund t’i parashtrijë vetëm me padi në kuadrin e gjykimit të mosmarrëveshjes administrative, duke thirrur si të paditur mbajtësin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, i cili është subjekti i detyruar nga pretendimet e palës paditëse dhe vendimmarrja e pritshme e gjykatës, me qenë se pasoja e shfuqizimit të aktit administrativ, në potencial passjell detyrim për të paditurin për t’i kthyer pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme, shtetit. Në asnjë rast të drejtat e mbajtësit të titullit të pronësisë nuk mund të mbrohen, duke qenë i thirrur në cilësinë e palës se tretë në këtë gjykim të karakterit



administrativ (*shih vendimin nr. 00-2021-1827, datë 15.11.2021, palë paditëse G.M.*).

40. Neni 10 i ligjit nr. 9948/2008 legjitimon aktivisht prefektin t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar pavlefshmërinë e titullit të pronësisë së familjes që ka përfutur nga akti, duke detyruar thirrjen në gjykim edhe të Avokaturës së Shtetit. Nga ana tjetër, ligji i mësipërm nuk ka ndonjë dispozitë konkrete që të marrë përsipër rregullimin e legjitimitetit pasiv në paditë me objekt shfuqizimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi dhe kthimin e saj në tokë shtet. Në këtë koncept, për të identifikuar ndërgjyqësinë dhe më pas atë të detyrueshme, i duhet referuar rregullave të përgjithshme procedurale, natyrës juridike e marrëdhënies konkrete dhe pasojave të vendimmarrjes që kërkohet nga gjykata.

41. Padia e prefektit për anulimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, për shkak të natyrës administrative të saj, fokuson kontrollin gjyqësor të gjykatës administrative në verifikimin e hetimit administrativ që ka kryer organi kompetent në kuptim të dispozitave të ligjit me nr. 9948/2008, i ndryshuar, mbi vlefshmërinë e titullit të pronësisë në raport me kërkesat ligjore sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar dhe atij nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërbllim të tokës bujqësore", i ndryshuar. Njëkohësisht, në këtë gjykim konkludohet edhe mbi të drejtën e pronësisë së të gjithë anëtarëve, pasi anulimi i aktit zhbën të drejtën e pronësisë së anëtarëve mbi tokën e përfutur me aktin e marrjes së tokës në pronësi. Pra, nëpërmjet padisë së paraqitur, prefekti synon t'u heqë të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore të gjithë anëtarëve të familjes, të cilët janë bashkëpronarë mbi sipërfaqen e tokës së përfutur nëpërmjet aktit të marrjes së tokës në pronësi. Bashkëpronësia rrjedh nga mënyra e fitimit të pronësisë, me akt administrativ, i cili buron nga një ligj i veçantë, nga kuadri ligjor që rregullon marrëdhëniet e pronësisë mbi tokën bujqësore, pas shpërbërjes së ish-kooperativave bujqësore dhe ndërmarrjeve.

42. Ligjet e mësipërme që kanë shërbyer si bazë ligjore për shpërndarjen e tokës bujqësore dhe as dispozitat e KC-së që rregullojnë bashkëpronësinë në pjesë nuk i kanë dhënë ndonjë pozitë të veçantë kryefamiljarit, në raport me anëtarët e tjerë të familjes, në mënyrë që ai këtë të drejtë të disponojë mbi sipërfaqen e tokës në bashkëpronësi, veprim i

cili realizohet me shprehjen e vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve apo të ketë tagra përfaqësimi për administrim të jashtëzakonshëm të sendit. Ligji nr. 9948/2008 nuk qartëson legjitimin pasiv në paditë me objekt anulimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi. Në këtë kuadër shtrohet për diskutim nëse prefekti në padinë për heqjen e së drejtës së pronësisë së anëtarëve të familjes duhet të mjaftohet me thirrjen në gjykim në cilësinë e palës së paditur të kryefamiljarit apo duhet të paditen të gjithë bashkëpronarët e tokës bujqësore përfutues nga akti i marrjes së tokës në pronësi, pra nëse në këtë padi ndodhemi në kushtet e bashkëndërgjyqësisë pasive të detyrueshme, ku pala paditëse do të duhet të thërrasë në gjykim të gjithë bashkëpronarët.

43. Në analizë të dispozitave të ligjit nr. 7501/1999 dhe akteve nënligjore, konkretisht VKM-së nr. 255/1991, "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", dhe VKM-së nr. 231/1993, "Për tokat që refuzohen të merren në pronësi ose në përdorim dhe zgjidhjen e kërkesave të shtetasve për lënie të tokës", nuk rezulton që kryefamiljari të ketë të drejta përfaqësimi *ipso legge* në raportet e pronësisë së anëtarëve të tjerë të familjes. E drejta e pronësisë së kontestuar gjyqësisht nga ana e autoritetit shtetëror, në planin e një gjykimi administrativ me kërkim pavlefshmëri të titullit (akti i marrjes së tokës në pronësi), nuk rezulton t'i ketë rezervuar kryefamiljarit ndonjë rregullim të posaçëm me ligj, për të pasur të drejtë përfaqësimi të jashtëzakonshëm. E drejta e bashkëpronësisë mbi tokën bujqësore është krijuar *ex lege* mes të gjithë anëtarëve, pjesë përbërëse të familjes, në një moment të përcaktuar. Për rrjedhojë, nuk mund të vihet në diskutim përmes një procesi gjyqësor titulli i pronësisë ndaj bashkëpronarit, pa qenë pjesë e procesit gjyqësor përkatës (ose pa lëshuar autorizimet përkatëse për lejin e përfaqësimit) edhe bashkëpronarët e tjerë. Një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit, sipas nenit 18 të KPC-së, shkëlja e të cilit do të shkaktonte pavlefshmërinë e procesit. Rrjedhimisht, Kolegji vlerëson se në rastin konkret gjendemi përpara bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme (të nevojshme) e llojit të njohur në doktrinë si *bashkëndërgjyqësi unike*, pasi, për shkak të natyrës së marrëdhënies juridike materiale në gjykim, çështja mund të zgjidhet veçse në mënyrë të njëjtë dhe kundërt të gjithë bashkëpronarëve, të cilët duhet të kenë të drejtë të dëgjohen para se të gjykohen.



44. Në lidhje me sa u vlerësua më lart, Kolegji çmon të vërë në dukje, se pavarësisht ndonjë rasti të veçuar, është zhvilluar një praktikë e qëndrueshme në lidhje me këtë moment procedural, duke u mbajtur, në mënyrë të vazhdueshme, qëndrimi se për pasuritë e fituara me AMTP-në, thirrja e të gjithë bashkëpronarëve hyn në rastet bashkëndërgjyqësisë së detyruar dhe se pala paditëse, prefekti ka detyrimin që t'i thërrasë si të paditur në gjykim. Kryefamiljari i familjes që ka përfituar tokë me AMTP-në nuk është përfaqësues me prokurë i anëtarëve të tjerë madhorë e, për këtë shkak nuk mund të konsiderohet se përfaqëson edhe ata pasivisht, për të drejtat e veçanta të pronësisë që ata kanë në mënyrë individuale (*shih vendimin nr. 00-2021-338, datë 29.3.2021, i paditur H.P., vendimi nr. 00-2021-1842, datë 18.11.2021, i paditur R.V., vendimi nr. 00-2022-2089, datë 20.9.2022, i paditur A.Xh., vendim nr. 00-2022-1667, datë 18.7.2022, i paditur Y.P., vendimi nr. 00-2021-1789, datë 15.11.2021, i paditur L.P.; nr. 00-2023-2320, datë 8.6.2023, i paditur S.S.; 00-2021-1592, datë 21.10.2021, i paditur R.D., vendimi nr. 00-2022-2701 (357), datë 17.10.2022, i paditur M.C., vendimi nr. 00-2020-739, datë 27.10.2020, e paditur F.H., vendimi nr. 0-2022-2252 (337), datë 6.10.2022, i paditur G.R., vendimi nr. 00-2023-1439 (138), datë 13.4.2023, i paditur P.Gj. të KA-së).*

45. Në përfundim, Kolegji vlerëson të konsolidojë, përmes njësimi, praktikën e tij të qëndrueshme tashmë, mbi natyrën e ndërgjyqësisë në gjykime me objekt pavlefshmërinë e aktit të marrjes së tokës në pronësi të ngritura nga prefekti. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në përgjigje të pyetjes së parë të shtruar për njësim, duhet të arrihet në përfundimin njësoj:

“Në paditë administrative me objekt kundërshtimin e ligjshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga prefekti (sot sukseduar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës), duhet të thirren në cilësinë e të paditurit të gjithë përfituesit e aktit të marrjes së tokës në pronësi, që rezultojnë në certifikatën e gjendjes familjare të datës 1.8.1991 (për ish-kooperativat bujqësore), ose 1.10.1992 (për ish-ndërmarrjet shtetërore).”

C. Lidhur me pyetjen e dytë:

- Në ato raste kur gjykatat administrative kanë shqyrtuar në themel padinë, e cila paraqitet me bashkëndërgjyqësi pasive të detyrueshme të parregullt, a mundet Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të prishë të

dyja vendimet dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë?

46. Kolegji vlerëson se është thelbësore të kuptohet drejt natyra e pavlefshmërisë së gjykimit në rastin e mosformimit të rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme dhe parimi i taksativitetit të vendimmarrjes së Kolegjit. Perfeksionimi i bashkëndërgjyqësisë, në rastet kur ajo është e detyrueshme, përbën kusht për vlefshmërinë e procesit gjyqësor. Një gjykim administrativ me ndërgjyqësi pasive të parregullt, në mbështetje të KPC-së, i cili, në zbatim të nenit 1(2) të ligjit nr. 49/2012, gjen zbatim në mënyrë komplementare me parashikimet procedurale të ligjit të posaçëm, është shkak për mosvijimin e mëtejshëm të gjykimit (*gjykimi nuk mund të vazhdojë*) dhe përfundimin e tij me një vendim deklarativ të natyrës jopërfundimtare. Neni 467(d) i KPC-së dhe 50 i ligjit nr. 49/2012 sanksionojnë detyrimin e gjykatave të apelit për konstatimin e kësaj pavlefshmërie, duke mos hyrë në themelin e shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, në rast konstatimi të kësaj të mete formale të gjykimit në shkallë të parë. Kjo do të thotë se një proces gjyqësor në të cilin bashkëndërgjyqësia e detyrueshme nuk është respektuar, është një proces gjyqësor i pavlefshëm dhe i pariparueshëm në shkallët më të larta të gjykimit të çështjes. Në mënyrë të njëjtë zbatohet parimi i pavlefshmërisë së plotë të procesit gjyqësor edhe në raste të tjera të *errores procedendo* të cilat gëzojnë atributin e parakushtit procedural që kushtëzon vlefshmërinë e procesit gjyqësor, sikurse është rasti i mungesës së juridiksionit ose mosrespektimi i kompetencës lëndore/funksionale etj.

47. Formimi jo i rregullt i ndërgjyqësisë është jo vetëm e metë formale e gjykimit, por ndikon edhe në deformimin e së drejtës materiale të mbrojtur, duke cenuar rëndë parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi në çdo rast një vendim gjyqësor me formim jo të rregullt të ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme, sjell problematika në procesin e ekzekutimit. Në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, palët nuk bashkohen në proces, si rrjedhojë e parimit të disponibilitetit, por si pasojë e parashikimit të ligjit dhe/ose natyrës juridike të mosmarrëveshjes në gjykim. Në këto raste, nëse paditësi nuk ka thirrur të gjithë bashkëndërgjyqësit e nevojshëm apo të detyrueshëm, padia është me të meta, pasi ai ka detyrimin ligjor të thërrasë çdo subjekt, mbi të cilin vendimi ka efekt direkt në



kuptimin që të drejtat e tij preken direkt nga kjo vendimmarrje, duke qenë titullar apo bashkëtitullar i së drejtës që kontestohet gjyqësisht, përndryshe gjykimi është i metë dhe sanksionohet si i pavlefshëm nga legjislacioni procedural. Disponibiliteti i paditësit kufizohet vetëm tek e drejta e tij për të filluar procesin, ndërsa rrethi i ndërgjyqësve, në rastet e parashikuara në ligj ose kur natyra e së drejtës në konflikt e kërkon, tejkalon vullnetin e palës paditëse.

48. Rasti i bashkëndërgjyqësisë pasive ngarkon me detyrime pozitive gjykatën për të vepruar aktivisht në drejtim të perfeksionimit të saj, sikurse pala paditëse detyrohet të zbatojë urdhërimet e gjykatës, tej parimit të disponibilitetit, përndryshe padia nuk do të jetë e suksesshme (neni 161 i KPC-së). Gjykatës i kërkohet të zbatojë ligjin procedural në mënyrë që në gjykim të respektohet parimi i kontradiktoritetit, duke mos lejuar që dikush të gjykohej pa iu dhënë mundësia për t'u dëgjuar (shiko nenet 33 dhe 42 të Kushtetutës dhe nenin 18 të KPC-së). Në kuadër të detyrimit për të garantuar një proces të rregullt gjyqësor (neni 4 i KPC-së), në formimin e rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme gjykata ka rol aktiv dhe investohet kryesisht. Formimi i rregullt i ndërgjyqësisë së detyrueshme përbën një nga prezumimet procedurale absolute, si kusht për vlefshmërinë e gjykimit.

49. Ndryshimet e ligjit procedural civil janë reflektuar në jurisprudencën e Kolegjit Administrativ, duke evoluuar qëndrimin në rastin e prishjes së vendimmarrjes së gjykatave më të ulët, kur konstatohet mosformim i saktë dhe i plotë i ndërgjyqësisë. Kolegji ka pranuar se neni 467 (d) i KPC-së nuk e lidh qëllimin e tij me mënyrën se si gjykata ka marrë apo refuzuar të marrë vendimet e ndërmjetme për të formuar ndërgjyqësinë dytësore. Qëllimin e kësaj dispozite, Kolegji e ka gjetur të lidhur vetëm dhe ekskluzivisht me ndërgjyqësinë kryesore dhe të detyrueshme. Kjo është logjika procedurale dhe mënyra se si duhet të kuptohet

fillimisht dhe më tej se si duhet të zbatohet neni 467(d) i KPC-së nga gjykatat me juridiksion rishikues. Kjo do të thotë se gjykata me juridiksion rishikues mundet të prishë një vendim të një gjykate më të ulët, vetëm kur nga kjo e fundit është lejuar të zhvillohet gjykimi pa u respektuar ligji apo natyra e marrëdhënies juridike objekt gjykimi, të cilat kërkojnë krijimin e ndërgjyqësinë kryesore të detyrueshme. Për të gjitha rastet e tjera neni 467 (d) i KPC-së është i pazbatueshëm. Vetëm kjo parregullsi dhe paligjshmëri është shkak i jashtëm pavlefshmërie gjykimi dhe njëkohësisht edhe i akteve procedurale, që është e aftë të bëjë nul të gjithë gjykimin në atë shkallë ku është lejuar të ndodhë kjo shkelje (*shih vendimin nr. 00-2017-2175 (788), datë 27.9.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

50. E ndërsa nuk ka diskutim në doktrinë dhe jurisprudencë se mosrespektimi i vendimit të gjykatës për të rregulluar ndërgjyqësinë pasive të detyrueshme gjatë gjykimit në shkallë të parë sjell pushimin e gjykimit (neni 161(ç) i KPC-së), e gjatë gjykimit në apel, konstatimi i një shkelje të tillë, sjell prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim kur nuk është zbatuar neni 161(ç) i KPC-së, vërehet se prej vitit 2017, jurisprudenca e Kolegjit Administrativ, për shkak të ndryshimeve të legjislacionit është luhatur në qëndrime, në rastet kur është konstatuar se gjykatat e faktit *ab initio* kanë lejuar gjykimin e padive me të meta formale, për shkak të formimit të gabuar të bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme.

51. Me ndryshimet ligjore të vitit 2017, në KPC dhe në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohej më një ndër kompetencat funksionale në disponim të Gjykatës së Lartë, konkretisht disponimi mbi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe gjykatës së shkallës së parë dhe kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë (parashikuar në vitin 1994, në ligjin nr. 8116/1994, në nenin 485(ç)). Në sinkron të plotë, KPC-ja¹ dhe ligji nr. 49/2012²

¹ Neni 485 i KPC-së, ndryshuar me ligjin nr. 38/2017 parashikonte, se: “Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin: a) lënien në fuqi të vendimit; b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë; c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit me tjetër trup gjykues; e) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.”

² Neni 63 i ligjit nr. 49/2012, ndryshuar me ligjin nr. 39/2017, parashikonte, se: “Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Administrativ ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin: a) lënien në fuqi të vendimit; b) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë; c) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit me tjetër trup gjykues; e) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.”



ndryshuan dispozitat procedurale mbi mënyrën e disponimit të Gjykatës së Lartë, duke mos parashikuar më, në mënyrë të shprehur, mundësinë e prishjes së vendimeve të gjykatave të faktit dhe rikthimin e procesit për gjykim në shkallë të parë, duke lënë Gjykatën e Lartë në vakum ligjor për rastet e pavlefshmërisë së procesit në dy shkallë gjykimi.

52. Në vitin 2021, përmes ligjeve nr. 49/2021 dhe 44/2021, pësuan përsëri ndryshime disponimet e Gjykatës së Lartë si për Kolegjin Administrativ ashtu edhe atë Civil. Me ndryshimin e ligjit nr. 49/2021, neni 63 i ligjit nr. 49/2012, u ndryshua dhe në vijim të zgjerimit të attributeve të disponimeve të Kolegjit Administrativ, në shkronjën (ç) të kësaj dispozite u parashikua, se: *“Pas shqyrtimit të çështjes Kolegji Administrativ ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin: ... (ç) prishjen e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga Gjykata Administrative e Apelit; ...”*. Në referim të dispozitave tranzitore të ligjit nr. 49/2021, ndryshe nga sa parashikohej në dispozitat tranzitore të ligjit nr. 39/2017, neni 63 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me parashikimet e ligjore të vitit 2021, gjeti zbatim të menjëhershëm në gjykimet administrative, kjo në përputhje edhe me rregullin e përgjithshëm të veprimit në kohë të ligjit procedural, duke vënë Kolegjin në një situatë tërësisht të re ligjore lidhur me disponimet në rastet e konstatimit të *errores procedendo* në gjykimin pranë shkallës së parë, të pariparuar gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

53. Si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore të mësipërme, erdhën qëndrimet e para të Kolegjit Administrativ mbi interpretimin e dispozitave të reja procedurale. Në praktikë, nga Kolegji është mbajtur si qëndrimi ku Kolegji mund të prishë vetëm vendimin e Gjykatës së Apelit për ta dërguar çështjen për rigjykim pranë kësaj gjykate, ashtu edhe qëndrimi ku Kolegji duhet të prishë të dyja vendimet e gjykatave të faktit dhe për ta dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë. Në lidhje me qëndrimin e parë, Kolegji është shprehur se pas ndryshimeve të nenit 63 të ligjit nr. 49/2012, me ligjin nr. 39/2017, Gjykatës së Lartë i është hequr kompetenca e mëparshme për të disponuar prishjen e dy vendimeve të gjykatave të faktit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së

Parë, por, pasi ka dërguar çështjen në gjykatën e apelit ka orientuar këtë të fundit që ta bëjë këtë veprim (*shih vendimin nr. 00-2017-2704 (823), datë 31.10.2017, vendimi nr. 00-2023-1439 (138), datë 13.4.2023 të KA-së*). Në një linjë tjetër arsyetimi, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se mosparashikimi i së drejtës së Gjykatës së Lartë për ta kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë është i qëllimshëm dhe e gjen kuptimin e tij në referencë të rregullit të parashikuar në nenin 467/a të KPC-së, duke vlerësuar se në këto raste Gjykata e Apelit do të duhet të gjykojë si shkallë e parë, rrjedhimisht edhe rregullimi i ndërgjyqësisë së detyrueshme të realizohet në këtë shkallë gjykimi (*shih vendimin nr. 00-2023-992 (25), datë 26.1.2023, të KA-së*). Në lidhje me qëndrimin e dytë, Kolegji ka vlerësuar se në kushtet e mosformimit të saktë të ndërgjyqësisë, proceset e zhvilluara në gjykatat e faktit, janë nul. Duke qenë se ndërgjyqësia nuk mund të rregullohet në shkallën e dytë të gjykimit, Kolegji ka vlerësuar se vendimet e të dyja gjykatave duhet të prishen dhe çështja duhet të kthehet për rishqyrtim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë (*shih vendimin nr. 0-2022-2252 (337), datë 6.10.2022, të Kolegjit Administrativ*). Ajo që është e përbashkët në këto qëndrime të jurisprudencës është se pranohet që mosformimi i saktë i bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme pasive është shkelje procedurale që shkakton pavlefshmërinë e gjykimit, ndërsa dallimi qëndron në mënyrën e zgjidhjes së rastit konkret.

54. Nisur nga përmbajtja në tërësi e nenit 63 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe në veçanti të pikës “ç” të tij, në funksion të interpretimit të saktë të ligjit dhe dhënies së përgjigjes për çështjen e dytë të shtruar për njësim, duke parë zgjidhjet e ndryshme të dhëna nga praktika gjyqësore në lidhje me çështjen në fjalë, Kolegji vlerëson se gjendet para tri alternativave të ndryshme mbi mënyrën e interpretimit të ligjit, të cilat kanë gjetur zbatim në praktikën gjyqësore dhe konkretisht: i. neni 63 (ç), i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 49/2021, mundëson vetëm prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë saj dhe kjo e fundit në zbatim të nenit 467(d), të Kodit të Procedurës Civile duhet të kthejë çështjen për rishqyrtim në shkallë të parë; ii. neni 63, i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 49/2021, mundëson vetëm prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë saj në rastet kur, vendimet përfundimtare të gjykatave të faktit nuk kanë konstatuar ndërgjyqësinë



pasive të detyrueshme, duke ngarkuar këtë të fundit me detyrën e gjykimit si shkallë e parë dhe rregullimin ex novo të ndërgjyqësisë së detyrueshme, gjatë rigjyqimit në apel; iii. Kolegji mund të prishë të dyja vendimet e gjykatave të faktit të cilët janë nul dhe të disponojë vetë kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë gjykatës së shkallës së parë, aty ku edhe është lejuar shkelja e rëndë e procesit dhe ku palët jo të thirrura në gjykim do të duhej të mbronin të drejtat e tyre, duke pasur më pas të drejtën e apelit për çështje fakti dhe ligji në një gjykatë më të lartë.

55. Përpara se të marrë në shqyrtim secilën nga këto alternativa, Kolegji vlerëson të theksojë, se pavarësisht se në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012 janë parashikuar mënyrat e disponimit, këto mënyra nuk janë fundore. Gjykata e Lartë ka për detyrë që përmes mënyrave të ndryshme të interpretimit të nxjerrë kuptimin e ligjit dhe të sigurojë një zbatim të unifikuar të tij. Interpretimi i ligjit nuk bëhet duke iu referuar vetëm leximit literal të një norme të caktuar, por duke iu referuar normave në tërësi, në lidhje me njëra-tjetrën, duke përdorur metoda të ndryshme interpretuese për të nxjerrë kuptimin e vërtetë të dispozitës. Në këtë kuptim, qëllimi i Gjykatës së Lartë është që të sigurojë një zbatim të njëjtë të ligjit jo vetëm kur ai është i qartë por më së shumti në rastet kur ligji nuk është i qartë, apo ka kundërtënie midis dispozitave. Është pikërisht në këto raste kur merr kuptim funksioni i Gjykatës së Lartë si një gjykatë ligji. Situatat që mund të sjellë praktika, janë nga më të ndryshmet prandaj edhe interpretimi i ligjit duhet të jetë njëkohësisht i kujdesshëm që të mos kalojë caqet interpretative, por edhe mjaftueshëm dinamik, në mënyrë që t'i përshtatet nevojës për zbatimin e ligjit, sipas qëllimit të tij, në funksion të respektimit të garancive procedurale kushtetuese e ligjore të palëve. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se llojet e disponimeve të parashikuara në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012, nuk mund të konsiderohen si ezauruese edhe në rrethana kur aplikimi i tyre nuk është në përputhje me rregullat dhe parimet procedurale. Në këtë kuptim, është detyrë e gjykatës që të zgjidhë kontradiktat që krijohen nga interpretimi dhe zbatimi i ligjit.

56. Lidhur me alternativën e parë (i), e cila përfaqëson një qëndrim që është ndeshur në disa raste në jurispruencës së tij, Kolegji çmon se nuk garanton zbatimin e rregullt të dispozitave procedurale. Zbatimi i nenit 63 (ç) të ligjit nr. 49/2012, sipas interpretimit të tij gjuhësor, josistematik, të shkëputur nga dispozitat e tjera të

dhe të KPC-së, shkakton një situatë kaotike sipas së cilës Gjykata e Lartë kthen një çështje për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit me qëllimin që kjo e fundit ta kthejë për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë, pasi vetë nuk identifikon bazën ligjore për të bërë këtë gjë, duke pasqyruar kosto të pajustificuara në kohëzgjatjen e gjykimeve dhe shumëzim joefektiv dhe të panevojshëm të procedurave të gjykimit. Kjo do të thotë se zbatimi i parimit të taksativitetit të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, ekskluzivisht sipas parashikimeve të nenit 63 (ç) të ligjit nr. 49/2012, në raste specifike, sikurse është nuliteti i gjykimit në dyja shkallët e gjykatave të faktit, nuk mund të aplikohet.

57. Zbehja e zbatimit të parimit të taksativitetit të vendimmarrjes së Kolegjit, sipas kësaj alternative, bëhet edhe më evidente në rastin kur evidentohet mungesa e kompetencës lëndore të gjykatave të faktit për shqyrtimin e një konflikti. Në eventualitetin ku gjykatat e faktit kanë keqzbatuar ligjin duke dhënë një vendim përfundimtar në mungesë të kompetencës lëndore, nuk mund të ketë vend për dyshime se Gjykata e Lartë, si autoriteti përfundimtar për shqyrtimin e kompetencës lëndore, ka autoritetin e plotë për kthimin e çështjes pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë.

58. Kolegji vlerëson se kjo mënyrë interpretimi cenon parimin e procesit të rregullt ligjor dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Duke iu referuar natyrës së gjykimit në Gjykatën e Apelit, si gjykim ligji dhe fakti, kjo e fundit ka për detyrë të shqyrtojë ankimin dhe të zgjidhë çështjen në themel, si nga pikëpamja e ligjit, ashtu edhe e faktit. Në këtë kuptim, prishja, nga Gjykata e Lartë, e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në këtë shkallë bëhet në rastet, kur Gjykata e Apelit, jo vetëm duhet të ndreqë të metat e karakterit procedural, por duhet të japë edhe një vendim përfundimtar për zgjidhjen e çështjes. Gjykata e Lartë, në kuptim të detyrave që lë për Gjykatën e Apelit në rishqyrtim, mund ta ngarkojë atë me kryerjen e detyrave konkrete në funksion të zgjidhjes përfundimtare të çështjes, por nuk mund t'i transferojë asaj detyrën për të konstatuar një shkelje të kryer në Gjykatën e Shkallës së Parë, kur është vetë Gjykata e Lartë që e konstaton këtë të metë.

59. Kolegji vlerëson se një interpretim i tillë nuk është në pajtim me parimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së



vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit, në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete, jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar, se sipas këtij neni, detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Në linjë të kundërt me këtë variant janë edhe qëndrimet e GJEDNJ-së, e cila ka theksuar se gjatë zbatimit të rregullave procedurale, gjykatat duhet të shmangin si formalizmin e tepruar që do të dëmtonte drejtësinë e procedurave, ashtu edhe fleksibilitetin e tepruar që do t'i bënte të pavlefshme kërkesat procedurale të përcaktuara në ligj (*Hasan Tunç dhe të tjerë kundër Turqisë, 2017, §§ 32–33*). Jurisprudenca e gjykatës ka vënë në dukje se e drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë “*praktike dhe efektive*”, joteorike apo iluzive (*shih Zubac kundër Kroacisë, 2018, § 76–79*).

61. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit, me detyrën që kjo e fundit ta kthejë çështjen për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë, nuk pajtohet me parimin e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe efektivitetin e mjetit të ankimit (rekursit).

62. Alternativa e dytë (ii) vë në dukje se mosparashikimi i shprehur i së drejtës së Gjykatës së Lartë për ta kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë është i qëllimshëm, në kuadrin e ekonomizimit të procesit dhe arritjen e standardit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke iu referuar rregullit procedural të parashikuar në nenin

467/a të KPC-së, sipas të cilit Gjykata e Apelit, kur prish vendimin nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë, por e shqyrton vetë si Gjykatë e Shkallës së Parë. Pra, mosparashikimi eksplisit i së drejtës së Kolegjit për të prishur vendimet përfundimtare të gjykatave të faktit dhe për të kthyer çështjen për rishqyrtim në shkallë të parë, e gjen kuptimin e tij në rregullin e parashikuar në nenin 467/a të KPC-së (dispozitë që parashikohet të pjesa e normave që rregullojnë gjykimin në apel e jo në Gjykatën e Lartë), duke vlerësuar se në këto raste Gjykata e Apelit do të duhet të gjykojë si shkallë e parë, rrjedhimisht edhe rregullimi i ndërgjyqësisë së detyrueshme të realizohet në këtë shkallë gjykimi.

63. Siç është argumentuar më lart dhe pranohet gjerësisht nga jurisprudenca, mosformimi i rregullt i ndërgjyqësisë përbën një gabim në procedim që shkakton nulitetin e gjykimit, në bazë dhe për zbatim të nenit 467 shkronja (d) të KPC-së, duke qenë se shkel parimin e kontradiktoritetit, të drejtën për t'u dëgjuar para se të gjykohet, një nga parimet me të rëndësishme kushtetuese dhe procedurale. Kjo e metë procedurale e procesit nuk mund të konvalidohet, veçse duke u rigjykuar çështja nga e para dhe duke u marrë vendimet e nevojshme nga gjykata dhe duke u ushtruar kërkesat e nevojshme nga palët për të rregulluar pozicionimin e çdo ndërgjyqësi në rolin e tij natyral procedural. Ekzistenca e këtyre të metave procedurale ndalojnë Gjykatën e Shkallës së Parë, Gjykatën e Apelit, apo edhe Gjykatën e Lartë nga dhënia e një vendimi mbi meritat e çështjes, pasi mungon një ndër prezumimet procedurale të vlefshmërisë së procesit. Pavlefshmëria e plotë e vendimit gjyqësor, që në shkallë të parë, pra ekzistenca e një shkakut që e bën nul gjykimin *ab initio*, përbën një të metë të pakonvalidueshme në shkallë të tjera dhe natyrshëm një e metë e kësaj natyre nuk mund të riparohet gjatë gjykimit në apel, pasi palëve ndërgjyqëse duhet t'u garantohet ushtrimi efektiv i të drejtat procedurale që ofron ligji, përfshirë dhe të drejtën e apelit.

64. Kolegji vlerëson, se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Gjykata Kushtetuese e ka elaboruar këtë element, duke mbajtur qëndrimin se ky element në sensin material, karakterizohet, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të



ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të, t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Gjykimi administrativ, si një gjykim i posaçëm, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 49/2012, i njeh Gjykatës Administrative të Apelit kompetencën funksionale të shqyrtimit të ankimit kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë (kompetencë natyrale për funksion rishikues) dhe gjykimin në shkallë të parë, të mosmarrëveshjeve me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj. Në përputhje me zbatimin komplementar të dispozitave të KPC-së në gjykimin administrativ, neni 467/a i KPC-së përbën të vetmin rast, të parashikuar me ligj, kur Gjykata Administrative e Apelit mund të shqyrtojë çështje si shkallë e parë tej rasteve të parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 49/2012. Kolegji vlerëson, se rregulli i parashikuar në nenin 467/a të KPC-së i referohet rastit kur Gjykata e Apelit prish për herë të dytë vendimin e themelit të gjykatës së shkallës së parë e, në këtë rast, ajo nuk mund ta rikthejë çështjen për rishqyrtim për herë të dytë, por do ta gjykojë vetë si shkallë e parë. E ndryshme paraqitet situata kur çështja i kthehet Gjykatës së Apelit prej Gjykatës së Lartë. Kthimi i çështjes për rishqyrtim nga Gjykata e Lartë nuk konsiderohet si një vendim që detyron Gjykatën e Apelit për ta gjykuar çështjen si shkallë e parë, por për ta gjykuar atë në përputhje me rregullat që parashikohen për gjykimin në apel. Kolegji konstaton se as në KPC dhe as në ligjin nr. 49/2012 nuk ka një parashikim eksplicit që të parashikojë se kur Kolegji Administrativ konstaton pavlefshmëri të plotë, nulitet gjykimi në shkallë të parë, për shkak të mosformimit të rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme, çështja duhet t'i kthehet për rigjykim Gjykatës Administrative të Apelit, e cila duhet të gjykojë si shkallë e parë. Kolegji çmon, se interpretimi i nenit 63 (ç) të ligjit nr. 49/2012, për rastin e vendimeve përfundimtare të gjykatave,

përmes rregullit që parashikohet në nenin 467/a të KPC-së (i cili zbatohet për gjykatën e apelit, kur ajo disponon për herë të dytë për vendimmarrjen e themelit të gjykatës së shkallës së parë), në mënyrë që të jetë në përputhje me parimin e gjykatës së krijuar me ligj dhe me kompetencat funksionale të Gjykatës Administrative të Apelit, do të duhet të ishte parashikuar në ligj.

66. Nga pikëpamja e strukturës së procesit gjyqësor të njohur nga rendi juridik, pavlefshmëria e procesit gjyqësor në shkallë të parë dhe apel, për shkak të formimit jo të rregullt të ndërgjyqësisë nuk mund të riparohet nëpërmjet kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë në gjykatën e shkallës së dytë. Parimi i shkallësisë së gjykimit (neni 135/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), të drejtat dhe detyrimet që kanë palët në secilën shkallë, e drejta e ankimit (neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë) me karakteristikat që ajo ka për secilën shkallë gjykimi, konsiderohen të kompromentuara, pasi kompetenca e gjykimit fillestar në apel nuk njihet shprehimisht edhe për rastet *errores procedendo* (lidhur me ndërgjyqësinë detyrueshme). Një ndërgjyqësi e detyrueshme e perfeksionuar për herë të parë gjatë gjykimit në apel, në mungesë të një parashikimi ligjor, që e lejon në mënyrë të shprehur një gjë të tillë në këtë shkallë, më së paku i heq palës që hyn për herë të parë në proces një shkallë gjykimi për çështje fakti dhe ligji brenda pushtetit gjyqësor, duke i cenuar të drejtën e ankimit dhe duke e vendosur ato në pozita të pabarabarta.

67. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor është një nga të drejtat themelore të individit. E drejta e ankimit e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës duhet kuptuar si një mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim, duke pasur mundësi të barabarta me palët e tjera. Në rastet kur parashikohen instanca të ndryshme të ankimit, atëherë ato duhet të jenë efektive. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kjo alternativë e interpretimit të ligjit, nuk është në përputhje me parimin e garantimit të parimit të shkallësisë së gjykimit dhe të gjykatës së caktuar me ligj.

68. Alternativa e tretë (iii) është që parashikimi i nenit 63 (ç), të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me



ligjin nr. 49/2021, nuk e kufizon kompetencën e Gjykatës së Lartë për ta dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë, vetëm në rastet kur procesi është mbyllur me vendime jopërfundimtare, por edhe në ato raste kur gjykatat administrative kanë shqyrtuar në themel padinë, e cila paraqitet me bashkëndërgjyqësi pasive të detyrueshme të parregullt, Kolegji Administrativ nuk ka pengesë që të disponojë prishjen vendimeve të gjykatave të faktit dhe të kthejë çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë.

69. Kolegji çmon të orientohet drejt mundësisë së interpretimit pajtues së përmbajtjes së nenit 63 (ç) të ligjit nr. 49/2012 me KPC-në, neni 493 (1), dhe rastet e konstatimit të *errores procedendo*, për shkak të formimit të gabuar të ndërgjyqësisë, kur është dhënë një vendim themeli nga ana e gjykatave më të ulëta, për të konkluduar se nga një interpretim tërësor i tyre nuk ka pengesë për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë, atje ku ka lindur e meta procedurale e pakonvalidueshme në shkallë të tjera gjyqësore.

70. Në uniformitet, doktrina dhe jurisprudenca kanë pranuar se ndërgjyqësia e detyrueshme e paperfeksionuar e bën nul gjykimin. Pavlefshmëria e procedurës së gjykimit, për shkak të formimit të gabuar të ndërgjyqësisë, ka natyrë absolute, për shkak se formimi i rregullt i ndërgjyqësisë së detyrueshme në procesin gjyqësor administrativ është një prezumim ligjor pozitiv, pa ekzistencën e të cilit procesi gjyqësor administrativ shuhet që në nisje të tij me pushimin e gjykimit, për shkak të pamundësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjes, veçse kundrejt të gjitha palëve të detyrueshme për t'u thirrur në gjykim me këtë cilësi nga paditësi.

71. Gjykata Administrative, përpara se të fillojë shqyrtimin e çështjes, ka për detyrë të verifikojë, në radhë të parë, kushtet formale të padisë, mosplotësimi i të cilave nuk lejon gjykatën të vijojë me shqyrtimin në themel të çështjes dhe dhënien e një vendimi përfundimtar. Gjykata verifikon: i. nëse ka kompetencë lëndore, tokësore (kur ka kërkesë) dhe funksionale, apo nëse çështja i përket juridiksionit gjyqësor (nenet 7, 9, 10, 11 të ligjit nr. 49/2012); ii. nëse është shteruar rruga e ankimit administrativ (neni 16); iii. nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 49/2012; iv. legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve (neni 15 i ligjit nr. 49/2012 dhe neni 176 i KPC),

afatin e paraqitjes së padisë (neni 18) etj. Kryerja e këtij verifikimi paraprak është i domosdoshëm dhe thelbësor për drejtësinë e vendimmarrjes, por edhe i shërben ekonomisë gjyqësore, ashtu siç shmang investimin e gjykatës në një çështje, qartësisht, pa një të ardhme. Në rastin kur gjykata konstaton mungesën e një prej elementeve të sipërcituara, neni 39, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 49/2012, ka parashikuar shprehimisht edhe mënyrën e disponimit nga gjykata administrative, me vendim jopërfundimtar. Në këtë kuptim, sa herë që ka një proces gjyqësor që preket nga *errores procedendo*, për shkak të formimit të gabuar të ndërgjyqësisë së detyrueshme pasive në shkallë të parë, zbatimi i drejtë i ligjit procedural kërkon që ky proces duhet të mbyllet me një vendim jopërfundimtar, pasi të jetë ndjekur procedura sipas nenit 161(ç) të KPC-së, ose nëse kjo nuk është bërë nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit nuk e ka konstatuar këtë të metë, atëherë duhet të prishen të dyja vendimet e themelit dhe çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë, për formimin e parregullt të bashkëndërgjyqësisë pasive të detyrueshme.

72. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 63 (ç), të ligjit nr. 49/2012, Kolegji vlerëson se i referohet kontrollit që i bëhet vendimmarrjes së gjykatave të faktit, në rastet kur çështja është mbyllur me një vendim jopërfundimtar, në rastet e parashikuara me ligj. Por në rast se gjykatat janë shprehur me vendim përfundimtar, në rastet e mosformimit të rregullt të ndërgjyqësisë së detyrueshme pasive (neni 161 i KPC-së), atëherë procesi është i cenueshëm. Në këtë rast, për shkak se nuk është zhvilluar një proces i rregullt, Kolegji ka të drejtë që të prishë të dyja vendimet përfundimtare dhe ta dërgojë çështjen për gjykim në shkallë të parë, në mënyrë që procesi të ndjekë rrugën e zakonshme që duhej të kishte ndjekur që në fillim të tij, duke zbatuar të gjitha parimet dhe rregullat procedurale nga shkalla e parë e në vijim. Pra, Kolegji vlerëson se kur çështja është mbyllur me një vendim përfundimtar, por procesi gjyqësor preket nga pavlefshmëri që shkaktohet nga formimi i parregullt i ndërgjyqësisë së detyrueshme pasive, procesi është i pavlefshëm dhe vendimi që është marrë nga gjykata nuk është në përputhje me ligjin, pasi i vetmi vendim që duhet të ishte marrë nga gjykata do të duhej të kishte qenë një vendim jopërfundimtar për pushimin e gjykimit, nëse paditësi nuk do të rregullonte ndërgjyqësinë sipas nenit 161(ç) të KPC-së. Pra, kur rezulton se gjykatat



më të ulëta kanë shkelur nenin 161(ç) të KPC-së, shkalla gjyqësore ku mund të rregullohen këto të meta dhe nga ku mund të rifillojë ky proces (rregullimi i bashkëndërgjyqësisë pasive të detyrueshme) është ajo ku është lejuar kjo e metë, pra shkalla e parë.

73. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji rithekson se kur konstatohen paligjshmëri në vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, që lidhen me çështje që janë përfunduar me vendim përfundimtar, por që në zbatim të drejtë të ligjit do të duhet të ishin përfunduar me vendim jopërfundimtar, pushimi, nëse paditësit do të ishte lënë kohë për rregullimin e bashkëndërgjyqësisë pasive të detyrueshme dhe këto të meta nuk do të rregulloheshin prej tij në afat, atëherë Kolegji nuk ka pengese që të prishë të dyja vendimet dhe të dërgojë çështjen për shqyrtim *de novo* në shkallë të parë. Pavarësisht mënyrës së formulimit të nenit 63 (ç) të ligjit nr. 49/2012, Kolegji vlerëson se qëllimi i tij, nuk është të rregullojë vendimmarrjen e Kolegjit vetëm në rastet kur ai haset me rekurse që lidhen me vendime gjyqësore jopërfundimtare, por të rregullojë vendimmarrjen e Kolegjit kur haset me rekurse që kanë të bëjnë me çështje në të cilat nuk është zhvilluar proces gjyqësor në shkallë të parë ose ai ka qenë i pavlefshëm dhe kjo pavlefshmëri nuk mund të rregullohet në shkallë të tjera të gjykimit. Në këto raste, ngjashëm sikur procesi është mbyllur me një vendim jopërfundimtar të parregullt dhe për çështjen nuk ka një gjykim themeli në shkallë të parë, ashtu edhe në rastin e vendimeve përfundimtare të themelit të marra në shkelje të normave të bashkëndërgjyqësisë pasive të detyrueshme, ndodhemi para mungesës së gjykimit në shkallë të parë, për shkak të pavlefshmërisë së gjykimit, prandaj, në zbatim të nenit 63(ç) të ligjit nr. 49/2012, çështja duhet të dërgohet në këtë gjykatë për të vijuar me gjykimin sipas rregullave të përgjithshme të gjykimit.

74. E drejta e Kolegjit për të dërguar çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë mbështetet dhe nga neni 493 (1) i KPC-së, i cili zbatohet në mënyrë komplementare në gjykimin administrativ, për efekt të nenit 1(2) të ligjit nr. 49/2012. Sipas përmbajtjes së këtij neni, Gjykata e Shkallës së Parë, kur dërgohet çështja për rigjykim, zbaton të njëjtat rregulla procedurale të parashikuara në atë shkallë gjykimi. Sa më sipër, KPC-ja, në mënyrë të shprehur njeh mundësinë e Gjykatës së Lartë, që të dërgojë çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë për rigjykim,

ku kjo e fundit, do të duhet t'u përmbahet udhëzimeve dhe detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë.

75. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në përgjigje të pyetjes së dytë të shtruar për njësim, duhet të arrihet në përfundimin njëjës:

“Në ato raste kur gjykatat administrative kanë shqyrtuar në themel padinë e cila paraqitet me bashkëndërgjyqësi pasive të detyrueshme të parregullt, neni 63 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, nuk pengon Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë të prishë të dyja vendimet dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë.”

A. Lidhur me shkaqet e rekursit

76. Kolegji vlerëson se shkaqet e parashtruara në rekurs ngrenë problematika që tregojnë për shkelje të rënda të normave procedurale, me pasoje pavlefshmërinë e procedurës së gjykimit, në kuptim të nenit 58, shkronja “c”, të ligjit nr. 49/2012, të cilat lidhen me mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë së detyrueshme pasive.

77. Ashtu siç është pranuar nga të dyja gjykatat, me aktin e marrjes së tokës në pronësi të datës 20.4.1993, familja e të paditurit Telha Loçka ka marrë në pronësi një sipërfaqe prej 4800 m² tokë arë. Nga certifikata e përbërjes familjare të të paditurit (me shënimin gjendja me datat 1.8.1991 dhe 1.10.1992) rezulton se kjo familje përbëhej me katër persona (bashkëshortja dhe dy fëmijët të vitëlindjeve 1985/1983).

78. Padia e prefektit të Qarkut Tiranë, paraqitur më datë 16.9.2013, është ngritur vetëm ndaj kryefamiljarit Telha Loçka (*paditësi rekursues*). Pavarësisht se Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se Gjykata e Shkallës së Parë i ka thirrur në gjykim të gjithë anëtarët e familjes, nga aktet e gjykimit dhe vendimi i gjykatës nuk rezulton që një veprim i tillë të jetë realizuar.

79. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton nëse bashkëpronarët kanë qenë të paravdekur në kohën e ngritjes së padisë. Në këto kushte, bazuar në konkluzionet e mësipërme, konstatohet se ndërgjyqësia pasive në këtë gjykim është ndërtuar në mënyrë të parregullt, duke mos u thirrur në cilësinë e palës së paditur të gjithë pronarët që tërheqin interesa të ligjshëm nga akti i marrjes së tokës në pronësi.

80. Për sa më sipër, Kolegji çmon që në mbështetje të nenit 63, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, vendimit nr. 2363, datë



20.7.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 2267, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duhet të prishur duke kthyer çështjen për rishqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012, “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 2363, datë 20.7.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 2267, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues.

Ky vendim njësohet botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 14.5.2024.

Kryesues: Sokol Sadushi

Anëtarë: Enkelejda Metaliaj, Asim Vokshi, Gentian Medja

Anëtar kundër: Arbena Ahmeti

MENDIM I GJYQTARIT TË MBETUR NË PAKICË

Gjyqtare: Arbena Ahmeti

Baza ligjore: Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”); Kodi i Procedurës Civile (në vijim “KPC”); ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9948/2008”); vendimi

nr. 29, datë 31.5.2010, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 20/2020”); si dhe neni 35(3) i ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për zgjidhjen e çështjeve ligjore të shtruara dhe të marra në shqyrtim prej Kolegjit Administrativ (në vijim “Kolegji”) në mosmarrëveshjen administrative nr. 31001-1635-2016 akti, në cilësinë e anëtares së trupës, nuk pajtohem me shumicën, duke mbetur votë në pakicë, në lidhje me përcaktimin e rregullit për pyetjen e parë të shtruar për njësim të praktikës gjyqësore dhe me zgjidhjen e çështjes konkrete.

- Rregulli njësohet për praktikën gjyqësore për ndërtimin e ndërgjyqësisë në gjykimet administrative për verifikimin e ligjshmërisë së titujve të pronësisë të dhëna me aktin e marrjes së pronës në pronësi, ku palë paditëse është organi publik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), në vend të prefektit të Qarkut, u vendos prej Kolegjit se duhet të jetë:

“Në paditë administrative me objekt kundërshtimin e ligjshmërisë së akteve të marrjes së tokës në pronësi, të ngritura nga prefekti (sot sukseduar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës), duhet të thirren në cilësinë e të paditurit të gjithë përfituesit e aktit të marrjes së tokës në pronësi, që rezultojnë në certifikatën e gjendjes familjare të datës 1.8.1991 (për ish-kooperativat bujqësore) ose 1.10.1992 (për ish-ndërmarrjet shtetërore).”

1. Pakica është dakord me trajtimin teorik që përcakton në mënyrë të përgjithshme Kolegji për ndërtimin e ndërgjyqësisë, kryesisht, duke mbajtur në konsideratë rregullat procedurale të KPC-së.³ Dhe ligji nr. 49/2012 përcakton, se, *palët*, përfaqësimi, të drejtat dhe detyrat e palëve dhe të përfaqësuesve, përgjegjësia e palëve për shpenzimet dhe për dëmet gjatë procesit, pjesëmarrësit e tjerë në

³ Neni 90 i KPC-së përcakton, se: “Palë në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi. Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe.”

Neni 161 i KPC-së, me titull “Bashkëndërgjyqësia”, përcakton, se: “Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqës), në rast se: a) kanë të drejtat ose detyrimet të përbashkëta mbi objektin e padisë; b) të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e faktit ose e ligjit kanë po atë bazë; c) në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij

të fundit, duke e thirrur si të paditur; ç) nëse vendimi nuk mund të jepet, përveçse kundërshtim shumë personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i të palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës “ç”, të këtij neni, dhe neni 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit” (shtruar shkronja “ç” me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008, dhe shkronja “ç” me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.201).



gjykim rregullohen sipas dispozitave përkatëse të KPC-së, për aq sa ato nuk bien ndesh me përmbajtjen e këtij ligji.⁴

2. Por, Pakica vëren, se *gjykimi administrativ, si lloj i posaçëm gjykimi, ka një tipar dallues thelbësor për sa i përket ndërtimit të ndërgjyqësorisë kryesore pasive*,⁵ pasi në cilësinë e palës së paditur duhet të jetë me domosdo organi publik që ka kryer veprimin, ka heshtur apo ka mosvepruar dhe si rezultat është cenuar e drejta që kërkohet të mbrohet me anë të padisë administrative. Rasti i përcaktuar në nenin 70 të Kodit të Procedurave Administrative⁶ (KPA), në lidhje me dispozitë specifike të ligjeve sektoriale sjell detyrueshmëri dhe ndërtimin e ndërgjyqësorisë kryesore pasive të detyrueshme në gjykimin administrativ. Mënyra e veçantë e të konceptuarit të procesit gjyqësor administrativ, buron nga qëllimi i tij dhe karakteristikat e veçanta që mbart vendimmarrja e organeve të administratës publike në ndryshim nga veprimtaria e individëve privatë. Qëllimi i procesit gjyqësor administrativ është të sigurojë mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike. Kjo mënyrë e të konceptuarit të procesit gjyqësor administrativ, ku përgjithësisht, objekt gjykimi është veprimtaria administrative e organeve publike, vë këtë të fundit në pozitë procedurale të palës së paditur, si subjekti i cili me veprimet apo mosveprimet e tij pretendohet se ka shkelur të drejtat ligjore dhe ndaj të cilit drejtohet kërkimi palës së dëmtuar.

3. Në rastin në gjykim, rezulton që *ndërtimi i ndërgjyqësorisë është në të kundërt të rregullit të përgjithshëm, pasi palë paditëse në gjykimin administrativ është organi publik*. Ligji 49/2012 i ndryshuar përcakton, se të drejtën e ngritjes së padisë e ka *çdo subjekt tjetër, të cilit*

kejo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj.⁷ Më tej, ky ligj përcakton edhe se padia ngrihet *për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ*.⁸ Përveç kushteve të përcaktuara në nenet e këtij kreu, *padia dubet të plotësojë edhe kushtet specifike, të vendosura në ligj, për raste të veçanta*.⁹ Është ligji nr. 9948/2008, që në përmbajtje të tij (neni 10), përcakton të drejtën e padisë të organit publik në gjykatë. **Pra, përtej kushteve të lartpërmendura, të cilat janë të përcaktuara në ligjin nr. 49/2012, është përmbajtja e ligjit nr. 9948/2008 i ndryshuar (neni 10) që ka të përcaktuara të tjera kushte, që duhet të plotësojë padia e prefektit të Qarkut (sot “ASHK”), që të jetë e aftë për gjykimin administrativ.**

4. Ligji, të drejtën e padisë në gjykatë për anulimin/shfuqizimin e titullit të pronësisë,¹⁰ ia ngarkonte *si përgjegjësi administrative*, fillimisht, organit publik, prefektit të Qarkut, në territorin, e të cilit ndodhej prona e disponuar me AMTP-në. Me krijimin e kadastrës, në bazë të ligjit nr. 111/2018¹¹ dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 20/2020¹² kjo përgjegjësi administrative/kompetencë i kaloi organit publik që administron regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, përkatësisht drejtorive vendore të ASHK.¹³ **Neni 10 i ligjit nr. 9948/2008, i ndryshuar,¹⁴ përcakton dhe përmbajtjen e përgjegjësisë administrative për të paraqitur padi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e ligjshmërisë së titullit të pronësisë, AMTP¹⁵, si vijon: “Kur KV -ja, gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe të vendimeve përkatëse të komisioneve të tokës, vëren se krijimi i titullit të pronësisë mbi tokën është dhënë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4 të këtij ligji dhe me vendimet e tij, të marra sipas neneve 8, pikat 2 e 3, dhe 9, pikat 3 dhe 6 të këtij ligji, i paraqet gjykatës së**

⁴ Neni 14 i ligjit nr. 49/2012, titulluar “Të drejtat dhe detyrat e palëve”.

⁵ Rregulli i përgjithshëm në gjykimin administrativ.

⁶ Me titull: “Vendimmarrja e përbashkët e organeve publike”, përcakton se: “1. Kur sipas ligjit, dy ose më shumë organe publike vendosin për një çështje administrative, në kuadër të një procedure administrative të vetme, ato përcaktojnë me marrëveshje organin që do të nxjerrë aktin administrativ të përbashkët, i cili përfshin edhe vendimin e organit tjetër. 2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, secili prej organeve të përfshira merr vendimin, në përputhje me kompetencën përkatëse. 3. Nëse, sipas ligjit, vendimmarrja e një organi publik bazohet në një pëlqim paraprak, konfirmim, miratim ose mendim të një organi tjetër publik, ky i fundit vendos dhe njofton organin publik brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përveç rasteve kur ligji parashikon një afat të ndryshëm. 4. Nëse organi publik, të cilit i lind detyrimi për të dhënë pëlqimin, konfirmimin, miratimin apo mendimin e nevojshëm për miratimin e aktit, nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar në pikën 3, të këtij neni, prezumohet se qëndrimi i tij është pozitiv. 5. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, mosmarrëveshjet lidhur me pikën 1, të këtij neni, zgjidhen sipas nenit 27 të këtij Kodi”.

⁷ Neni 15 i ligjit nr. 49/2012 titulluar “E drejta e padisë”, germa “dh”.

⁸ Neni 17 i ligjit nr. 49/2012 titulluar “Objekti i padisë”.

⁹ Neni 19 i ligjit nr. 49/2012 titulluar “Kushte të tjera”.

¹⁰ Titulli i pronësisë është një akt administrativ, emërtuar prej përmbajtjes së ligjit nr. 7501/1991, i ndryshuar si: Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP).

¹¹ “Për Kadastrën”.

¹² “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

¹³ Dispozita kalimtare, neni 68, pika 3 e në vijim të këtij ligji.

¹⁴ Titulluar “Procedurat për titujt e pronësisë, të krijuar në kundërshtim me ligjin”, ndryshuar me ligjin nr. 58/2012, datë 17.5.2012.

¹⁵ Sille të vëmendje nga pakica, se, me **vendimin unifikues nr. 2, datë 10.3.2014**, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (KBGJL), është përcaktuar dhe gjykata kompetente në lëndë për shqyrtimin e AMTP-së.



rrethit gjyqësor përkatës një kërkesë për anulimin e aktit administrativ, Akt i marrjes së tokës në pronësi. 2. Kërkesa i paraqitet subjektit përkatës nga prefekti i qarkut brenda 7 ditëve nga data e njoftimit të vendimit për paligjshmërinë e aktit të pronësisë mbi tokën bujqësore. Objekt i kërkesës së prefektit është deklarimi i pavlefshmërisë së aktit të marrjes së tokës në pronësi, shfuqizimi i tij dhe kthimi i pronës në pronësi të shtetit, kur ajo posedohet ende nga mbajtësi i parë i titullit, si dhe ngarkimin me detyrimin financiar, kur ky e ka tjetërsuar apo i është shpronësuar për interes publik. 3. Gjykata shqyrton kërkesën e prefektit brenda 60 ditëve, duke thirrur në proces gjyqësor edhe Avokatin e Shtetit.” Kjo dispozitë është nënshtruar kontrollit kushtetues¹⁶ në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor.

5. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 29/10 përcakton, se: “(...) me përfundimin e procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, si dhe në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, me kalimin e afateve përkatëse të kundërshtimit, si dhe me regjistrimin e pronave përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme, përfutjesit nga këto procedura, bëhen mbajtës të titujve të pronësisë, që mbrohen nga neni 41 i Kushtetutës. Për pasojë, midis këtyre individëve, me cilësinë e pronarëve të tokës bujqësore dhe gjithë subjekteve të tjera, duke përfshirë edhe shtetin, krijohet një marrëdhënie që trajtohet në kuadrin e së drejtës private. Kjo do të thotë, se, pas këtij momenti që u përshtua më sipër, çdo pretendim kundrejt pronarëve të mësipërm, zgjidhet në kuadrin e së drejtës private. Për pasojë, titujt e pronësisë të fituar si rezultat i përfundimit të procedurave të parashikuara në ligjet e sipërpërmendura, si dhe regjistrimet e këtyre titujve në regjistrat e pronave të paluajtshme, nuk mund të anulohen, apo të shfuqizohen *iure imperi*, pra në mënyrë të njëanshme, me anën e vendimeve administrative të nxjerra nga autoritetet publike përkatëse. (...)”

6. Gjykata Kushtetuese, po në këtë vendim, në lidhje me pretendimin se ligji nr. 9948/2008 cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, thekson, se: “Ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën

bujqësore”, është në pajtim me Kushtetutën, vetëm nëse ai interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e theksuara prej kësaj Gjykate, pra ai nuk prek titujt e pronësisë të dhënë në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e krijimit të tyre, komisionet vendore janë vetëm konstatuese të pavlefshmërisë, këto komisione nuk mund të anulojnë, apo të shfuqizojnë titujt të pronësisë, apo të urdhërojnë çregjistrimin e këtyre titujve nga regjistri i pasurive të paluajtshme. Është vetëm gjykata, e cila mbi padinë e të interesuarve, apo autoriteteve publike përkatëse, vendos përfundimisht në lidhje me të drejtën e pronësisë së subjekteve të interesuara.”

7. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr. 2/2014, kanë përcaktuar, se: “(...) Nisur nga legjislacioni në lidhje me kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore dhe në përgjithësi legjislacioni ynë i së drejtës administrative, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë sjellin në vëmendje se disa nga kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh, nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadrin të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i së drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik.”, ku dhe është arritur në përfundimin unifikues që: “- Mosmarrëveshjet që burojnë nga aktet e marrjes së tokës në pronësi, që kanë të bëjnë me kundërshtimin e tyre, janë të natyrës administrative, pavarësisht natyrës civile të pasojave që akti i dhënies së tokës në pronësi, apo përdorim, ka sjellë për palët e interesuara. Këto akte, pavarësisht se në thelb krijojnë pasoja që kanë të bëjnë me të drejta civile, siç është edhe e drejta e pronësisë, janë akte të nxjerra nga organet e përcaktuara me ligj për të ushtruar në interesin publik pushtetin e tyre të

¹⁶ Referojnë paragrafit të fundit, faqja 8 dhe paragrafit vijues në faqen 9, të pjesa arsyetuese e vendimit nr. 29/10 të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet se: “Gjykata Kushtetuese në këtë vendim duke qenë se ligji objekt shqyrtimi kushtetues është kundërshtuar në tërësi, megjithatë, nga arsyetimi i kërkesës dhe parashtrimet në Faqe| 22654

seancë gjyqësore, rezulton se kërkesa për shfuqizim lidhet vetëm me nenet 2, 3, 4, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji. Për pasojë, Gjykata duhet të shqyrtojë vetëm kushtetutshmërinë e këtyre dispozitave të ligjit të kundërshtuar.”



dhënë nga ligji, në lidhje me ndarjen e tokës bujqësore. Në këtë rast, këto organe disponojnë mbi të drejta pronësie për pronën publike, duke ndryshuar statusin juridik të saj në pronë private.”

8. Pakica vëren, se Kolegji për të përcaktuar dhe vendos për rregullin për pyetjen e parë të shtruar për njësim të praktikës gjyqësore, arrin në përfundimin, se ligji 9948/2008 i ndryshuar nuk ka rregulluar në mënyrë të posaçme legjitimin pasiv dhe se në analizë të dispozitave të ligjit nr. 7501/1991 dhe akteve nënligjore nuk rezultojnë që kryefamiljari të ketë të drejta përfaqësimi ispo lege në raportet e pronësisë së anëtarëve të tjerë të familjes¹⁷ (shih pg. 40 dhe pg. 43 në pjesën arsyetuese të vendimit). Ndërsa, Pakica sjell në vëmendje që nuk referohet përmbajtja e ligjit në pjesën arsyetuese të vendimit të Kolegjit. **Përmbajtja e ligjit përcakton marrëdhënien juridike që krijohet në bazë të tij dhe rrjedhimisht janë të përcaktuar dhe subjektet e saj. Qartësia, se cilat janë subjekte pjesëmarrëse në marrëdhënien juridike që krijohet në bazë të ligjit, është përcaktuese për legjitimitimin aktiv dhe pasiv të padisë, në zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative.**

9. Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, në nenin 5¹⁸ të tij parashikon, se u jepej tokë në pronësi **familjeve** që ishin anëtare të kooperativës bujqësore, ndërsa në nenin 6 të tij, ky ligj parashikon, se: “*Familjeve me banim në fshat, që nuk janë anëtare të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punojnë e banojnë në ndërmarrjet bujqësore u jepet në përdorim tokë bujqësore.*” Dhe, ligji nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, i cili sipas përcaktimit në nenin 1, kishte për qëllim rregullimin ligjor të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore *familjeve bujqësore*, apo *individëve që e kishin atë në përdorim*. Ky ligj nuk lejonte kalimin në pronësi të tokave bujqësore në zonat që sipas VKM-së nr. 88, datë 1.3.1993, “Për miratimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, ishin përcaktuar si zona që kishin përparësi turizmi, *me përjashtim të familjeve apo*

individëve që kanë përfituar tokë bujqësore si bashkëthemelues të ish-kooperativave apo ndërmarrjeve bujqësore. Sipas këtij ligji dhe rregullimeve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij, *toka bujqësore që kalonte në pronësi duhej që më parë të ishte dhënë në përdorim*.¹⁹

10. Pakica mban në konsideratë parimin e gjykimit administrativ, sipas të cilit Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.²⁰ Vërehet se ligji i posaçëm, nr. **9948/2008, i ndryshuar, që ka** prioritet zbatimi ndaj rregullave të përgjithshme të KPC-së, për sa i përket ndërgjyqësisë në gjykimin administrativ, *kërkon në mënyrë të shprehur që në gjykim, gjykata të thërrasë Avokatit e Shtetit*, përveç palës përfituese prej aktit administrativ, i cili kërkohet të deklarohet i pavlefshëm, pasi është disponuar tokë bujqësore, në kundërshtim me ligjin. *Pala përfituese prej përmbajtjes së aktit administrativ dhe ligjit me nr. 7501/1991, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore zbatuese të tij, është familja bujqësore* (neni 5 i ligjit nr. 7501/1991 dhe akteve nënligjore përkatëse). Në titullin e pronësisë, AMTP-ja, që është akt administrativ dobipurës, është shënuar si mbajtës i drejtave të përfituara, vetëm kryefamiljari i familjes bujqësore. Ndërsa ligji nr. 7501/1991 përcakton se volumi i të drejtave dhe i detyrimeve të marrëdhënies së pronësisë i takojnë *subjektit, familja bujqësore*, anëtare e kooperativës bujqësore. Ndaj, Pakica ndan qëndrimin se, kur norma ka përmbajtje të qartë, nuk mundet me anë të metodave të interpretimit të arrihet në një përfundim të ndryshëm, vetëm për të bërë rregullin njësoj të praktikës gjyqësore.

11. Pakica vlerëson, se nuk ka një dispozitë ligjore që të përcaktojë në mënyrë të shprehur dhe urdhëruese/detyruese se në këtë lloj kategorie të gjykimit administrativ, duhet të thirren të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, në cilësinë e palës së paditur. Pra, nuk jemi përpara situatës që me ligjin e

¹⁷ Shënim. Është perifrashuar prej pakicës pjesa arsyetuese midis pg. 40–pg. 43 të vendimit të Kolegjit.

¹⁸ Neni 5 i ligjit nr. 7501/1991 përcakton, se: “**Familjet anëtare të kooperativës bujqësore**, pas ndarjes së tokës kanë të drejtë të shpërbërjes dhe të dalin subjekt më vete, duke marrë në pronësi tokën bujqësore që u takon nga tërësia e subjektit ku bëjnë pjesë. Sasia dhe vendi ku do të jepet toka, përcaktohet nga komisioni i tokës. Në zonat kodrinore e malore, ku familjeve fshatrave nuk u sigurohet sipërfaqja e nevojshme e tokës bujqësore, shteti merr masa dhe u garanton burime të tjera jetese nëpërmjet subvencioneve, shtimit të investimeve Për punësimin e

njerëzve, vendosjes së asistencës sociale dhe lëvizjes së kontrolluar të popullatës, në bazë të një programi të caktuar nga Këshilli i Ministrave.”

¹⁹ E njëjta analizë ligjore citohet dhe në përmbajtjen e vendimit unifikues nr. 2, datë 10.3.2014, të KBGJL-së, në pg. 30 të pjesës arsyetuese.

²⁰ Neni 17, pg. 2 i ligjit nr. 49/2012.



posaçëm është krijuar bashkëndërgjyqësi e detyrueshme dhe duhet të mbahet në konsideratë që ky lloj gjykimi nuk duhet ngatërruar me gjykimin civil, ku mosmarrëveshja lidhet me të drejta që burojnë prej titullit të pronësisë që gëzohet në bashkëpronësi.

12. Objekti i gjykimit administrativ, në këtë lloj kategorie mosmarrëveshjesh, është i natyrës deklarative. *Kjo pasi hetimi gjyqësor mbetet i fokusuar ngushtësisht rreth hetimit administrativ, që ka zhvilluar organi publik, sipas përmbajtjes së ligjit me nr. 9948/2008, i ndryshuar, dhe nuk mund të zgjerohet apo ngushtohet. Ndërkohë, në gjykimin civil, gjykata nuk ka asnjë kufi për hetimin gjyqësor dhe palët ndërgjyqëse mund të parashtrojnë të gjitha prapësimet e mundshme. Gjithashtu, karakteristikë në këtë kategori të gjykimit administrativ është, se pasojat e paligjshmërisë ardhur prej AMTP-së së nxjerrë në kundërshtim me ligjin nuk i rregullon gjykata në mënyrë të pavarur, por i ka rregulluar në mënyrë të shprehur ligji i posaçëm. Çdo disponim i gjykatës është i kushtëzuar sipas përmbajtjes së hipotezës së normës specifike në ligjin e posaçëm. Në të tillë mënyrë vendimmarrja e gjykatës i shtrin efektet te të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, për shkak të rregullimit ligjor dhe nuk kushtëzohet prej faktit nëse kanë marrë pjesë apo jo të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, si palë të paditura në gjykim.* KPC-ja përcakton se, kur, për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike që janë në konflikt ose për shkak të një dispozite ligjore, efekti i vendimit, që do të jepet, shtrihet në të gjithë bashkëndërgjyqësit, veprimet procedurale që janë kryer prej disa bashkëndërgjyqësve kanë efekt edhe për bashkëndërgjyqësit e tjerë që nuk janë paraqitur në gjykatë ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar.²¹

13. Gjykatat administrative të faktit, në këtë lloj gjykimi, kanë detyrë të orientojnë palën paditëse për rregullimin e ndërgjyqësisë, mbi thirrjen në gjykim të të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore dhe, nëse pala paditëse nuk i thërret, gjykata mund t'i thërrasë, kryesisht, në cilësinë e personit të tretë, që të vijnë në gjykim dhe të marrin dijeni. *Pakica vlerëson se, nëse do të ndodhë që gjykata administrative pushon gjykimin, se pala paditëse nuk ka thirrur si palë të paditur të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, siç edhe orienton Kolegji në vendimmarrjen e tij, kjo situatë procedurale do të binte në*

kundërshtim të hapur me qëllimin e ligjit nr. 9948/2008, i ndryshuar, duke mos i dhënë përparësi interesit publik, që një akt administrativ i paligjshëm (AMTP titull pronësie) të deklarohet si i tillë, por të vijojë pasiguria juridike²² mbi titujt e pronësisë, vetëm për një të metë procedurale.

14. Por, edhe nëse gjykata nuk ka thirrur kryesisht në cilësinë e personit të tretë në gjykim, anëtarët e familjes bujqësore, Pakica vlerëson se, kjo situatë e nuk përbën shkak sipas germës “c”, të nenit 58, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, pra nuk përbën shkelje të rëndë procedurale, e cila ndikon dukshëm në dhënien e vendimit, pasi siç edhe më lart arsyetohet:

- hetimi gjyqësor në këtë lloj gjykimi administrativ është i përcaktuar dhe lidhet ngushtësisht prej hetimit administrativ, që ka kryer organi administrativ kolegial, pranë Prefektit të Qarkut dhe prej përmbajtjes së ligjit me nr. 9948/2008, i ndryshuar; dhe

- ligji ka përcaktuar në mënyrë të shprehur se si rregullohen pasojat e krijuara prej dhënies së tokës bujqësore familjes bujqësore, sipas aktit administrativ, AMTP-së, që është konstatuar në kundërshtim me ligjin me nr. 7501/1991 dhe aktet nënligjore zbatuese të tij.

14. Ndaj dhe përfundimi që arrin gjykata administrative në dhënien e vendimit, në këtë lloj gjykimi²³, nuk kushtëzohet dhe as lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me veprimin procedural të thirrjes apo jo të të gjitha anëtarëve të familjes bujqësore në gjykim, rrjedhimisht as mund të ndikojë në mënyrë thelbësore dhënien e vendimit. Gjykata administrative duhet të tregojë kujdes maksimal që të verifikojë në këtë lloj gjykimi, se gjatë procedurës administrative të zhvilluar prej organit publik, janë respektuar të drejtat e palës në procedurë, sipas parimeve të KPA-së, në raport me të drejtat e njohura sipas ligjit me nr. 9948/2008, i ndryshuar, dhe që është zhvilluar hetimi administrativ që ligji dhe aktet nënligjore përcaktojnë. Pala, në procedurën administrative, në këtë rast është subjekti përfitues i tokës bujqësore, *pra familja, anëtare e kooperativës bujqësore.*

15. Ndërgjyqësia në gjykimin administrativ rregullohet në zbatim të nenit 15 dhe nenit 17 të ligjit

²¹ Pg. 2 i nenit 162 të KPC-së.

²² Pasi me vendimin përfundimtar të një organi publik është konstatuar situata e paligjshmërisë së titullit të pronësisë, në përfundim të hetimit administrativ, kryer në mbështetje të ligjit nr. 9948/2008 i ndryshuar.

²³ Gjykimi i padisë administrative të prefektit/ASHK-së në ushtrim të përgjegjësiwe administrative, sipas nenit 10 të ligjit nr. 9948/2008, i ndryshuar.



të posaçëm për gjykimin administrativ²⁴ dhe në logjikën e zbatimit të parimit themelor procedural/material, që në gjykatë përgjigjet për cenimin e pretenduar ai/ajo që ka shfaq vullnet në ardhjen e pasojës ose ka lejuar të vijë, duke mos ndërmarrë veprimet që e detyron ligji. Në rrjedhim të këtij parimi, në rastin objekt shqyrtimi është e pakuptimtë të përcaktosh se vullneti i shtetasve të ketë ndikuar në mënyrë thelbësore në nxjerrjen e aktit, apo kryerjen e veprimit administrativ, AMTP-së, pasi dhe ligji i posaçëm nr. 7501/1991, i ndryshuar “Për token”, i jep autoritet vendimmarrës vetëm organit/zyrtarit përgjegjës. Pakica ka parasysh dhe rregullimin e bërë në nenin 114 të KPA-së, i cili përcakton: “1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet, apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë. 2. Nëse pala përfituese është në mirëbesim, një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet. 3. Pala përfituese nuk vlerësohet se është në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit ose nuk ka qenë në dijeni të tyre, për shkak të pakujdesisë së rëndë, apo nëse akti është nxjerrë, bazuar në informacionin materialisht të gabuar, apo jo të plotë të dhënë, me faj, nga vetë pala.”

16. Si përfundim, Pakica i qëndron vlerësimit të vazhdueshëm, që ndërgjyqësia pasive në gjykimin administrativ, që ka për objekt shqyrtimi, padinë administrative që lidhet me ushtrimin e përgjegjësive të Prefektit të Qarkut (kompetencë ligjore që i ka kaluar ASHK-së me ligjin me nr. 20/2020 në raport dhe me ligjin me nr. 111, datë 7.2.2018), në bazë të nenit 10 i ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, i ndryshuar, nuk është bashkëndërgjyqësi e detyrueshme. Pakica vlerëson, se ndërgjyqësia pasive e detyrueshme në këtë kategori të mosmarrëveshjeve administrative do të binte ndesh me parimin themelor të gjykimit administrativ, të realizimit të gjykimit në afate sa më të shpejta dhe të arsyeshme.²⁵

- Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete:

²⁴ Ligji nr. 49/2012 i ndryshuar, dispozitat e mësipërme përbëjnë rastin e parashikimit ligjor i ndryshëm nga ndërgjyqësia në KPC, në mbështetje të nenit 1, pg. 2, të po këtij ligji.

²⁵ Neni 3, pg. 1 i ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar përcakton, se: “Gjykata, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen

1. Për sa më lart, u arsyetua në lidhje me shkaqet e parashtruara në përmbajtje të rekursit, Pakica vlerëson, se nuk gjejnë mbështetje në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, dhe mbi to duhet të disponohet për lënien në fuqi të vendimmarrje së Gjykatës Administrative të Apelit, për sa kohë që nuk gjendet asnjë shkak për cenim.

2. Megjithatë, vërehet, se Kolegji nuk ka zbatuar në zgjidhjen e çështjes konkrete as rregullat procedurale në dispozitat kalimtare. Pasi vërehet se dispozitat procedurale,²⁶ ku Kolegji ka mbështet analizën ligjore, kanë pësuar ndryshime thelbësore në vitin 2017, me ligjin nr. 38/2017 dhe rekursi ka qenë regjistruar në Gjykatë të Lartë, më datë 3.10.2016. Dispozita kalimtare²⁷ përcakton se çështjet civile, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit, ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë. Çështjet civile, që shkojnë për gjykim në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të gjykohen sipas dispozitave ligjore, që janë në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit ose të rekursit.

3. Pakica ka qëndrim që është detyrë e Kolegjit të orientojë drejtë dhe në mënyrë të qartë praktikën gjyqësore, në lidhje me situatat e ndryshme të gjykimit, për sa u përket ndryshimeve ligjore procedurale, në raport me rregullat kalimtare, që rregullojnë ndërgjyqësinë e detyrueshme, meqenëse arriti në atë rregull njësuës.

Tiranë, më 14.5.2024.

Gjyqtare: Arbena Ahmeti

juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike”.

²⁶ Neni 161 i KPC-së.

²⁷ Parashikuara me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017.



VENDIM
Nr. 43, datë 30.9.2025

Në zbatim të nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 55, pika 9, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, të ndryshuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike në mbledhjen e tij, sipas rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore”.

2. Shfuqizimin e rregullores nr. 4, datë 29.3.2018, “Për investigimin dhe procedurat e marrjen e masave disiplinore”, e ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Dritan Fino

Anëtarë: Adriana Berberi, Luan Abazi, Martin Mici, Gjergji Duro

RREGULLORE
PËR INVESTIGIMIN DHE PROCEDURAT
PËR MARRJEN E MASAVE DISIPLINORE

*Miratuar me vendimin nr. 43, datë 30.9.2025,
të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.*

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Procesi i investigimit dhe vendosja e sanksioneve, dhe masave disiplinore kanë për qëllim zbulimin, korrigjimin e parandalimin e shkeljeve dhe sjelljeve të papajtueshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Kjo rregullore ka për qëllim:

a) përcaktimin e kërkesave ligjore që lidhen me investigimin dhe marrjen e masave disiplinore nga ana e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP);

b) përcaktimin e parimeve për vendosjen e masave disiplinore jo me qëllim ndëshkimit, por mbrojtjen e interesit të publikut, nëpërmjet një sistemi efektiv dhe proporcional;

c) përcaktimin e parimeve të përgjithshme të funksionimit, mënyrës së funksionimit të procesit të investigimit dhe të marrjes së masave disiplinore nga ana e BMP-së, si dhe përbërjes të komisioneve të investigimit dhe disiplinës të ngritura pranë organizatave profesionale, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 55, pika 9, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për procedurat dhe masat disiplinore të marra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike ndaj:

a) Audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;
b) Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë (IEKA);

c) Subjekteve të tjera që janë drejtpërdrejtë ose indirekt, objekt i mbikëqyrjes së BMP-së, që shkelin dispozitat e ligjit për auditimin ligjor.

2. Kjo rregullore parashikon, gjithashtu:

a) rregullat për investigimin e shkeljeve dhe sjelljeve të papajtueshme të audituesve ligjorë, shoqërive të auditimit, Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë (IEKA), si edhe subjekteve të tjera të mbikëqyrjes, bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi;

b) procedurat për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë BMP-së;

c) procedurat administrative të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore, si dhe përcaktimin e masës së gjobës brenda kufijve respektivë të nenit 55, pika 5, të ligjit për auditimin.



Neni 4

Përkufizime dhe shkurtime

1. Shkurtime e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

BMP: Bordi i Mbikëqyrjes Publike, autoriteti kompetent për marrjen e masave disiplinore, përgjegjës për mbikëqyrjen e audituesve ligjorë, shoqërive të auditimit dhe organizatave profesionale, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 5.3.2009, të ndryshuar;

KIDB: Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës i ngritur nga BMP-ja, për të trajtuar rastet e shkeljeve ose sjelljeve të papajtueshme të subjekteve të mbikëqyrjes;

Subjekte të mbikëqyrjes: audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit, Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë (IEKA), organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar, si edhe çdo person fizik apo juridik që vepron në kundërshtim me ligjin për auditimin ligjor dhe është drejtpërdrejtë ose indirekt, objekt i mbikëqyrjes së BMP-së;

Shkelje ose sjellje të papajtueshme: Çdo veprim apo mosveprim nga subjektet e mbikëqyrjes, që janë në mospajtueshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator për auditimin, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe sigurisë, parimet e etikës profesionale dhe kërkesat përkatëse të kodit të etikës, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit për auditimin;

Burim i hapur: Në kontekstin e informacionit, zakonisht i referohet informacionit që është i disponueshëm publikisht, i arritshëm dhe falas për t'u përdorur. Informacioni me burim të hapur konsiderohet kur:

a) është i disponueshëm lirisht për publikun (p.sh.: në internet, në libra, media, etj.);

b) mund të përdoret, shpërndahet dhe analizohet nga kushdo;

c) nuk kërkon leje të veçantë ose të drejta aksesit.

2. Të gjitha termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në nenin 2 të ligjit për auditimin.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË INVESTIGIMIT DHE DISIPLINËS PRANË BMP-së DHE BASHKËRENDIMI ME KOMISIONET E ORGANIZATAVE PROFESIONALE

Neni 5

Ngritja e Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës së BMP-së

1. Me qëllim zbatimin e rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore dhe aktet nënligjore, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës i BMP-së (KIDB).

2. KIDB-ja shqyrton rastet dhe zhvillon procedura të pavarura investigimi dhe discipline ndaj audituesve ligjorë, shoqërive të auditimit, Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë (IEKA) dhe të çdo subjekti tjetër, që kryejnë shkelje ose sjellje të papajtueshme me ligjin për auditimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Ngritja, funksionimi i KIDB-së, si edhe kriteret e anëtarëve përcaktohen në rregulloren për organikën e strukturës mbështetëse.

4. Anëtarët e komisionit do të konfirmojnë pavarësinë për shmangien e konfliktit të interesit nga:

a) subjekti i investigimit;

b) personat e lidhur ose të interesuar me rastin në investigim.

5. Në rastin e konfliktit të interesit, anëtarët e komisionit duhet të tërhiqen menjëherë nga rasti, duke paraqitur arsyen e këtij konflikti interesi.

Neni 6

Objekti i veprimtarisë së KIDB-së

1. KIDB-ja ka si objekt të veprimtarisë:

a) shqyrtimin e ankesave të paraqitura, pranë BMP-së, ndaj audituesve ligjorë, shoqërive të auditimit, Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë (IEKA), si edhe për subjektet e tjerë, në përputhje me fushëveprimin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin e auditimit ligjor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të identifikuara në kuadër të kontrollit të sigurimit të cilësisë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit;



c) shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të identifikuar, në kuadër të mbikëqyrjes së Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë.

2. Objekt i veprimtarisë së KIDB-së janë edhe të gjitha rastet e tjera të parashikuara në këtë rregullore që çojnë në nisjen e një procedure investigimi.

3. KIDB-ja harton dhe i paraqet BMP-së, brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë, lidhur me rastet e shqyrtuara dhe masat e propozuara, ku përfshihen:

a) një përshkrim për aktivitetin e kryer dhe rastet e shqyrtuara gjatë periudhës raportuese;

b) një përmbledhje të shkeljeve të identifikuar, lidhur me:

i. kuadrin ligjor dhe rregullator për auditimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

ii. kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës, të shpallur të detyrueshëm për zbatim;

iii. standardet ndërkombëtare të auditimit dhe sigurisë;

c) rekomandimet dhe masat e ndërmarra;

Neni 7

Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë (KID)

1. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë vë në funksionim një sistem efikas investigimi dhe monitorimi të disiplinës, si dhe respekton procedurat e kryerjes së investigimit, me qëllim zbulimin, korrigjimin dhe parandalimin e mangësive, që mund të vërehen gjatë kryerjes së shërbimit të auditimit ligjor dhe të shërbimeve profesionale të tjera dhe të lidhura nga audituesit ligjorë.

2. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë harton rregulloren për investigimin dhe procedurat e masave disiplinore dhe funksionimin e komisionit të investigimit dhe disiplinës të ngritur pranë saj, në përputhje me ligjin për auditimin, akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, si edhe këtë rregullore.

3. Rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore miratohen nga bordi, sipas propozimit të këshillit drejtues. Para miratimit, BMP-ja jep mendimin lidhur me këtë rregullore, i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar.

4. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë krijon Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës

(KID), me qëllim kryerjen e investigimit për aspekte brenda objektit të vet.

5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni duhet të jetë në përputhje me ligjin për auditimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe këtë rregullore.

6. KID-ja ka si objekt të veprimtarisë:

a) Shqyrtimin e ankesave të paraqitura ndaj anëtarëve të organizatës profesionale dhe kryen investigimin e rasteve të shkeljeve të standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse të etikës;

b) Shqyrtimin e rasteve të shkeljeve ose sjelljeve, të anëtarësisë së saj, që dëmtojnë reputacionin, sjelljet dhe komunikimet publike të papërshtatshme, veprimet dhe mosveprimet si rrjedhojë e neglizhencës profesionale, shkeljet e dispozitave të statutit dhe rregulloret e brendshme të organizatës;

c) Shqyrtimin dhe propozimin e masës disiplinore, pranë BMP-së, të rasteve të shkeljeve të identifikuar, në kuadër të delegimit të kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë për audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese;

ç) Shqyrtimin e rasteve për investigim me kërkesë të BMP-së.

7. Në rastin e konfliktit të interesit, anëtarët e komisionit duhet të tërhiqen menjëherë nga rasti, duke paraqitur arsyen e këtij konflikti interesi.

8. KID-ja harton raportin vjetor të veprimtarisë, lidhur me rastet e shqyrtuara dhe masat e propozuara, ku përfshihen:

a) Një përshkrim për aktivitetin e kryer dhe rastet e shqyrtuara gjatë periudhës raportuese;

b) Një përmbledhje të shkeljeve të identifikuar, lidhur me:

i. shkeljet e standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse të etikës;

ii. shkeljet ose sjelljet, e anëtarësisë së saj, që dëmtojnë reputacionin, sjelljet dhe komunikimet publike të papërshtatshme dhe në mospajtueshmëri me parimet themelore të Kodit të Etikës, veprimet dhe mosveprimet si rrjedhojë e neglizhencës profesionale, shkeljet e dispozitave të statutit dhe rregulloret e brendshme të organizatës;

iii. rastet e shkeljeve të identifikuar në kuadër të delegimit të kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit.

c) Rekomandimet dhe masat e ndërmarra;

9. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë dërgon raportin vjetor të KID-së pranë BMP-së,



brenda 3 (tre) mujorit të parë të vitit pasardhës. BMP-ja mund të japë rekomandime për përmirësim ose, në raste të veçanta, të kërkojë rishqyrtim të çështjeve të trajtuara.

Neni 8

Propozimi i masave disiplinore nga organizata profesionale

1. Komisioni i disiplinës, i cili funksionon pranë Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, i drejtohet Bordit të Mbikëqyrjes Publike, duke i vënë në dispozicion edhe dokumentacionin përkatës që vërteton shkeljen që bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit për auditimin apo të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

2. Propozimi duhet të përmbajë të paktën informacionin, si më poshtë:

a) përshkrimin e procedurave të ndjekura nga KID-ja dhe të dispozitave të kuadrit ligjor dhe rregullator ku janë mbështetur këto procedura;

b) dokumentacionin mbështetës për procedurat e ndjekura;

c) përshkrimin e shkeljes dhe dispozitave të ligjit për auditimin apo të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij;

ç) dokumentacionin që vërteton shkeljen së bashku me një relacion shpjegues në lidhje me shkeljen e evidentuar;

d) masa e propozuar, në përputhje me nenin 55 të ligjit për auditimin dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

3. BMP-ja ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme, në përputhje me këtë rregullore, për të siguruar evidencën e duhur dhe dokumentacionin mbështetës në funksion të shqyrtimit të propozimit.

4. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë duhet të dorëzojë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga BMP-ja.

5. Bordi nuk do të marrë vendim lidhur me propozimet për masa disiplinore për të cilat Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë ka kompetencën për të vendosur masa ndaj anëtarëve të saj, për aspekte brenda objektit të rregullave të brendshme të saj.

6. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij neni, nga ana e BMP-së do të zbatohen masat disiplinore, në përputhje me nenin 55/2 të ligjit për auditimin dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 9

Komisionet e Investigimit dhe Disiplinës të organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar

1. Organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar (OPKM) hartojnë rregulloret për investigimin dhe procedurat e masave disiplinore dhe funksionimin e komisioneve të investigimit, dhe disiplinës të ngritura pranë tyre, në përputhje me ligjin për auditimin, kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje.

2. Komisionet e investigimit dhe disiplinës të organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar funksionojnë dhe realizojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me rregullat e brendshme të Organizatës Profesionale të Kontabilistëve të miratuar dhe rregullat për vendosjen dhe zbatimin e masave disiplinore ndaj anëtarësisë së tyre.

3. Me kërkesë të BMP-së, komisionet e organizatës shqyrtojnë rastet, kryejnë investigimin dhe marrin masat disiplinore në përputhje me rregullat e brendshme të Organizatës Profesionale të Kontabilistëve të miratuar dhe rregullat për vendosjen dhe zbatimin e masave disiplinore ndaj anëtarësisë së tyre. Në përfundim të shqyrtimit të rastit, OPKM-të informojnë BMP-në për masat e marra.

KREU III

PROCEDURAT E INVESTIGIMIT

Neni 10

Shkeljet ose sjelljet e papajtueshme që çojnë në fillimin e investigimit dhe marrjen e masave disiplinore

1. Në përputhje me këtë rregullore trajtohen të gjitha çështjet që lidhen me shkelje ose sjellje apo veprim të papajtueshëm.

2. Me shkelje ose sjellje të papajtueshme nënkuptohet çdo veprim apo mosveprim i audituesit ligjor ose shoqërisë audituese, Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë apo subjekte të tjera të mbikëqyrjes, që bie ndesh me kuadrin ligjor dhe rregullator për auditimin, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe sigurisë, parimet e etikës profesionale dhe kërkesat përkatëse të kodit të etikës, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:



a) shkeljen ose mospajtueshmërinë me dispozitat e ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

b) shkeljen ose mospajtueshmërinë me dispozitat e ndonjë ligji tjetër dhe akteve të tjera ligjore për të cilat ka detyrimin të zbatojë gjatë ofrimit të shërbimeve profesionale si auditues ligjor ose shoqëri audituese;

c) shkeljen ose mospajtueshmërinë me Kodin e Etikës të shpallur të detyrueshëm për zbatim nga BMP-ja;

ç) shkeljen, sjelljen apo veprimtarinë që cenon interesin publik, integritetin, etikën ose imazhin e profesionit të auditimit ligjor;

d) shkeljen apo sjelljen e papajtueshme që dëmton ndjeshëm reputacionin e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese;

dh) veprimin në mënyrë të pandershme gjatë kryerjes së ndonjë pune apo detyre që i takon audituesit ligjor, në lidhje me:

i. shërbimet profesionale si auditues ligjor ose shoqëri audituese;

ii. çdo detyrë të marrë përsipër ose të pranuar nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese;

e) raste të neglizhencës profesionale apo moskryerjen e shërbimeve profesionale, apo detyrave me shkallën e duhur të kompetencës profesionale, kujdesit dhe aftësisë së duhur, që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme sipas vlerësimit objektiv të BMP-së;

ë) në përfundim të vlerësimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë është vlerësuar jokënaqshëm;

f) shkeljen e statutit dhe rregullave të brendshme të organizatave profesionale;

g) rastin/et kur nuk i përgjigjet ose nuk e trajton në mënyrë të përshtatshme brenda një afati të arsyeshëm çdo korrespondencë apo komunikim tjetër nga BMP-ja, që kërkon një përgjigje apo veprim;

gj) nuk përmbush brenda një kohe të arsyeshme një urdhër, kërkesë ose thirrje të BMP-së;

h) në rast ndërprerjeje të kontratës ose dorëheqjeje të audituesit ligjor, ku ky i fundit nuk arrin të dorëzojë të gjitha librat, dosjet e angazhimit dhe dokumentet që janë pronë e njësisë ekonomike dhe që ndodhen ose që mund të vijnë në zotërim të audituesit ligjor, ose shoqërisë audituese, te njësia ekonomike ose te kontabilisti i miratuar ose audituesi ligjor pasardhës, kur njësia ekonomike e kërkon këtë;

i) heq dorë nga ushtrimi i profesionit si auditues ligjor, pa njoftim paraprak për klientët e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese dhe pa marrë masa për të siguruar trajtimin e çështjeve të klientëve apo ruajtjen e pronës së tyre që ndodhet në zotërimin ose nën kontrollin e audituesit ligjor, ose shoqërisë audituese;

j) mospërmbushja e detyrimeve ndaj BMP-së nga organizatat profesionale, përfshirë detyrimet financiare, të cilat cenojnë vijimësinë e veprimtarisë së BMP-së dhe mbrojtjen e interesave të publikut;

k) nuk arrin pas kërkesës të shlyejë pagesat e detyrueshme ndaj BMP-së dhe/ose Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë;

l) mosdhënia e informacionit ose dhënia e informacionit të pasaktë nga Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë.

Neni 11

Mënyrat e nisjes së procedurës së investigimit

1. Procesi i investigimit fillon në një nga rastet e mëposhtme:

a) **Investigim bazuar në ankesë:** Procesi i investigimit nis si rezultat i një ankese të paraqitur nga individë apo persona juridikë ndaj subjekteve të mbikëqyrjes nga BMP-ja, në lidhje me veprimtarinë apo sjelljen e tyre profesionale;

b) **Investigim bazuar në informacionin e marrë si rrjedhojë e procesit të kontrollit të cilësisë:** Procesi i investigimit nis kur nga procesi i kontrollit të sigurimit të cilësisë, të realizuar pranë audituesve ligjorë ose shoqërive audituese, identifikohen mangësi apo shkelje të dispozitave të ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

c) **Investigim bazuar në informacionin e marrë nga burime të hapura:** Procesi i investigimit nis si rrjedhojë e marrjes së informacionit nga burime të hapura, të cilat mund të përbëjnë rrethana për shkelje ose sjellje të papajtueshme nga subjektet e mbikëqyrjes.

2. Nisja e procedurës së investigimit kryhet me vendim të KIDB-së.



Neni 12

Investigimi mbi bazë ankese

1. Ankesat e ardhura pranë BMP-së duhet të paraqiten në formë elektronike ose shkresore pranë BMP-së, në adresat zyrtare të publikuara në faqen e saj.

2. Ankesa duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme për faktet dhe rrethanat e shkeljes ose sjelljes së papajtueshme, mbi të cilën mund të gjykohet për kryerjen e një procesi investigimi, me të dhënat si më poshtë:

a) Të dhëna mbi ankuesin: emër, atësia, mbiemër, kopje të kartës së identitetit, adresa e plotë e banimit apo vendit të ushtrimit të veprimtarisë, adresa e postës elektronike dhe numrin e telefonit;

b) Të dhëna mbi subjektin e mbikëqyrjes ndaj të cilit paraqitet ankimi;

c) Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara dhe periudhën e ndodhjes së tyre;

c) Dokumentet apo burimet mbështetëse të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara;

d) Çdo dokument tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga ankuesi.

3. KIDB-ja, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit të ankesës, do të shqyrtojë paraprakisht çdo ankesë të paraqitur dhe do të vlerësojë nëse duhet të fillojë procedurën e investigimit.

4. KIDB-ja nuk do të fillojë procedurën e investigimit në rastet, kur:

a) objekti i ankesës është jashtë objektit të veprimtarisë së KIDB-së;

b) ankesa është paraqitur në formë anonime;

c) nuk përmban të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;

ç) objekti i ankesës ka të bëjë me çështje të cilat janë shqyrtuar më parë;

d) procedura e investigimit dhe vendimmarrja lidhur me të cenon procese të cilat janë në shqyrtim nga organet e drejtësisë, gjykatat ose prokuroria, për të cilat nuk ka vendim të formës së prerë;

dh) rrethana të arsyetuara bazuar në kuadrin ligjor për auditimin dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

5. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, ankuesi mund të plotësojë dokumentacionin mbështetës me dokumente të tjera që ai i gjykon të arsyeshme ose që mund t'i kërkojnë nga struktura

mbështetëse e BMP-së në funksion të shqyrtimit të ankesës. KIDB-ja, sipas rastit, zhvillon seanca dëgjimore me palët e përfshira në proces.

6. Personeli i strukturës mbështetëse i përfshirë në procesin e marrjes dhe shqyrtimit të ankesave ruan konfidencialitetin e plotë të rastit dhe të të dhënave të ankuesit.

7. Informacioni dhe dokumentacioni i siguruar në kuadër të procesit të investigimit është konfidencial dhe do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë informacioni.

8. KIDB-ja njofton me shkrim, brenda 7 (shtatë) ditë pune, nëpërmjet strukturës mbështetëse, të gjitha palët e përfshira dhe të interesuara në proces, për nisjen e procedurës së investigimit.

9. KIDB-ja njofton me shkrim, brenda 10 (dhjetë) ditë pune, nëpërmjet strukturës mbështetëse të BMP-së, ankuesin lidhur me rezultatet e shqyrtimit të ankesës, kur vlerëson se nuk do të nisë procedurë investigimi.

Neni 13

Investigimi bazuar në informacionin e marrë si rrjedhojë e procesit të kontrollit të cilësisë

1. Procedura e investigimit bazuar në informacionin e marrë si rrjedhojë e procesit të kontrollit të cilësisë, bazohet në rrethana të konstatuara dhe të raportuara nga inspektorët e lartë të kontrollit të sigurimit të cilësisë, të cilat mund të përbëjnë shkelje ose sjellje të papajtueshme të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese, subjekt i kontrollit.

2. Inspektorët e lartë të kontrollit të sigurimit të cilësisë sigurojnë informacionin paraprak, lidhur me çështjet që mund të shtrihen në periudha të cilat nuk mbulohen nga periudha që mbulon kontrolli i sigurimit të cilësisë.

3. Investigimi bazuar në këto informacione do të fillojë pas përfundimit të vlerësimit, në kuadër të procesit të kontrollit të cilësisë.

Neni 14

Investigimi bazuar në informacionin e marrë nga burime të hapura

1. Në rastet kur BMP-ja disponon informacione të marra nga burime të hapura, të cilat ngrenë dyshime të arsyeshme për shkelje të mundshme të



subjekteve të mbikëqyrjes, KIDB-ja shqyrton rrethanat dhe vlerëson për nisjen e procedurës së investigimit.

2. Procedura e investigimit mbi bazën e informacioneve të marra nga burime të hapura, pavarësisht se nuk vjen si ankesë, përfshin si veprimtarinë profesionale të subjektit, ashtu dhe veprimet ose mosveprimet për mënyrën sesi i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor, që bie ndesh me kuadrin ligjor dhe rregullator për auditimin, standardet ndërkombëtare të auditimit dhe sigurisë, parimet e etikës profesionale dhe kërkesat përkatëse të kodit të etikës, si dhe aktet nënligjore dhe rregullatore të miratuara nga BMP-ja në zbatim të ligjit për auditimin.

3. KIDB-ja, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit, do të shqyrtojë paraprakisht informacionin dhe do të vlerësojë nëse duhet të fillojë procedurën e investigimit.

4. KIDB-ja nuk do të fillojë procedurë investigimi në rastet, kur:

a) objekti i informacionit është jashtë objektit të veprimtarisë së KIDB-së;

b) informacioni nuk përmban të dhëna mbi subjektin e mbikëqyrjes;

c) çështja është shqyrtuar më parë;

ç) procedura e investigimit dhe vendimmarrja lidhur me të cenon procese të cilat janë në shqyrtim nga organet e drejtësisë, gjykatat ose prokuroria, për të cilat nuk ka vendim të formës së prerë;

d) rrethana të arsyetuara bazuar në kuadrin ligjor për auditimin dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

5. Gjatë periudhës së shqyrtimit, KIDB-ja ka të drejtë t'u kërkojë subjekteve të mbikëqyrjes dhe palëve të treta informacionet, dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në konkluzionet e duhura për çështjen në shqyrtim.

6. KIDB-ja, sipas rastit, zhvillon seanca dëgjimore me palët e përfshira në proces.

7. Personeli i strukturës mbështetëse i përfshirë gjatë shqyrtimit të informacionit ruan konfidencialitetin e plotë të rastit dhe të të dhënave të palëve dhe subjektit të mbikëqyrjes.

8. Informacioni dhe dokumentacioni i siguruar në kuadër të procesit të investigimit është konfidencial do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë informacioni.

9. KIDB-ja njofton me shkrim, brenda 7 (shtatë) ditë pune, nëpërmjet strukturës mbështetëse, të

gjitha palët e përfshira dhe të interesuara në proces, për nisjen e procedurës së investigimit.

Neni 15

Detyrimi për bashkëpunim dhe dhënie të informacionit

1. Subjektet e investigimit kanë detyrim të bashkëpunojnë dhe t'u përgjigjen brenda afateve të përcaktuara në të gjitha komunikimet e bëra nga KIDB-ja.

2. Detyrimi për bashkëpunim përfshin pjesëmarrjen në seancat dëgjimore, dhënien e çdo deklarate, informacioni, dokumentacioni, evidence, komunikimi elektronik ose shkresor, regjistra dhe/ose dosje angazhimi, të lidhura me procedurën e investigimit, të cilat mund të kërkojnë nga KIDB-ja gjatë procedurës së investigimit.

3. Në rast se subjekti refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për mënyrën sesi i përmbush detyrimet gjatë auditimit ligjor do të zbatohen masat disiplinore, sipas pikës 6, të nenit 55 të ligjit për auditimin.

Neni 16

Procedura e investigimit

1. KIDB-ja, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e njoftimit për nisjen e procedurave të investigimit, do të njoftojë subjektin mbi datën e thirrjes në seancë dëgjimore.

2. Ky njoftim do të përmbajë:

a) datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet seanca dëgjimore;

b) shkeljen ose sjelljen e papajtuashme objekt të investigimit;

c) të drejtën e subjektit për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore dhe për t'u përfaqësuar;

ç) informacionin dhe dokumentacionin e mbledhur mbi të cilin është bazuar fillimi i procedurës së investigimit;

d) detyrimin e subjektit, të njoftojë KIDB-në jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune para datës së seancës dëgjimore, mbi pjesëmarrjen në seancën dëgjimore, informacionin, deklaratat, dokumentacionin, evidencën, komunikimet elektronike ose shkresore, regjistrat dhe/ose dosjet e angazhimit të lidhura me procedurën e investigimit;



dh) të drejtën e subjektit të pranojë shkeljen ose sjelljen e papajtueshme, duke i kërkuar KIDB-së ta trajtojë si rrethanë lehtësuese.

3. Seancat dëgjimore regjistrohen në pajisje regjistruese dhe janë të mbyllura për publikun.

4. Një kopje e transkriptuar e seancës dëgjimore mund të vihet në dispozicion me kërkesë të subjektit, jo më herët se 20 (njëzet) ditë nga data e zhvillimit të seancës dëgjimore.

5. Subjekti ka të drejtë të paraqesë informacion dhe dokumentacion shtesë ose me kërkesë të KIDB-së, në mbështetje të deklarimeve të veta të bëra gjatë seancës dëgjimore, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e zhvillimit të seancës dëgjimore.

6. Në kuadër të procedurës së investigimit, KIDB-ja shqyrton të gjithë informacionin dhe dokumentacionin mbi rastin dhe merr vendim për:

a) mbylljen e procedurës së investigimit kur shkelja ose sjellja e papajtueshme nuk vërtetohet;

b) të evidentojë shkeljen ose sjelljen e papajtueshme të subjektit si faktor risku për t'u marrë në konsideratë gjatë kontrollit të sigurimit të cilësisë;

c) t'i propozojë bordit marrjen e masave disiplinore, në përputhje me nenin 55 të ligjit për auditimin dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

7. KIDB-ja njofton me shkrim brenda 7(shtatë) ditë pune, nëpërmjet strukturës mbështetëse, të gjitha palët e përfshira dhe të interesuara në proces mbi rezultatin e vendimit, të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 6 të këtij neni.

8. Propozimi i përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 6 të këtij neni duhet të përmbajë:

a) përshkrimin e procedurës së investigimit dhe palët e përfshira;

b) shkeljen/t ose sjelljen/t e papajtueshme të identifikuar;

c) qëndrimet dhe sqarimet e subjektit të mbikëqyrjes;

ç) referencën në informacionin, deklaratat, dokumentacionin, faktet dhe rrethanave që provojnë shkeljen/t ose sjelljen/t e papajtueshme të subjektit;

d) arsyetimin dhe masën disiplinore të propozuar;

dh) opinionin ligjor.

9. Në përfundim të procedurave të investigimit, Bordi merr vendim, brenda afateve të përcaktuara në pikën 10, të nenit 55 të ligjit për auditimin.

10. Afati i përfundimit të procedurave të investigimit është deri në 6 muaj nga data e vendimit për fillimin e procedurës të investigimit. Ky afat mund të zgjatet me vendim të BMP-së, jo më shumë se 6 muaj në rast se kërkohen investigime të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.

Neni 17

Njoftimet dhe shkëmbimi i dokumentacionit

1. Çdo njoftim ose dokument që i drejtohet ankuesit apo subjektit të investigimit, dërgohet përmes shërbimit postar ose postës elektronike, ku dorëzimi ose marrja regjistrohet, ose duke e lënë në:

a) adresën zyrtare të palës përkatëse; ose

b) çdo adresë tjetër të përcaktuar me shkrim nga pala për komunikim me KIDB-në.

2. Kur ankuesi apo subjekti përfaqësohet nga një avokat, një kopje e njoftimit mund të dorëzohet:

a) në adresën e ushtrimit të veprimtarisë së avokatit;

b) në adresën e postës elektronike të avokatit, nëse kjo adresë i është njoftuar KIDB-së si adresë ku do merren njoftimet.

3. Çdo njoftim ose dokument që i drejtohet ankuesit mund t'i jepet personalisht, t'i dërgohet me postë, korrier ose me postë elektronike në adresën e deklaruar prej tij për marrjen e çdo njoftimi apo dokumenti.

4. Çdo njoftim ose dokument që i drejtohet KIDB-së, do të dorëzohet në formë elektronike ose shkresore pranë BMP-së në adresat zyrtare të publikuara në faqen e saj.

5. Çdo njoftim ose dokument mund të dërgohen në formatin përkatës, përmes:

a) shërbimit postar; ose

b) postës elektronike në adresën e njoftuar zyrtarisht për komunikim.

6. Kur një njoftim ose dokument dërgohet në mënyrë elektronike, pala që e dërgon dokumentin (qoftë KIDB-ja, subjekti i investigimit apo ankuesi) nuk ka detyrim të dërgojë apo dorëzojë edhe një kopje shkresore, përveç rasteve kur KIDB-ja e përcakton shprehimisht ndryshe.

7. Dorëzimi i çdo njoftimi apo dokumenti konsiderohet i vlefshëm nëse vërtetohet me:

a) konfirmim zyrtar të dërgimit të lëshuar nga ose në emër të operatorit postar ose shërbimit të shpërndarjes;



b) konfirmim të marrjes së njoftimit ose dokumentit të dërguar me postë elektronike; ose

c) deklaratë të nënshkruar nga personi që e ka dërguar me postë ose e ka dorëzuar njoftimin në përputhje me këtë rregullore.

8. Kur një njoftim ose dokument dërgohet sipas këtyre rregullave, ai do të konsiderohet i dorëzuar.

Neni 18

E drejta e përfaqësimit

1. Subjekti i investigimit ka të drejtë të emërojë një përfaqësues, me prokurë, i cili përfaqëson atë në raport me KIDB-në dhe/ose BMP-në.

2. Subjekti është personalisht përgjegjës për shkeljen/t ose sjelljen e papajtueshme edhe në rastin e emërimit të përfaqësuesit me prokurë.

KREU IV

MASAT DISIPLINORE DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN E TYRE

Neni 19

Kompetenca në marrjen e masave disiplinore

1. Në rast të shkeljeve të ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kompetenca e marrjes së masave disiplinore i takon Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

2. Komisioni i investigimit dhe disiplinës, i cili funksionon pranë Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, apo çdo person, i cili vihet në dijeni të rasteve, që bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit për auditimin apo të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, ka të drejtën t'i drejtohet BMP-së, duke i vënë në dispozicion edhe dokumentacionin përkatës që vërteton shkeljen.

Neni 20

Sistemi i investigimit dhe marrja e masave disiplinore

1. Parimi i vendosjes së masave disiplinore nuk është ndëshkimi, por mbrojtja e interesit të publikut.

2. Procesi i investigimit dhe vendosja e sanksioneve dhe masave disiplinore kanë për qëllim zbulimin, korrigjimin e parandalimin e shkeljeve dhe sjelljeve të papajtueshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

3. BMP-ja zbaton një sistem efektiv dhe proporcional të procesit të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore.

4. Efektiviteti në marrjen e masës disiplinore përfshin rrethanat e mëposhtme, aty ku është e përshtatshme, ndikimin e shkeljes ose sjelljes së papajtueshme në:

a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;

b) shkallën e përgjegjësisë së personit përgjegjës;

c) fuqinë financiare të subjektit, bazuar në qarkullimin vjetor të periudhës raportuese paraardhëse të shoqërisë apo të personit fizik, ose në të ardhurat vjetore të personit përgjegjës, nëse ky i fundit është individ;

ç) shumën e të ardhurave të fituara, ose të humbjeve të shmangura nga personi përgjegjës, për aq sa mund të përcaktohet, nga ushtrimi i detyrës së caktuar që ka çuar në marrjen e masës disiplinore;

d) nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës me BMP;

dh) shkeljet e mëparshme, në lidhje me ligjin e auditimit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese përgjegjëse.

5. Masa disiplinore e vendosur duhet të mbajë në konsideratë dhe proporcionalitetin ekuilibrat midis:

a) interesit publik;

b) interesat e profesionit të auditimit ligjor në tërësi;

c) Interesat e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese që ka kryer shkeljen ose sjelljen e papajtueshme;

ç) seriozitetin e shkeljes ose sjelljes së papajtueshme; dhe

d) rrethanat lehtësuese dhe rënduese të shkeljes ose sjelljes së papajtueshme.

6. Çdo ndikim, në statusin profesional dhe aftësinë e një audituesi ligjor ose shoqërisë audituese për të ushtruar profesionin, nuk duhet të tejkalojë atë që është domosdoshmërisht e nevojshme për të mbrojtur interesin publik. Vendimmarrja duhet të sigurojë një ekuilibër të drejtë midis të drejtave të personit përkatës dhe interesit publik, me qëllim mbrojtjen e të drejtës për jetë private dhe familjare.

7. Vendimmarrja në respektim të parimit të proporcionalitetit përfshin shqyrtimin e të gjitha sanksioneve dhe masave disiplinore në dispozicion të tij në rendin rritës të seriozitetit të shkeljes, duke u orientuar nga masa më e lehtë drejt më të rëndës.



8. Arsytimi i vendimit mbi masën disiplinore ose i masave disiplinore të kombinuara, duhet të vërtetohet se masa është:

a) e mjaftueshme; dhe

b) nuk tejkalon qëllimin e vendosjes së masës disiplinore.

9. Si pjesë e një procesi vendimmarrës proporcional, duhet të merren në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese të rastit, si dhe çdo provë e paraqitur.

10. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese që merren në konsideratë gjatë vendosjes së masës disiplinore janë:

a) Rrethanat që kanë ekzistuar në kohën e shkeljes ose sjelljes së papajtueshme, të cilat duhet të merren parasysh në përcaktimin e seriozitetit të shkeljes ose sjelljes së papajtueshme;

b) Rrethanat aktuale, të cilat bëhen të rëndësishme gjatë vlerësimit se cilën masë apo kombinim i masave disiplinore do të jetë më i përshtatshëm për t'u zbatuar.

11. Për qëllime të zbatimit të pikës 10 të këtij neni, rrethana lehtësuese do të konsiderohen si më poshtë, por pa u kufizuar:

a) evidencë të zbatimit të praktikave të mira;

b) evidencë të ndërgjegjësimit dhe kuptueshmërisë, si edhe përpjekjet e bëra për të adresuar shkeljen ose sjelljen e papajtueshme në shqyrtim;

c) rrethanat personale, si periudha të stresit, sëmundjes, nivelit të mbështetjes në rastet e punësimit.

12. Rrethanat lehtësuese provohen nëpërmjet provave të paraqitura nga vetë subjekti, dëshmime dhe rekomandimeve.

13. Për qëllime të zbatimit të pikës 10 të këtij neni, rrethana rënduese do të konsiderohen si më poshtë, por pa u kufizuar:

a) mungesa e ndërgjegjësimit;

b) dëmtim ose ndikim i pafavorshëm;

c) model i sjelljes së papajtueshme përgjatë një periudhe kohore;

ç) historiku i mëparshëm i sanksionimit (recidivizmi).

14. Shqyrtimi i rrethanave lehtësuese ose rënduese duhet të jetë i mbështetur në prova të bazuara në ligj.

15. Shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, subjekt të masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi

i Mbikëqyrjes Publike nuk do të tejkalojnë vlerën prej 100 000 (njëqindmijë) lekë.

16. Masat disiplinore të propozuara nga KIDB-ja, do të arsyetohen bazuar në kërkesat e këtij neni dhe në përpunime me tabelën e kriterëve për ndarjen e niveleve të masave disiplinore dhe tabelat për përcaktimin e masave disiplinore, sipas aneksit 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 21

Shkeljet dhe masat disiplinore

1. Në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë, BMP-ja ka të drejtë të marrë ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese një ose disa nga llojet e masave disiplinore të mëposhtme:

a) vërejtje, nëpërmjet së cilës personit fizik ose personit juridik përgjegjës për shkeljen i kërkohet të ndërpresë shkeljen dhe të mos e përsërisë atë në të ardhmen;

b) dënim me gjobë në masën nga 0,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse;

c) pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon:

i. audituesin ligjor, shoqërinë audituese ose partnerin kryesor të auditimit të kryejë auditim ligjor dhe/ose të nënshkruajë raporte të auditimit ligjor; apo

ii. audituesin ligjor, shoqërinë audituese ose ortakun kryesor të qëndrueshmërisë të kryejë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe/ose nënshkrimin e raportit të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;

ç) pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon anëtarët e një shoqërie auditimi apo të një organi administrativ ose drejtues të një njësie ekonomike me interes publik të ushtrojnë funksione në shoqëritë audituese ose në njësitë ekonomike me interes publik;

d) heqja e së drejtës për ushtrimin e profesionit, çregjistrimi i audituesit ligjor nga regjistri publik dhe humbja e së drejtës së regjistrimit.

2. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja "a", të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore që përfshihen në llojet e shkeljeve për të cilat jepen masat disiplinore të



shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të kësaj pike dhe kanë një natyrë rekomanduese ose shmangie, e cila mund të përmirësohet pa krijuar shkelje ligjore. Këto masa jepen kur audituesi ose shoqëria e auditimit ka bërë deklaram vullnetar përpara fillimit të procesit të investigimit apo kontrollit të cilësisë.

3. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “b”, të këtij neni zbatohet, si më poshtë:

a) do të zbatohet sanksioni 0,5% deri në 1,5% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse, në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme:

i. nuk zbaton kërkesat e nenit 44, pikat 1 dhe/ose 4 të ligjit të auditimit;

ii. nuk kryen njoftimin, në përputhje me nenin 30 të ligjit të auditimit;

iii. nuk zbaton kërkesat e nenit 25 të ligjit të auditimit dhe të rregullores për edukimin e vazhdueshëm profesional;

iv. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 45 të ligjit të auditimit;

v. nuk dorëzon brenda afateve informacionin e parashikuar në kuadër të kontrollit të sigurimit të cilësisë;

b) do të zbatohet sanksioni 1,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme:

i. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 42 të ligjit të auditimit;

i. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në lidhje me etikën profesionale, pavarësinë dhe sekretin profesional të parashikuara në seksionin IV, të kreut IV dhe në nenin 47 të ligjit të auditimit, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

ii. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat, në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë së audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese dhe/ose të rishikimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit të parashikuara në ligjin e auditimit dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

iii. në rastet kur personat që kanë kaluar testimet e aftësive profesionale ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor pa qenë të regjistruar më parë në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë;

iv. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në lidhje me standardet e rregullat e punës dhe raportimin e auditimit, të parashikuara në seksionin V, të kreut IV të ligjit të auditimit dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

4. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “c”, do të zbatohet në rastet kur në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer, në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë, konstatohet një ose disa prej shkeljeve të mëposhtme:

a) rezultatet e auditimit ligjor të paraqitura në raportin e auditimit nuk mbështeten në procedurat e punës dhe në evidencën e auditimit, në zbatim të kërkesave përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit;

b) janë kryer në më shumë se 1/3 e dosjeve të angazhimeve të auditimit ligjor të paktën një nga shkeljet e sanksionueshme në pikën 5, shkronja “b”, të nenit 55 të ligjit të auditimit;

c) në përfundim të kontrollit pasues vlerësohet se nga audituesi ligjor apo shoqëria audituese nuk janë zbatuar afatet e vendosura nga BMP-ja dhe rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë;

ç) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP-ja;

d) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e procedurës të investigimit nga BMP-ja;

dh) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për mënyrën sesi i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe raportimin e qëndrueshmërisë.

5. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “ç”, të këtij neni jepet në rastet kur në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer, në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë, konstatohen shkelje të nenit 42 të ligjit të auditimit.

6. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “d”, të këtij neni jepet në rastet kur në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e sigurimit të cilësisë konstatohet se:

a) janë përmbushur kushtet e zbatimit të nenit 24 të ligjit të auditimit;

b) janë përsëritur më shumë se dy herë (recidivizëm) shkelje të parashikuara në pikën 6, të nenit 55 të ligjit të auditimit;

c) audituesit ligjorë ose shoqëria e auditimit përfshihen në shërbime të dhënies së sigurisë për pasqyrat financiare dhe/ose raportimit të



qëndrueshmërisë të përgatitura për qëllimet e klientit, kur verifikohet se këto të fundit janë informale, të hartuara jo në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 22

Masat disiplinore për strukturat e Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë

1. Anëtarët e organeve drejtuese të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë dhe anëtarët e tjerë të zgjedhur, që mbajnë pozicione në strukturat drejtuese të tij janë përgjegjës për shkeljet administrative ose disiplinore të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. BMP-ja ka të drejtë të vendosë llojet e sanksioneve administrative:

a) vërejtje me shkrim;

b) gjobë administrative që varion nga 1 deri në 10 paga mesatare kombëtare bruto, sipas përditësimit të raporteve statistikore të INSTAT-it, për vitin në të cilën është vendosur penaliteti;

c) pezullim i përkohshëm nga detyra për një periudhë nga 6 muaj deri në 1 vit. Në rast pezullimi të drejtorit ekzekutiv të Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, emërohet një drejtor i përkohshëm, në përputhje me statutin e Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë.

Këto sanksione do të zbatohen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes.

2. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “a”, të këtij neni, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1 të këtij neni.

3. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “b”, të këtij neni jepet në rastet kur:

a) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 12 të ligjit të auditimit;

b) nuk është zbatuar neni 15 i ligjit të auditimit;

c) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenet 10, 11, 13 dhe 14 të ligjit të auditimit;

ç) nuk është zbatuar pika 7, e nenit 17 të ligjit të auditimit;

d) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenet 19, 20, 21, 22 dhe 23 të ligjit të auditimit;

dh) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në seksionin III, të kreut IV të ligjit të auditimit;

e) nuk janë zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikuara në nenin 25 të ligjit të auditimit;

ë) nuk është zbatuar pika 1, e nenit 32 të ligjit të auditimit;

4. Masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “c”, të këtij neni jepet në rastet kur të paktën një prej shkeljeve të sanksionuara sipas pikës 3 të këtij neni përsëritet.

Neni 23

Heqja e të drejtës për të kryer shërbimin e auditimit ligjor për shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë

1. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri audituese hiqet nga bordi, në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në ligjin e auditimit, të cilat konsiderohen të domosdoshme për autorizimin e regjistrimit.

2. Bordi, në vend të heqjes së të drejtës për ushtrimin e veprimtarisë, mund të përcaktojë një kohë të arsyeshme, për të rregulluar gjendjen e pjesëmarrjes në kapital apo të pjesëmarrjes në organet drejtuese. Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga bordi, gjendja nuk është rregulluar, bordi vendos heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe çregjistrimin nga regjistri publik.

3. E drejta për ushtrimin e profesionit të një audituesi ligjor apo të një shoqërie audituese, mund të hiqet, nëse reputacioni është dëmtuar ndjeshëm. Bordi, në vend të heqjes së të drejtës për ushtrimin e profesionit, mund të vendosë pezullimin e ushtrimit të profesionit, duke vënë në dispozicion një periudhë kohe të arsyeshme, e cila është e barabartë me pezullimin, një listë të kërkesave që duhen plotësuar, për të siguruar kthimin e reputacionit të mirë. Nëse edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga bordi kërkesat nuk janë plotësuar, bordi vendos heqjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe çregjistrimin nga regjistri publik.

4. Për qëllime të pikës 3 të këtij neni, reputacioni i mirë i një audituesi ligjor ose i një shoqërie audituese konsiderohet si i dëmtuar ndjeshëm në rast se vërtetohet një nga situatat e mëposhtme, por pa u kufizuar:

a) është caktuar nga gjykata një masë shtrënguese e arrestit në shtëpi ose e arrestit në burg për një vepër penale të kryer me dashje;



b) është caktuar nga gjykata një nga masat ndaluese të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, që i ndalon përkohësisht ushtrimin e profesionit të audituesit ligjor;

c) është vendosur një sanksion disiplinor ose administrativ nga institucione të tjera shqiptare ose të huaja për shkelje profesionale dhe të përsëritur;

ç) ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur kodin e etikës, rregullat e moralit dhe të profesionit, rekomandimet e autoriteteve mbikëqyrëse të profesionit apo të autoriteteve të ndryshme mbikëqyrëse të tregut.

5. Mospërmbushja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm është kusht për mosregjistrimin e audituesve ligjorë në listën e publikueshme për të gjithë vitin pasardhës.

Neni 24

Raste të tjera disiplinore për çregjistrimin e audituesve ligjorë nga regjistri publik

1. Audituesi ligjor fshihet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë, në rastet kur:

a) konstatohen parregullsi në:

i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale;

ii. deklaratimet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në regjistrin publik;

iii. dokumentet e në faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit;

b) në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;

c) për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cenuar ndjeshëm;

ç) është hequr e drejta e ushtrimit të profesionit, për shkak të ndryshimit të kushteve të domosdoshme për regjistrim, të lidhura me pjesëmarrjen në kapital;

2. Fshirja përfundimtare nga regjistri publik bëhet me vendim të BM-së, pasi janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm të investigimit dhe verifikimit të fakteve dhe evidencës lidhur me rastin.

Neni 25

Administrimi i dokumentacionit gjatë procesit të investigimit

1. Dosja e investigimit administrohet nga sekretaria teknike e KIDB-së.

2. Në çdo mbledhje të KIDB-së mbahet një procesverbal me shkrim i cili përmban datën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën dhe rezultati i vendimeve.

3. Dosjet duhet të ruhet për një periudhë prej pesë vitesh.

4. Dispozitat e parashikuara për KIDB-në në pikën 1, pikën 2 dhe pikën 3 të këtij neni zbatohen për KID-në dhe komisionet e investigimit dhe disiplinës të organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar.

Neni 26

Publikimi i masave disiplinore

1. Masat disiplinore të vendosura publikohen në faqen zyrtare të BMP-së, shoqëruar me informacion mbi llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e individit ose të personit juridik për të cilin është vendosur sanksioni, pasi të gjitha të drejtat e apelimit, të parashikuara në nenin 57/1 të ligjit të auditimit, të jenë shteruar ose të ketë përfunduar afati i ankimit, menjëherë pasi audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit janë njoftuar për atë vendim. Akti disiplinor duhet të përmbajë edhe dispozitat për mënyrën e publikimit.

2. BMP-ja dhe Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë mund të publikojnë sanksionet e vendosura në mënyrë anonime dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme:

a) në rastet kur sanksioni është vendosur ndaj një individi dhe publikimi i të dhënave personale rezulton të jetë joproporcional nga një vlerësim paraprak i detyrueshëm i proporcionalitetit të këtij publikimi;

b) kur publikimi vë në rrezik stabilitetin e tregjeve financiare ose procesin hetimor në vazhdim;

c) kur publikimi shkakton dëme joproporcionale (më të mëdha se shkelja) për institucionet ose individët e përfshirë.

3. BMP-ja dhe Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë, referuar sanksioneve që kanë



qenë objekt ankimi, në përputhje me nenin 57/1 të ligjit për auditimin, publikojnë, sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të arsyetuar që të jetë e mundur, informacione lidhur me statusin e rezultatin e çdo ankimi.

4. BMP-ja duhet të sigurojë që çdo publikim, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, të bëhet brenda një kohe të arsyeshme dhe të ruhet në faqen e tyre zyrtare të internetit për të paktën pesë vjet, pasi të jenë shteruar ose të kenë kaluar të gjitha të drejtat apo afatet e ankimit të parashikuara në nenin 57/1 të ligjit për auditimin.

5. BMP-ja publikon në faqen e saj zyrtare sanksionet administrative të dhëna sipas nenit 55/2 të ligjit për auditimin, të cilat do të ruhen në këtë faqe për një periudhë 1-vjeçare që nga data e publikimit.

6. Publikimi i sanksioneve, i masave disiplinore dhe i çdo deklarate publike duhet të bëhet duke respektuar të drejtat themelore, në veçanti, të drejtën

për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 27

Dispozita përfundimtare

1. Në rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje.

2. Ngarkohen të zbatojnë këtë rregullore Bordi i Mbikëqyrjes Publike, KIDB-ja dhe subjektet e parashikuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

3. Masat disiplinore për dhënien e sigurisë mbi raportimin e qëndrueshmërisë do të zbatohen për periudhat e raportimit të mbyllura më 31.12.2028.

4. KIDB-ja do të ushtrojë funksionet në përputhje me vendimin nr. 13, datë 8.5.2025.

Aneks 1

Tabela e përcaktimit të nivelit të shkeljeve:

Ndikimi i shkeljes ose i sjelljes së papajtueshme	Niveli i shkeljeve		
	Shkelje ose sjellje të papajtueshme e lehtë	Shkelje ose sjellje të papajtueshme serioze	Shkelje ose sjellje të papajtueshme e rëndë
Rëndësia e shkeljes ose sjelljes së papajtueshme	Përmirësohet pa krijuar shkelje ligjore përmes masave këshilluese, vërejtjes ose udhëzimeve të përshtatshme.	Mos pajtueshmëri e qartë, me: i. kërkesat e ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; ii. standardet profesionale të auditimit dhe dhënies së sigurisë; iii. kodin e etikës; iv. kërkesat e pikës 2, të nenit 10 të kësaj rregulloreje.	Mos pajtueshmëri thelbësore, me: i. kërkesat e ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; ii. standardet profesionale të auditimit dhe dhënies së sigurisë; iii. kodin e etikës; iv. me kërkesat e pikës 2, të nenit 10 të kësaj rregulloreje.
Ndikimi në cilësinë e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale	I papërfillshëm ose minimal	Ndikim i ndjeshëm, por i korigjueshëm.	Ndikim i rëndë dhe potencialisht i pakorigjueshëm.
Shkalla e përgjegjësisë së personit përgjegjës	Pa qëllim të keq, gabim i rastësishëm.	Mund të përfshijë pakujdesi serioze apo neglizhencë të vazhdueshme.	Me qëllim të qartë për të mashtruar, manipuluar ose fshehur informacione.
Kohëzgjatja dhe shkeljet ose sjelljet e papajtueshme të mëparshme, në lidhje me ligjin e auditimit dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese përgjegjëse (recidivizmi).	E izoluar gjatë ushtrimit të profesionit, nuk është përsëritur.	Në vazhdimësi gjatë ushtrimit të profesionit, e përsëritur ose me paralajmërime të mëparshme.	Në vazhdimësi gjatë ushtrimit të profesionit, e përsëritur pavarësisht paralajmërimeve, tregon mospajtueshmëri të vazhdueshme..
Nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës me BMP-në	Audituesi ose shoqëria e auditimit ka bërë deklaram vullnetar përpara fillimit të procesit të investigimit apo kontrollit të cilësisë.	Audituesi ose shoqëria e auditimit bashkëpunon pjesërisht ose me vonesë.	Audituesi ose shoqëria e auditimit qëllimisht refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion.
Shuma e të ardhurave të fituara ose të humbjeve të shmangura nga personi përgjegjës, për aq sa mund të përcaktohet, nga ushtrimi i detyrës së caktuar	Jo reale ose minimale.	Të kufizuara, por të prekshme për palët e interesuara.	Serioze për interesin publik, klientin apo sistemin e mbikëqyrjes të auditimit ligjor.
Interesi i publikut	Nuk cenohet.	Mund të cenohet në rast të mosmarjes së masave disiplinore.	Cenohet rëndë, përbën rrezik për reputacionin e profesionit dhe besimin në raportet financiare.



Tabela e përcaktimit të kufijve të gjobës:

Lloji i masës sipas nenit 55 të ligjit për auditimin dhe nenit 21 të kësaj rregullore	Përshkrimi i shkeljes	Niveli i shkeljes	Kufijtë e masës
Masa disiplinore dënim me gjobë në masën nga 0,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të perindhës raportuese paraardhëse	a) do të zbatohet sanksioni 0,5% deri në 1,5% të qarkullimit vjetor të perindhës raportuese paraardhëse në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme: i. nuk zbaton kërkesat e nenit 44, pikat 1 dhe/ose 4 të ligjit të auditimit; ii. nuk kryen njoftimin në përputhje me nenin 30 të ligjit të auditimit; iii. nuk zbaton kërkesat e nenit 25 të ligjit të auditimit dhe të rregullores për edukimin e vazhdimshëm profesional; iv. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikura në nenin 45 të ligjit të auditimit; v. nuk dorëzon brenda afateve informacionin e parashikuar në kuadër të kontrollit të signimit të cilësisë.	Shkelje ose sjellje të papajtueshme e lehtë	0.5%
		Shkelje ose sjellje të papajtueshme serioze	1%
		Shkelje ose sjellje të papajtueshme e rëndë	1.5%
	b) do të zbatohet sanksioni 1,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të perindhës raportuese paraardhëse në rastet kur konstatohet se nuk janë zbatuar një ose disa nga pikat e mëposhtme: i. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikura në nenin 42 të ligjit të auditimit; ii. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikura në lidhje me etikën profesionale, pavarësinë dhe sekretin profesional të parashikuar në seksionin IV të krenit IV dhe në nenin 47 të ligjit të auditimit, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij; iii. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikura në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë të auditimit ligjor ose të shoqërisë andmese dhe/ose të nënkohimit të kontrollit të cilësisë së angazhimit të parashikuar në ligjin e auditimit dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij; iv. në rastet kur personat që kanë kaluar testimet e aftësive profesionale ushtrinë profesionin e auditimit ligjor pa qenë të regjistruar më parë në Regjistrin Publik të Auditimit Ligjor; v. nuk është zbatuar një ose disa nga dispozitat e parashikura në lidhje me standardet e rregullat e punës dhe raportimin e auditimit të parashikuar në seksionin V të krenit IV të ligjit të auditimit dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.	Shkelje ose sjellje të papajtueshme e lehtë	1.5%
		Shkelje ose sjellje të papajtueshme serioze	2.25%
		Shkelje ose sjellje të papajtueshme e rëndë	3%

Tabela për përcaktimin e kufijve të pezullimit:

Lloji i masës sipas nenit 55 të ligjit për auditimin dhe nenit 21 të kësaj rregullore	Përshkrimi i shkeljes	Niveli i shkeljes	Kufijtë e masës
Masa disiplinore pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon: i. auditimin ligjor, shoqërinë andmese ose partnerin kryesor të auditimit të kryejë auditim ligjor dhe/ose të nënkohimaj raporte të auditimit ligjor; apo ii. auditimin ligjor, shoqërinë andmese ose ortakun kryesor të qëndrueshmërisë të kryejë dhënie e signisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe/ose nënkohimin e raportit të dhënies së signisë për raportimin e qëndrueshmërisë.	d) rezultatet e auditimit ligjor të paraqitura në raportin e auditimit nuk mbështeten në procedurat e punës dhe në evidencën e auditimit, në zbatim të kërkesave përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit; e) janë kryer në mënyrë të 1/3 e dosjeve të angazhimeve të auditimit ligjor të paktën një nga shkeljet e sanksionueshme në pikën 5, shkronja "b" të nenit 55 të ligjit të auditimit; f) në përfundim të kontrollit pasues vlerësohet se nga auditimi ligjor apo shoqëria andmese nuk janë zbatuar afatet e vendosura nga BMP dhe rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të kontrollit të signimit të cilësisë; g) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk signon informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit të signimit të cilësisë nga BMP; h) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk signon informacion për realizimin e procedurës së investigimit nga BMP; i) refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk signon informacion për mënyrën sesi i pëmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe raportimin e qëndrueshmërisë.	Shkelje ose sjellje të papajtueshme e lehtë	1 vit
		Shkelje ose sjellje të papajtueshme serioze	1.5 vite
		Shkelje ose sjellje të papajtueshme e rëndë	3 vite
Masa disiplinore pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon anëtarët e një shoqërie auditimi apo të një organi administrativ ose drejtimes të një njësie ekonomike me interes publik të ushtrinë funksione në shoqëritë	në përfundim të procedurës së investigimit dhe/ose të vlerësimit të kryer në lidhje me kontrollin e signimit të cilësisë konstatohen shkelje të nenit 42 të ligjit të auditimit.	Shkelje ose sjellje të papajtueshme e lehtë	1 vit
andmese ose në njësitë ekonomike me interes publik;		Shkelje ose sjellje të papajtueshme serioze	1.5 vite
		Shkelje ose sjellje të papajtueshme e rëndë	3 vite

**VENDIM****Nr. 44, datë 30.9.2025**

Në zbatim të nenit 5, pika 1 (j), nenit 33 pika 7/1, nenit 34, pika 3, nenit 37 pika 4, nenit 38, pika 3, nenit 39, pika 10, nenit 46, pika 8, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, i ndryshuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike në mbledhjen e tij, sipas rendit të ditës:

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të sigurimit të cilësisë, organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e cilësisë së audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit”.

2. Shfuqizimin e rregullores nr. 7 datë 2.10.2018, “Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”, e ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Dritan Fino

Anëtarë: Adriana Berberi, Luan Abazi, Martin Mici, Gjergji Duro

RREGULLORE

**PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË
KONTROLLIT TË SIGURIMIT TË CILËSISË,
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
SISTEMIT PËR SIGURIMIN E CILËSISË SË
AUDITUESVE LIGJORË DHE TË
SHOQËRIVE TË AUDITIMIT**

*Miratuar me vendimin nr. 44, datë 30.9.2025
të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.*

KREU I**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë:

i. procedurat, metodologjinë dhe kërkesat për organizimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm për sigurimin e cilësisë, si dhe për kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit, nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;

ii. kuadrin rregullator të mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) për mbrojtjen e interesit publik, nëpërmjet kontrollit të sigurimit të cilësisë së auditimit ligjor dhe, ku është e zbatueshme të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;

iii. rregulla të detajuara në zbatim të kërkesave të ligjit për auditimin dhe të kërkesave përkatëse të kodit të etikës në fuqi për auditimin dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në lidhje me përgatitjen për auditimin ligjor dhe vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë, ruajtjen e pavarësisë dhe objektivitetit, ndalimin e shërbimeve të joauditimit, parregullsitë e identifikuar në njësinë ekonomike kur kryhet auditimi ligjor dhe/ose dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë për një njësi ekonomike me interes publik;

iv. rregullat për transferimin e informacionit, në rastet e zëvendësimit të audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese, pa përfunduar angazhimi i auditimit ligjor;

v. rregulla dhe kërkesa të posaçme në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si edhe të raportit të dhënies së sigurisë për raportin vjetor e të konsoliduar të qëndrueshmërisë;

vi. rregulla të detajuara në lidhje me raportimin në komitetin e auditimit.

Neni 2**Baza ligjore**

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të nenit 5, pika 1 (j), nenit 33, pika 7/1, nenit 34, pika 3, nenit 37, pika 4, nenit 38, pika 3, nenit 39, pika 10, nenit 46, pika 8, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar (ligji për auditimin).



Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të angazhuar në auditimin ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të njësive ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik, strukturën mbështetëse të BMP-së, si edhe organizatën profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e parashikuara në nenin 2 të ligjit për auditimin.

KREU II
**SISTEMI I KONTROLLIT TË CILËSISË
DHE KUSHTET PËR KRYERJEN E
AUDITIMIT LIGJOR**

Neni 5
**Organizimi dhe funksionimi i sistemit për
sigurimin e cilësisë së audituesit ligjor dhe
shoqërisë audituese**

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të angazhuar në auditimin e njësive ekonomike me interes publik dhe jo me interes publik, janë të detyruar të organizojnë dhe të sigurojnë funksionimin e sistemit të brendshëm për sigurimin e cilësisë, në zbatim të nenit 38, pika 1, shkronja “a” e ligjit për auditimin dhe kërkesave të standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë.

2. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të hartojë e të zbatojë politika dhe procedura të përshtatshme për organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit, kësaj rregulloreje dhe standardeve të shpallura për zbatim nga BMP-ja.

3. Shoqëritë e auditimit duhet të kenë në zbatim politika dhe procedura të përshtatshme për të siguruar që ortakët ose aksionerët e saj, si dhe anëtarët e organeve administrative, drejtuese dhe mbikëqyrëse të shoqërisë, ose të një shoqërie filial, nuk ndërhyjnë në kryerjen e një auditimi ligjor në çfarëdo mënyre që rrezikon pavarësinë dhe

objektivitetin e audituesit ligjor i cili kryen auditimin ligjor në emër të shoqërisë audituese.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ketë në zbatim procedura administrative dhe kontabël të qëndrueshme, sisteme të brendshme të kontrollit të cilësisë, politika dhe procedura efektive për vlerësimin e rrezikut dhe masa kontrolli dhe sigurie për sistemet e përpunimit të informacionit.

Sistemet e kontrollit të brendshëm të cilësisë duhet të ndërtohen në mënyrë që të sigurojë pajtueshmëri me vendimet, politikat dhe procedurat në të gjitha nivelet e shoqërisë audituese ose të strukturës së brendshme të punës së audituesit ligjor.

5. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ketë në zbatim politika dhe procedura të përshtatshme për të siguruar që punëmarrësit e tij ose të saj dhe çdo person tjetër fizik, shërbimet e të cilëve janë në dispozicion të tij ose të saj ose nën kontrollin e tij ose të saj, dhe që janë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e auditimit ligjor, të kenë njohuri dhe përvojë të përshtatshme për detyrat që u janë ngarkuar.

6. Audituesi ligjor dhe shoqëria audituese duhet të ketë në zbatim politika dhe procedura të përshtatshme për të siguruar që kontraktimi, nga palë të treta, i funksioneve të rëndësishme të auditimit nuk do të ndërmerret në atë mënyrë që të dëmtojë cilësinë e kontrollit të brendshëm të cilësisë së audituesit ligjor ose shoqërisë audituese dhe aftësinë e BMP-së për të mbikëqyrur pajtueshmërinë e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese me detyrimet e përcaktuara në ligjin për auditimin dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Kontraktimi nga palë të treta i funksioneve të auditimit nuk përjashton përgjegjësinë e audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese ndaj njësive ekonomike të audituar.

7. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ketë në zbatim masa të përshtatshme dhe efektive organizative dhe administrative për të parandaluar, identifikuar, eliminuar ose reduktuar në një nivel të pranueshëm dhe shpalosur çdo kërcënim ndaj pavarësisë së tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për auditimin dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

8. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ketë në zbatim politika dhe procedura të përshtatshme për kryerjen e auditimeve ligjore, drejtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e aktiviteteve të punonjësve dhe organizimin e strukturës së dosjes



së auditimit siç përmendet në nenin 36 të ligjit për auditimin.

9. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese krijon një sistem të kontrollit të brendshëm të cilësisë për të siguruar cilësinë e auditimit ligjor.

10. Sistemi i kontrollit të cilësisë mbulon, të paktën, politikat dhe procedurat e përshkruara në pikën 8 të këtij neni. Në rastin e një shoqërie audituese, përgjegjësia për sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë bie mbi një person që është i kualifikuar si auditues ligjor.

11. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të përdorë sisteme, burime dhe procedura të përshtatshme për të siguruar vazhdimësi dhe pajtueshmëri me rregullat gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij/saj të auditimit ligjor.

12. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet gjithashtu të ketë në zbatim masa organizative dhe administrative, të përshtatshme dhe efektive, për trajtimin dhe regjistrimin e incidenteve që kanë ose mund të kenë pasoja të rënda për integritetin e aktiviteteve të auditimit ligjor të tij ose të saj.

13. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ketë në zbatim politika dhe procedura të përshtatshme shpërblymshme, duke përfshirë politikat e ndarjes së fitimit, të cilat sigurojnë stimuj të mjaftueshëm për rezultatet për të siguruar cilësinë e auditimit. Në veçanti, shumica e të ardhurave që audituesi ligjor ose shoqëria audituese siguron nga ofrimi i shërbimeve joaudituese për njësinë e audituar nuk duhet të jetë pjesë e vlerësimit të performancës dhe shpërblymshimit të ndonjë personi të përfshirë ose që mund të ndikojë në kryerjen e auditimit.

14. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese monitoron dhe vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve që kanë në zbatim, mekanizmeve dhe masave të kontrollit të brendshëm të cilësisë të vendosura në përputhje me ligjin për auditimin dhe këtë rregullore, si edhe merr masat e duhura për të adresuar çdo mangësi. Një auditues ligjor ose një shoqëri audituese kryen në veçanti një vlerësim vjetor të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë, të përmendur në pikën 9 të këtij neni. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese regjistron gjetjet e identifikuar nga vlerësimi, si edhe çdo masë të propozuar për ndryshimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë.

15. Politikat dhe procedurat e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të dokumentohen dhe t'u

kommunikohen punëmarrësve të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese.

16. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese merr në konsideratë madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tij ose të saj në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë nen. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet t'i vërtetojë BMP-së se politikat dhe procedurat e hartuara për të arritur një pajtueshmëri të tillë janë të përshtatshme, duke pasur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e aktiviteteve të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese.

KREU III

ETIKA PROFESIONALE, PAVARËSIA, OBJEKTIVITETI, KONFIDENCIALITETI DHE SEKRETI PROFESIONAL

Neni 6

Etika profesionale

Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit zbatojnë parimet e etikës profesionale, ku përfshihen të paktën funksioni i tyre me interes publik, integriteti, objektiviteti, aftësia profesionale dhe kujdesi i duhur, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse të Kodit të Etikës të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës të Profesionistëve Kontabël të publikuara nga FNK-ja, të përkthyer e të publikuara në shqip nga organizata profesionale e audituesve ligjorë jo më vonë se 12 muaj nga data e publikimit nga FNK-ja dhe të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP-ja.

Neni 7

Skepticizmi profesional

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ushtrojë skepticizëm profesional gjatë kryerjes së një auditimi, duke pranuar mundësinë e një anomalie materiale, si pasojë e fakteve ose e sjelljeve, që tregojnë parregullsi, përfshirë mashtrimin ose gabimin, pavarësisht ndershmërisë dhe integritetit të treguar në të kaluarën nga drejtimi i subjektit të audituar dhe nga personat përgjegjës për drejtimin e tij.

2. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ushtrojë skepticizëm profesional në veçanti gjatë rishikimit të vlerësimeve të drejtuesve në lidhje me vlerat e drejta, zhvlerësimin e aktiveve, provizionet



dhe fluksin e ardhshëm të mjeteve monetare që lidhen me aftësinë e subjektit për të vazhduar biznesin mbi bazën e parimit të vijimësisë.

Neni 8

Pavarësia, objektiviteti dhe konflikti i interesit

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese dhe çdo individ në gjendje të ndikojë drejtpërdrejt ose indirekt në rezultatin e auditimit ligjor, gjatë kryerjes së një auditimi ligjor, duhet të jetë i pavarur nga njësi ekonomike e audituar dhe nuk duhet të jetë i përfshirë në vendimmarrjen e njësisë ekonomike të audituar. Pavarësia është e detyrueshme si për periudhën që mbulohet nga pasqyrat financiare që do të auditohen, ashtu edhe përgjatë periudhës së kryerjes së auditimit ligjor.

2. Kur kryen një auditim ligjor, një auditues ligjor ose një shoqëri audituese duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të siguruar që pavarësia e tij nuk ndikohet nga ndonjë konflikt ekzistues ose i mundshëm interesi ose biznesi, ose nga ndonjë marrëdhënie tjetër e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, që përfshin audituesin ligjor ose shoqërinë audituese, që kryen auditimin, dhe, sipas rastit, rrjetin e tij, drejtuesit e tij, audituesit apo punonjësit e tij, çdo individ tjetër, shërbimet e të cilit janë në dispozicion ose nën kontrollin e audituesit ligjor ose të shoqërisë audituese, ose çdo individ me lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me audituesin ligjor ose shoqërinë audituese nëpërmjet ushtrimit të kontrollit.

3. Nëse pavarësia e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese cenohet nga kërcënime apo presione, që lidhen me konflikte interesi, si interesi vetjak, vetë-rishikimi, familjariteti, favorizimi, apo frikësimi, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të marrë masa mbrojtëse, me qëllim që të pakësojë ose të eliminojë efektin e këtyre rrethanave në kryerjen e auditimit.

4. Nëse shkalla e kërcënimeve, në krahasim me masat mbrojtëse, është e tillë, që të rrezikohet pavarësia, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të heqë dorë nga kryerja e angazhimit të auditimit ligjor.

5. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk do të pranojnë apo nuk do të kryejnë auditimin ligjor në rast se ekziston kërcënimi i vetë-rishikimit, i interesit vetjak, i favorizimit, i familjaritetit dhe i frikësimit të krijuar gjatë marrëdhënies financiare, personale,

tregtare, të punësimit apo të marrëdhënieve të tjera ndërmjet:

i. audituesit ligjor, shoqërisë së auditimit, rrjetit të shoqërisë së auditimit, cilitdo individ, në pozicion që mund të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në konkluzionet e auditimit ligjor; dhe

ii. njësisë ekonomike të audituar, ku, si rrjedhojë e kërcënimit, një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar, duke marrë në konsideratë të gjitha masat mbrojtëse të zbatuara, arrin në konkluzionin se pavarësia e audituesit ligjor ose e shoqërisë së auditimit është cenuar.

6. Audituesi ligjor, shoqëria e auditimit, ortaku kryesor i auditimit të tyre, punonjësit e tyre dhe cilitdo individ, shërbimet e të cilit janë në dispozicion apo nën kontrollin e audituesit ligjor ose të shoqërisë së auditimit, si dhe individët e përfshirë në procedurat e auditimit ligjor dhe individët e lidhur ngushtë me ta nuk duhet të zotërojnë apo të kenë interesa përfitimi material apo të angazhohen në transaksione të instrumenteve financiare të lëshuara, të garantuara apo të mbështetura në formë të tjera, nga cilado njësi ekonomike e audituar brenda fushës së auditimit ligjor. Përrjashtim bëjnë interesat e zotëruar në mënyrë të tërthortë nëpërmjet skemave të diversifikuara të investimit kolektiv, ku përfshihen edhe fondet e menaxhuara si fondet e pensionit apo sigurimi i jetës.

7. Për shoqëritë e listuara në bursë, bankat ose shoqëritë e sigurimeve, audituesi ligjor ose shoqëria audituese mund të ofrojë, përveç auditimit, edhe shërbime të tjera, që nuk janë auditim ligjor, për sa kohë që një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e mirinformuar nuk arrin në përfundimin se shkelet pavarësia. Ankimimi, në rast shkeljeje, bëhet pranë bordit, i cili, pasi e shqyrton rastin, vendos për pretendimin e ngritur dhe urdhëron veprimet e mëtejshme.

8. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese duhet të dokumentojnë në fletët e tyre të punës së auditimit të gjitha kërcënimet ose presionet e rëndësishme, që lidhen me pavarësinë e tyre, si dhe masat e marra për shmangien e tyre.

9. Në kuptim të pikës 8 të këtij neni, kërcënime të rëndësishme mund të konsiderohen, por pa u kufizuar, rastet që lidhen me:

- a) interesat financiare;
- b) huat dhe garancitë;
- c) marrëdhëniet e biznesit;
- ç) marrëdhëniet familjare dhe personale;



- d) punësimi te një subjekt auditimi;
- dh) emërimi i përkohshëm i personelit;
- e) shërbimet e ofruara kohët e fundit për subjektin e auditimit;
- ë) mbajtjen e një pozicioni drejtues ose administrativ në njësinë ekonomike subjekt i auditimit;
- f) ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga ato të sigurimit të cilësisë për një subjekt auditimi;
- g) politikat e shpërblyerjes dhe vlerësimit;
- gj) dhuratat dhe mikpritja;
- h) çështje gjyqësore në proces ose të pretenduara për t'u ndërmarrë.

10. Personat ose shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 6 të këtij neni, nuk lejohen të marrin pjesë apo të ushtrojnë ndikim në rezultatin e auditimit ligjor të një njësie ekonomike, nëse:

- a) zotërojnë instrumente financiare të njësisë ekonomike të audituar, përveç kur janë interesa të zotëruar në mënyrë indirekte nëpërmjet skemave të diversifikuara kolektive të investimit;
- b) zotërojnë instrumente financiare të njësisë ekonomike të lidhur me njësinë ekonomike të audituar, pronësia e së cilës mund të krijojë rrethana të konfliktit të interesit, përveç kur janë interesa të zotëruar në mënyrë indirekte nëpërmjet skemave të diversifikuara kolektive të investimit;
- c) kanë pasur një marrëdhënie punësimi, biznesi ose marrëdhënie tjetër me njësinë ekonomike të audituar, që mund të krijojë rrethana të konfliktit të interesit me njësinë ekonomike që po auditohet, për periudhën që mbulohet nga pasqyrat financiare, që do të auditohen ashtu edhe përgjatë periudhës së kryerjes së auditimit ligjor.

11. Personat ose shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 6 të këtij neni, nuk lejohen të kërkojnë ose të pranojnë dhurata, donacione ose favore monetare dhe jomonetare nga njësi ekonomike e audituar apo cilado njësi ekonomike e lidhur me njësinë ekonomike të audituar, përveç rasteve kur një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar do ta konsideronte vlerën e tyre si të papërfillshme ose të parëndësishme.

12. Nëse gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, njësi ekonomike e audituar blihet nga një njësi ekonomike tjetër, bashkohet me të ose blen një njësi ekonomike tjetër, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të identifikojë dhe të vlerësojë të gjithë interesat, marrëdhëniet aktuale ose të afërta, duke përfshirë shërbimet jo të auditimit të

ofruar për atë njësi, të cilat, duke marrë parasysh edhe masat e mundshme mbrojtëse, mund të cenojnë pavarësinë dhe aftësinë e audituesit ligjor për të vijuar me auditimin ligjor pas datës efektive të bashkimit ose të blerjes. Brenda tre muajve nga njohja e bashkimit ose e blerjes, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të përfunduar çdo marrëdhënie aktuale ose interesi, që do të cenonte pavarësinë e tij. Gjithashtu, kur është e mundur, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ndërmarrë masa mbrojtëse për të minimizuar çdo kërcënim ndaj pavarësisë së tij, që rrjedh nga interesat dhe marrëdhëniet e mëparshme dhe aktuale me njësitë ekonomike të audituara ose me çdo njësi ekonomike tjetër të lidhur me të.

13. Tarifa e auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë nuk duhet të jetë influencuar apo përcaktuar në funksion të kryerjes së shërbimeve të tjera për njësinë ekonomike të audituar dhe nuk mund të jetë bazuar në ndonjë formë tjetër kushtëzimi.

Neni 9

Punësimi nga njësitë ekonomike të audituara të ish-audituesve ligjorë ose të punëmarrësve të audituesve ligjorë ose shoqërive audituese

1. Audituesi ligjor ose ortak kryesor i auditimit, që kryen auditimin ligjor në emër të shoqërisë audituese, pa kaluar një periudhë kohore prej të paktën një viti ose, në rastin e auditimit ligjor të njësisë ekonomike me interes publik, të paktën dy vjet nga përfundimi i emërimit të tij si auditues ligjor ose ortak kryesor i auditimit në angazhimin e auditimit, nuk lejohet që:

- a) të marrë ndonjë pozicion të rëndësishëm drejtimi në njësinë ekonomike të audituar;
- b) të bëhet, sipas rastit, anëtar në komitetin e auditimit të njësisë ekonomike të audituar ose të një organi me funksione të barasvlershme me ato të një komiteti auditimi;
- c) të bëhet anëtar joekzekutiv i organit administrativ ose i organit mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar.

2. Në çdo rast që punonjësit ose ortakët e një audituesi ligjor ose të një shoqërie audituese që kryejnë auditimin ligjor, si dhe çdo individ, shërbimet e të cilit janë në dispozicion ose nën



kontrollin e këtij audituesi ligjor ose shoqërie audituese, regjistrohen si auditues ligjorë, ata nuk mund të mbajnë asnjë nga pozicionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, pa kaluar të paktën një vit nga përfundimi i përfshirjes së tyre të drejtpërdrejtë në angazhimin e auditimit ligjor. Ky rregull nuk zbatohet për ortakët kryesorë të auditimit.

Neni 10

Përgatitja për auditimin ligjor dhe vlerësimi i kërcënimeve ndaj pavarësisë

1. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese, përpara se të pranojnë ose vazhdojnë një angazhim për një auditim ligjor, duhet të vlerësojnë dhe dokumentojnë si më poshtë:

i. Pajtueshmërinë e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese me kërkesat e nenit 33 të ligjit për auditimin dhe kërkesat e nenit 8 të kësaj rregullore;

ii. Kërcënimet e pavarësisë së audituesit ligjor ose shoqërisë audituese dhe masat mbrojtëse të përdorura për të zbutur këto kërcënime;

iii. Kompetencat profesionale të punëmarrësve, kohën dhe burimet e nevojshme për të kryer auditimin ligjor në mënyrën e duhur;

iv. Se ortakë kryesorë të auditimit në shoqërinë audituese është i regjistruar në regjistrin publik.

Neni 11

Konfidencialiteti dhe sekretet profesionale

1. Informacionet dhe dokumentet që përdoren ose mbi të cilat merret dijeni nga audituesi ligjor apo shoqëria audituese, gjatë kryerjes së auditimit, mbrohen nga rregullat e konfidencialitetit dhe sekretit profesional.

2. Rregullat e konfidencialitetit dhe të ruajtjes së sekretit profesional, që lidhen me audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese, nuk përbëjnë pengesë për zbatimin e dispozitave të ligjit për auditimin dhe kësaj rregulloreje, për zbatimin e standardeve dhe as bien ndesh me kërkesat ligjore të ligjeve të tjera, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë marrjen e këtyre informacioneve edhe kur ato mbrohen si konfidenciale dhe pjesë të sekretit profesional.

3. Kur një auditues ligjor ose shoqëri audituese zëvendësohet nga një tjetër auditues ligjor ose shoqëri audituese përpara përfundimit të një angazhimi auditimi, audituesi ligjor ose shoqëria

audituese paraardhës duhet t'i sigurojë audituesit ligjor ose shoqërisë audituese pasardhës/e aksesin në të gjithë informacionin përkatës të mbledhur në lidhje me njësinë ekonomike të audituar.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese që ka ndërprerë angazhimin në një auditim të caktuar, ose audituesi ligjor ose shoqëria audituese i/e mëparshme, do të vazhdojnë t'u nënshtrohen kërkesave të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, në lidhje me auditimet e kryera.

5. Kur audituesi ligjor ose shoqëria audituese kryen një auditim ligjor të një ndërmarrjeje e cila është pjesë e një grupi, ndërmarrja mëmë e së cilës ndodhet në një vend të huaj, rregullat e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të sekretit profesional të përmendura në pikën 1 të këtij neni nuk përbëjnë pengesë për transferimin e dokumentacionit që lidhet me punën e kryer të auditimit nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese tek audituesi i grupit i vendosur në një vend të huaj, nëse një dokumentacion i tillë është i nevojshëm për kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare të konsoliduara të ndërmarrjes mëmë.

6. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese që kryejnë auditim ligjor të një ndërmarrjeje që ka emetuar letra me vlerë në një vend të huaj ose që është pjesë e një grupi që përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në një vend të huaj, mund të transferojnë tek autoriteti kompetent i vendit të huaj vetëm dokumentet e punës së auditimit ose dokumente të tjera në lidhje me auditimin e asaj njësie ekonomike, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 33 të kësaj rregulloreje.

7. Transferimi i informacionit tek audituesi i grupit i vendosur në një vend të huaj do të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me përpunimin dhe qarkullimin e këtyre të dhënave.

Neni 12

Rregullat për transferimin e informacionit

1. Kur një auditues ligjor ose një shoqëri audituese zëvendësohen nga një auditues ligjor ose shoqëri audituese tjetër, audituesi ligjor ose shoqëria audituese e mëparshme duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

2. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që ka ndërprerë angazhimet në një auditim të caktuar, ose



një ish- auditues ligjor ose ish-shoqëri audituese, do të vazhdojnë t'u nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të kësaj rregulloreje, në lidhje me auditimet e kryera.

3. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese e mëparshme do t'i japin gjithashtu audituesit ose shoqërisë audituese të ardhshëm akses në raportet shtesë të përmendura në nenin 30 në lidhje me vitet e mëparshme dhe në çdo informacion të transmetuar tek autoritetet kompetente mbikëqyrëse në përputhje me nenin 31 të kësaj rregulloreje dhe nenin 45 të ligjit për auditimin.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese e mëparshme, në rastet kur kërkohet nga BMP-ja, duhet të dëshmojnë se informacionet e përmendura në këtë nen i janë dhënë audituesit ose shoqërisë audituese të ardhshëm.

KREU IV STANDARDET E AUDITIMIT DHE RAPORTIMI I AUDITIMIT

Neni 13 Standardet e zbatueshme

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese i kryejnë auditimet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit.

2. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese e kryejnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në përputhje me standardet e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP-ja. Audituesit ligjorë ose shoqëritë e auditimit duhet të paraqesin rezultatet e raportimit të sigurimit të qëndrueshmërisë në një raport sigurie mbi raportimin e qëndrueshmërisë.

3. Për qëllime të zbatimit të pikës 1 të këtij neni dhe pikës 1 të nenit 37 të ligjit për auditimin, “standardet ndërkombëtare të auditimit” përfshijnë standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA), standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë (SNMC) dhe standardet e tjera të lidhura me to, të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Sigurisë (BSNAS), në masën që ato janë të rëndësishme për auditimin ligjor, të shpallura të detyrueshme për zbatim nga BMP-ja.

Neni 14

Rregullat e Auditimit

1. Kur auditimi ligjor apo dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë kryhet nga një shoqëri audituese, kjo e fundit cakton të paktën një ortak kryesor të auditimit apo ortak kryesor të qëndrueshmërisë, i cili mund të jetë një nga ortakët kryesorë të auditimit. Shoqëria audituese duhet t'i sigurojë ortakut kryesor të auditimit dhe ortakut kryesor të qëndrueshmërisë burime të mjaftueshme dhe personel, që ka kompetencën dhe aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat në mënyrë të përshtatshme.

2. Në shërbimet e auditimit dhe të dhënies së sigurisë, sigurimi i cilësisë, i pavarësisë dhe i kompetencave duhet të jenë kriteret kryesorë të përdorura nga shoqëria audituese gjatë përzgjedhjes së ortakut kryesor të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, të ortakut kryesor të qëndrueshmërisë. Ortakët kryesorë të auditimit dhe ortakët kryesorë të qëndrueshmërisë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në kryerjen e auditimit ligjor dhe në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

3. Audituesi ligjor u kushton kohë të mjaftueshme angazhimit të auditimit dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe duhet të caktojë burime të mjaftueshme që t'i mundësojnë kryerjen e detyrave në mënyrë të përshtatshme.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të krijojë një regjistër për çdo shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për çdo pasojë të çdo shkeljeje, duke përfshirë masat e marra për adresimin e shkeljes dhe ndryshimet përkatëse në sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë. Ata do të përgatisin një raport vjetor, që përmban një pasqyrë të të gjitha masave të marra dhe që do të shpërndahet për komunikim të brendshëm. Në rast se audituesi ligjor ose shoqëria audituese kërkon këshillim nga ekspertë të jashtëm gjatë një angazhimi auditimi, ai duhet të dokumentojë kërkesën për këshillim dhe këshillën e marrë nga eksperti i jashtëm.

5. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të mbajë një regjistër të klientit. Regjistri duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për çdo klient auditimi:

a) emrin, adresën dhe vendndodhjen e biznesit;



b) në rastin e një shoqërie audituese, emrin e ortakut ose të ortakëve kryesorë të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, emrin e ortakut ose të ortakëve kryesorë të qëndrueshmërisë;

c) tarifat e aplikuara për auditimin ligjor, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe tarifat e aplikuara për shërbime të tjera për çdo periudhë raportuese.

6. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të krijojë një dosje auditimi për çdo auditim ligjor dhe një dosje për çdo angazhim në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të dokumentojë në dosjet përkatëse të paktën vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë dhe fletët e punës, në përputhje me kërkesat përkatëse të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të raportit të qëndrueshmërisë. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të ruajë çdo të dhënë dhe dokument tjetër, që ka rëndësi në mbështetje të raportit të auditimit dhe për monitorimin e pajtueshmërisë me ligjin për auditimin dhe këtë rregullore, si dhe kërkesat e tjera të legjislacionit të zbatueshëm. Dosja e auditimit dhe ajo e raportimit të qëndrueshmërisë mbyllet e arkivohet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të raportit të auditimit dhe të raportit të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, kur kjo e fundit është e zbatueshme.

7. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të regjistrojë çdo ankesë të bërë me shkrim lidhur me realizimin e auditimeve ligjore të kryera apo të angazhimeve të dhënies së sigurisë në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë.

8. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese duhet të dorëzojnë çdo informacion, pranë BMP-së, për mënyrën sesi i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

Neni 15

Njësitë ekonomike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare

1. Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;

b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;

iii. ka, mesatarisht, të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

Neni 16

Emërimi i audituesve ligjorë ose i shoqërive audituese

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese emërohet çdo vit nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve për shoqëritë aksionare, nga asambleja e ortakëve për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ose nga ndonjë organ tjetër i ngarkuar për këtë qëllim, sipas legjislacionit specifik në fuqi, me të drejtë riemërimi. Kohëzgjatja totale e emërimit në angazhimin e auditimit nuk do të kalojë periudhën 10-vjeçare, si për audituesin ligjor ose shoqërinë audituese, ashtu edhe për këto në kombinim. Me kalimin e kohëzgjatjes maksimale të emërimit në angazhimet e auditimit, as audituesi ligjor, as shoqëria audituese dhe, kur është e zbatueshme, ndonjë anëtar i rrjeteve të tyre nuk do të ndërmarrin auditimin ligjor të së njëjtës njësi ekonomike me interes publik brenda periudhës katërvjeçare në vijim. Për njësitë ekonomike jo me interes publik do të zbatohet periudha trevjeçare në vijim.

Ndalohet çdo klauzolë kontraktuale dhe/ose statutore, që kufizon emërimin nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve/ortakëve dhe/ose nga organe të tjera të njësive ekonomike të audituara, për disa kategori ose lista audituesish ose shoqërish audituese në lidhje me emërimin e një audituesi ligjor ose shoqërie audituese të caktuar për të kryer auditimin ligjor apo dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të asaj njësie ekonomike. Çdo klauzolë e tillë në kontratat ekzistuese do të konsiderohet e pavlefshme.

2. Ortaku kryesor i auditimit në një shoqëri audituese, që është audituesi ligjor, përgjegjës për kryerjen e angazhimit të auditimit në emër të



shoqërisë audituese, duhet të zëvendësohet për kryerjen e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e fillimit si auditues ligjor. Ai mund të marrë pjesë sërish në auditimin e së njëjtës njësi ekonomike pas kalimit të një periudhe prej të paktën 3 vjetësh nga zëvendësimi i tij, me kusht që periudha kohore e përgjithshme e angazhimit të mos kalojë 10 vjet.

3. Autoritetet mbikëqyrëse të tregjeve të rregulluara me ligj të veçantë mund të parashikojnë kritere shtesë, të cilat duhet të plotësohen nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese, që do të kryejnë auditimin e njësive ekonomike të mbikëqyrura prej tyre.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit nuk duhet të pranojë angazhimin e auditimit nëse vendimi i emërimit i përcaktuar në këtë nen nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe kushtet e tjera të kryerjes së angazhimit të auditimit të përcaktuara në këtë ligj.

5. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij neni nga audituesit dhe shoqëritë e auditimit, do të zbatohen masat disiplinore në përputhje me nenin 55 të ligjit për auditimin dhe rregulloren për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

6. Në rast të moszbatimit të dispozitave të këtij neni nga organi administrativ ose drejtuesi i një njësie ekonomike me interes publik, do të zbatohen masat disiplinore të parashikuara në nenin 55 të ligjit për auditimin dhe rregulloren për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

Neni 17

Auditimi ligjor i pasqyrave financiare të konsoliduara

1. Në rastin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara të një grupi sipërmarrjesh, audituesi ligjor i grupit:

a) mban përgjegjësi të plotë për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e auditimit të përmendur në nenin 19, ose kur është e zbatueshme, në nenin 29 të kësaj rregullore;

b) kryen kontroll të auditimit, të bërë nga audituesit ligjorë të tjerë, si edhe në një juridiksion tjetër, për qëllimet e auditimit të grupit dhe dokumenton natyrën, kohën dhe nivelin e punës të kryer nga këta auditues, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, rishikimin nga audituesi i grupit të

pjesëve përkatëse të dokumentacionit të auditimit të atyre audituesve;

c) audituesi i grupit rishikon punën e auditimit të kryer nga audituesi/it ose audituesi/it ligjor/ë i vendit të huaj dhe njësia/të ekonomike audituese ose shoqëria/të audituese e vendit të huaj për qëllimin e auditimit të grupit dhe e dokumenton atë. Dokumentacioni i mbajtur nga audituesi i grupit duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë autoritetit kompetent përkatës të rishikojë punën e audituesit të grupit.

2. Në zbatim të shkronjës “c” pikës 1 të këtij neni, audituesi i grupit kërkon miratimin e audituesit/ve, audituesit/ve ligjor/ë të vendit të huaj, njësisë/ve ekonomike audituese ose shoqërisë audituese të vendit të huaj në lidhje me transferimin e dokumentacionit përkatës gjatë kryerjes së auditimit të pasqyrave financiare të konsoliduara, si kusht i mbështetjes nga audituesi i grupit në punën e audituesit/ve, audituesit/ve ligjor/ë të vendit të huaj, njësisë/ve ekonomike audituese ose shoqërisë audituese të vendit të huaj.

3. Nëse audituesi i grupit nuk mund të zbatojë shkronjën “c” të pikës 1, ai duhet të ndërmarrë masat e duhura dhe të njoftojë autoritetin kompetent përkatës. Të tilla masa do të përfshijnë, aty ku është e zbatueshme, kryerjen e punës shtesë të auditimit ligjor, qoftë drejtpërdrejt ose duke nënkontraktuar këto detyra, në filialin përkatës.

4. Kur audituesi i grupit është subjekt i kontrollit të sigurisë për cilësinë ose një investigim në lidhje me auditimin ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara të një grupi ndërmarrjesh, audituesi i grupit, kur kërkohet, i vë në dispozicion autoritetit kompetent dokumentacionin përkatës që ai ose ajo mban në lidhje me punën e auditimit të kryer nga audituesi/it ose audituesi/it ligjor i vendit të huaj dhe njësia/të ekonomike audituese ose shoqëria/të audituese e vendit të huaj për qëllime të auditimit të grupit, duke përfshirë çdo letër pune të përshtatshëm për auditimin e grupit.

5. Autoriteti kompetent mund të kërkojë dokumentacion shtesë mbi punën e auditimit të kryer nga çdo auditues/it ligjor ose shoqëria/të audituese për qëllime të auditimit të grupit nga autoritetet kompetente përkatëse në përputhje me nenin 11 dhe nenin 33 të kësaj rregulloreje.

6. Në rast se, një njësi ekonomike mëmë ose një njësi ekonomike filial i një grupi njësisish ekonomike auditohet nga një auditues ose auditues/it ose



shoqëri/të audituese nga një vend i huaj, autoriteti kompetent mund të kërkojë dokumentacion shtesë nga autoritetet përkatëse të vendit të huaj, për punën e auditimit të kryer nga çdo auditues/it i vendit të huaj ose shoqëri/të audituese e vendit të huaj, në përputhje me kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit me vendin e huaj.

7. Bëjnë përjashtim rastet kur, një njësi ekonomike mëmë ose një njësi ekonomike filial i një grupi njësisht ekonomike auditohet nga një auditues ose disa auditues ose një njësi ose disa ekonomike audituese nga një vend i huaj që nuk ka marrëveshje marrëveshjes së bashkëpunimit, audituesi i grupit, kur kërkohet, është përgjegjës për sigurimin e dorëzimit të dokumentacionit shtesë të punës së auditimit të kryer nga ky auditues/it ose shoqëri/të audituese e vendit të huaj, duke përfshirë dokumentet e punës të rëndësishme për auditimin e grupit. Për të siguruar një dorëzim të tillë, audituesi i grupit mban një kopje të këtij dokumentacioni, ose në mënyrë alternative bie dakord me audituesin/it ose shoqëri/të audituese e vendit të huaj që atij ose asaj t'i jepet akses i pakufizuar në këto dokumentacione sipas kërkesës, ose të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër të përshtatshëm.

8. Kur dokumentet e punës së auditimit nuk mund t'i kalojnë audituesit të grupit nga një vend i huaj, për arsye ligjore ose të tjera, dokumentacioni i mbajtur nga audituesi i grupit duhet të përfshijë evidencë se ai ose ajo ka ndërmarrë procedurat e duhura për të fituar akses në dokumentacionin e auditimit, dhe në rastin e pengesave të ndryshme nga ato ligjore që dalin nga legjislacioni i vendit të huaj në fjalë, evidencë që mbështet ekzistencën e këtyre pengesave.

Neni 18

Dhënia e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë

1. Në rastin e angazhimeve të dhënies së sigurisë në lidhje me raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë të një grupi njësisht ekonomike:

a) në lidhje me raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë, audituesi i grupit mban përgjegjësinë e plotë për raportin e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të përmendur në nenin 20 të kësaj rregullore;

b) audituesi i grupit vlerëson punën e dhënies së sigurisë të kryer nga çdo ofrues/it i pavarur i

shërbimeve të dhënies së sigurisë, auditues/it, auditues/it ligjor i vendit të huaj, shoqëri/të audituese me qëllim dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë dhe dokumenton natyrën, kohën dhe nivelin e punës të kryer nga këta auditues, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, rishikimin nga audituesi i grupit të pjesëve përkatëse të dokumentacionit të sigurisë të atyre audituesve; dhe

c) audituesi i grupit rishikon punën e dhënies së sigurisë të kryer nga ofrues/it i pavarur i shërbimeve të dhënies së sigurisë, auditues/it, auditues/it ligjor/ë i vendit të huaj, shoqëri/të audituese e vendit të huaj me qëllim dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë dhe e dokumenton atë. Dokumentacioni që mbahet nga audituesi i grupit duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë autoritetit kompetent përkatës të rishikojë punën e audituesit të grupit.

2. Për qëllim të zbatimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij neni, audituesi i grupit kërkon miratimin e ofruesit/ve të pavarur të shërbimeve të dhënies së sigurisë, audituesit/ve, audituesit/ve ligjor/ë të vendit të huaj, njësisë/ve ekonomike audituese ose shoqërisë audituese në fjalë të vendit të huaj për transferimin e dokumentacionit përkatës gjatë dhënies së sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë, si kusht i mbështetjes nga audituesi i grupit në punën e ofruesit/ve të pavarur të shërbimeve të dhënies së sigurisë, auditues/ve të vendit të huaj, audituesit/ve ligjor/ë, njësisë/ve ekonomike audituese të vendit të huaj ose shoqërisë audituese.

3. Kur audituesi i grupit nuk është në gjendje të zbatojë shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni, duhet të marrë masat e duhura, si edhe të informojë autoritetin kompetent përkatës. Të tilla masa do të përfshijnë, aty ku është e zbatueshme, kryerjen e punës shtesë të dhënies së sigurisë, qoftë drejtpërdrejt ose duke i nënkontraktuar këto detyra, në filialin përkatës.

4. Kur audituesi i grupit është subjekt i kontrollit të sigurisë për cilësinë audituesi i grupit i nënshtrohet një rishikimi të dhënies së sigurisë për cilësinë ose një investigimi në lidhje me dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë të një grupi njësisht ekonomike, audituesi i grupit, kur kërkohet, i vendos në dispozicion autoritetit kompetent dokumentacionin përkatës që ai ose ajo mban në lidhje me punën e dhënies së sigurisë të



kryer nga ofruesi/it përkatës i shërbimeve të dhënies së sigurisë, audituesi/it, audituesi/it ligjor i vendit të huaj, njësia/të ekonomike audituese ose shoqëria/të audituese e vendit të huaj, me qëllim dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë, duke përfshirë çdo dokument pune që lidhet me dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë.

5. Autoriteti kompetent mund të kërkojë dokumentacion shtesë mbi punën e dhënies së sigurisë të kryer nga çdo auditues/it ligjor ose shoqëri/të audituese me qëllim dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë nga autoritetet kompetente përkatëse në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje.

6. Kur dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të një njësie ekonomike mëmë ose një njësie filial të një grupi njësisht ekonomike kryhet nga ndonjë auditues/it ose njësi/të ekonomike audituese nga një vend i huaj, autoriteti kompetent mund të kërkojë dokumentacion shtesë për punën e dhënies së sigurisë të kryer nga ndonjë auditues/it i vendit të huaj ose njësi/të ekonomike të vendit të huaj nga autoritetet kompetente përkatëse nga vendet e huaja përmes marrëveshjeve të punës.

7. Bëjnë përjashtim rastet kur, një njësi ekonomike mëmë ose një njësi ekonomike filial i një grupi njësisht ekonomike, kur ndonjë ofrues/it i pavarur i shërbimeve të dhënies së sigurisë, auditues/it ose njësi/të ekonomike të vendit të huaj që nuk kanë marrëveshje pune të kryer për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë së një njësie ekonomike mëmë ose një njësie ekonomike ndihmëse të një grupi njësisht ekonomike, audituesi i grupit, kur kërkohet, është gjithashtu përgjegjës për sigurimin e dorëzimit të duhur të dokumentacionit shtesë mbi punën e dhënies së sigurisë të kryer nga ky ofrues/it i pavarur i shërbimeve të dhënies së sigurisë, auditues/it ose njësi/të ekonomike audituese e vendit të huaj, duke përfshirë dokumentet e punës që lidhen me dhënien e sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë. Për të siguruar një dorëzim të tillë, audituesi i grupit mban një kopje të këtij dokumentacioni, ose në mënyrë alternative bie dakord me ofruesin/it e pavarur të shërbimeve të dhënies së sigurisë, audituesin/it ose njësinë/të ekonomike audituese të vendit të huaj që ai apo ajo duhet t'i jepet akses i pakufizuar në këtë dokumentacion sipas kërkesës,

ose të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër të përshtatshëm.

8. Kur fletët e punës për dhënien e sigurisë nuk mund t'i kalojnë audituesit të grupit nga një vend i huaj, për arsye ligjore ose të tjera, dokumentacioni i mbajtur nga audituesi i grupit duhet të përfshijë evidencë se ai ose ajo ka ndërmarrë procedurat e duhura për të marrë akses në dokumentacionin e dhënies së sigurisë, dhe në rastin e pengesave të ndryshme nga ato ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i vendit të huaj në fjalë, evidencë që mbështesin ekzistencën e këtyre pengesave.

Neni 19

Raporti i auditimit

1. Audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese duhet të paraqesin konkluzionet e auditimit ligjor në një raport auditimi. Raporti përgatitet në përputhje me kërkesat e standardeve të auditimit sipas nenit 37 të ligjit për auditimin dhe nenit 13 të kësaj rregulloreje.

2. Raporti i auditimit duhet të jetë me shkrim dhe:

a) identifikon njësinë ekonomike, pasqyrat financiare vjetore ose të konsoliduara të së cilës janë objekt i auditimit ligjor; specifikon pasqyrat financiare vjetore ose të konsoliduara, datën dhe periudhën që ato mbulojnë, si edhe identifikon kornizën e raportimit financiar që është përdorur për përgatitjen e tyre;

b) përfshin një përshkrim të objektit të auditimit ligjor, i cili identifikon, të paktën, standardet e auditimit në përputhje me të cilat është kryer auditimi ligjor;

c) përfshin një opinion auditimi, i cili duhet të jetë ose i pakualifikuar, i kualifikuar ose një opinion i kundërt dhe shpreh qartë opinionin e audituesit/ve ligjor/ë ose shoqërisë audituese:

i. nëse pasqyrat financiare vjetore japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me kuadrin përkatës të raportimit financiar; dhe,

ii. aty ku është e përshtatshme, nëse pasqyrat financiare vjetore janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Nëse audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese nuk mund të shprehin një opinion auditimi, raporti duhet të përmbajë një refuzim të opinionit;

ç) i referohet çdo çështjeje tjetër për të cilën audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese



tërheq/in vëmendjen nëpërmjet nënvizimit pa e cilësuar opinionin e auditimit;

d) përfshin një opinion dhe një deklaratë, ku të dyja bazohen në punën e ndërmarrë gjatë auditimit, në bazë të raportimeve të parashikuara në kuadrin ligjor për kontabilitetin dhe raportimin financiar, si edhe ku është e zbatueshme, për raportimin e qëndrueshmërisë.

dh) jep një paraqitje mbi çdo pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme rreth aftësisë së njësisë ekonomike për të vazhduar si vijimësi;

e) identifikon vendin e themelimit të audituesit/ve ligjor/ë ose shoqërisë audituese.

3. Kur auditimi ligjor është kryer nga më shumë se një auditues ligjor ose shoqëri audituese, auditues/it ligjorë ose shoqëria/të audituese bien dakord për rezultatet e auditimit ligjor dhe paraqesin një raport dhe opinion të përbashkët. Në rast mosmarrëveshjeje, çdo auditues ligjor ose shoqëri audituese paraqet opinionin e tij ose të saj në një paragraf të veçantë të raportit të auditimit dhe duhet të deklarojë arsyen e mosmarrëveshjes.

4. Raporti i auditimit nënshkruhet dhe i vendoset data nga audituesi ligjor. Kur një shoqëri audituese kryen auditimin ligjor, raporti i auditimit nënshkruhet nga të paktën njëri prej audituesit/ve ligjor/ë që kryen/jnë auditimin ligjor në emër të shoqërisë audituese. Kur më shumë se një auditues ligjor ose shoqëri audituese janë angazhuar njëkohësisht, raporti i auditimit nënshkruhet nga të gjithë audituesit ligjorë ose të paktën nga audituesit ligjorë që kryejnë auditimin ligjor në emër të çdo shoqërie audituese.

5. Raporti i audituesit ligjor ose i shoqërisë audituese për pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni. Në raportimin e përputhshmërisë së raportit të drejtimit të brendshëm dhe pasqyrave financiare, siç kërkohet nga shkronja “d” e pikës 2 të këtij neni, audituesi ligjor ose shoqëria audituese merr në konsideratë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin e konsoliduar të drejtimit të brendshëm. Në rast se pasqyrat financiare vjetore të ndërmarrjes mëmë i janë bashkëlidhur pasqyrave financiare të konsoliduara, raportet e audituesve ligjorë ose shoqërive të auditimit, të përmendura në këtë nen, mund të paraqiten në një raport auditimi.

Neni 20

Raporti i dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë

1. Audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese paraqet rezultatet e dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë në një raport të dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Ky raport përgatitet në përputhje me kërkesat e nenit 37 të ligjit për auditimin dhe nenin 13 të kësaj rregulloreje.

2. Raporti i dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë duhet të jetë me shkrim dhe:

a) identifikon njësinë ekonomike, raportimi vjetor ose i konsoliduar i qëndrueshmërisë i së cilës është objekt i angazhimit të dhënies së sigorisë; specifikon raportimin vjetor ose të konsoliduar të qëndrueshmërisë, datën, dhe periudhën e mbuluar, si edhe identifikon kornizën e raportimit të qëndrueshmërisë që është përdorur për përgatitjen e tij;

b) përfshin një përshkrim të objektit të dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë, i cili identifikon, të paktën, standardet e dhënies së sigorisë në përputhje me të cilat është kryer dhënia e sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë;

c) përfshin opinionin e parashikuar në kuadrin ligjor të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

3. Kur dhënia e sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë është kryer nga më shumë se një auditues ligjor ose shoqëri audituese, audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese bien dakord për rezultatet e dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe dorëzojnë një raport dhe opinion të përbashkët. Në rast mosmarrëveshjeje, çdo auditues ligjor ose shoqëri audituese duhet të paraqesë opinionin e tij ose të saj në një paragraf të veçantë të raportit të dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe duhet të deklarojë arsyen e mosmarrëveshjes.

4. Raporti i dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë nënshkruhet dhe i vendoset data nga audituesi ligjor që kryen dhënien e sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Kur një shoqëri audituese kryen dhënien e sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë, raporti i dhënies së sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë duhet të ketë nënshkrimin e të paktën audituesit/ve ligjorë që kryen dhënien e sigorisë për raportimin e qëndrueshmërisë në emër të shoqërisë audituese.



Kur më shumë se një auditues ligjor ose shoqëri audituese janë angazhuar njëkohësisht, raporti i dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë nënshkruhet nga të gjithë audituesit ligjorë ose të paktën nga audituesit ligjorë që kryejnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në emër të çdo shoqërie audituese.

5. Kur i njëjti auditues ligjor kryen auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, raporti i dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë mund të përfshihet si një seksion i veçantë i raportit të auditimit.

6. Raporti i audituesit ligjor ose i shoqërisë audituese për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuar në pikat 1 deri në 5 të këtij neni.

Neni 21

Shkarkimi dhe dorëheqja e audituesve ligjorë ose shoqërive audituese

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese mund të shkarkohet përpara përfundimit të auditimit vetëm kur ka arsye të mjaftueshme. Papajtueshmëria e mendimeve për trajtimet kontabël, raportimin financiar ose procedurat e auditimit, ose, aty ku është e zbatueshme, mbi raportimin e qëndrueshmërisë ose procedurat e dhënies së sigurisë, nuk përbëjnë arsye të vlefshme për shkarkim.

2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike është autoriteti kompetent për shqyrtimin e ankesave për rastet e shkarkimit të audituesit ligjor apo shoqërisë audituese nga njësia ekonomike, përpara përfundimit të angazhimit të auditimit ligjor. Njësia ekonomike e audituar dhe audituesi ligjor ose shoqëria audituese informojnë BMP-në në lidhje me shkarkimin ose dorëheqjen e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese gjatë kohëzgjatjes së emërimit dhe japin një argumentim të mjaftueshëm për arsyet.

3. Njësia ekonomike e audituar, subjekt i auditimit të pasqyrave financiare dhe audituesi ligjor apo shoqëria audituese, subjekt i një kërkesë për shkarkim, në mënyrë të pavarur, informojnë organizatën profesionale të audituesve ligjorë dhe japin argumentim të mjaftueshëm për arsyet. Për çdo rast të paraqitur, organizata profesionale i

përgatit një relacion bordit, për shkarkimin gjatë kohës së angazhimit të auditimit ligjor.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, në rast dorëheqjeje nga detyra e auditimit, njofton, me shkrim, organizatën profesionale për motivet e dorëheqjes. Në këtë rast, funksionin dhe përgjegjësinë e ndërmjetësimit apo shqyrtimit të konfliktit për rastin e ka kryetari i këshillit drejtues të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

5. Detyrimi për dhënien e informacionit, të parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohet gjithashtu për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

6. Në rastin e auditimit ligjor apo dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të një NJEIP:

a) aksionarët/ortakët që përfaqësojnë 5% ose më shumë të të drejtave të votës ose të pjesëmarrjes në kapital;

b) organet e tjera drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësive ekonomike të audituara; ose

c) BMP-ja;

kanë të drejtë të kërkojnë pranë gjykatës kompetente shkarkimin e audituesit/ve ligjor/ë ose shoqërisë/ve audituese kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme.

Neni 22

Ruajtja e dokumentacionit

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese do të ruajnë, për një periudhë prej të paktën 5 (pesë) vjet pas krijimit, dokumentet dhe informacionin e përmendur në nenin 5, nenin 17, nenin 19, në pikën 3, të nenit 24, nenin 10, nenin 26, nenin 27, në pikën 4 deri në 7, të nenit 28, nenin 29, nenin 30, pikat 1 dhe 2 e nenit 31, nenin 37, të kësaj rregulloreje, si edhe në nenin 36 të ligjit për auditimin dhe procedurat e përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 5, të nenit 46, të ligjit për auditimin.

KREU V

DISPOZITA TË POSAÇME PËR AUDITIMIN LIGJOR TË NJËSIVE EKONOMIKE ME INTERES PUBLIK

Neni 23

Fusha e veprimtimit

1. Ky krye përcakton kërkesa të posaçme për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të konsoliduara të njësive ekonomike me



interes publik, rregullat për organizimin dhe përzgjedhjen e audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese nga njësitë ekonomike me interes publik, për promovimin e pavarësisë së tyre dhe shmangien e konfliktit të interesave dhe rregullat për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me këto kërkesa nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese.

2. Dispozitat e këtij kreu zbatohen, për:

a) të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese që kryejnë auditime ligjore të njërive ekonomike me interes publik të përcaktuara në pikën 23 të nenit 2 të ligjit për auditimin dhe vendimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre;

b) të gjitha njësitë ekonomike me interes publik të përcaktuara në pikën 23, të nenit 2, të ligjit për auditimin dhe vendimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre.

Seksioni I

Kushtet për kryerjen e auditimit ligjor të njërive ekonomike me interes publik

Neni 24

Tarifat e auditimit

1. Tarifat për kryerjen e auditimeve ligjore të NJEIP nuk duhet të jenë tarifa të kushtëzuara. Për qëllime të këtij neni, tarifat e kushtëzuara të angazhimeve të auditimit, nënkuptojnë tarifat e përlogaritura mbi një bazë të paracaktuar që lidhet me rezultatin e një transaksioni ose rezultatin e punës së kryer. Tarifatat e vendosura nga një gjykatë apo autoritet kompetent nuk janë tarifa të kushtëzuara.

2. Kur shoqëria audituese i ofron subjektit të audituar, ndërmarrjes së saj mëmë ose të kontrolluar, për një periudhë prej tre ose më shumë vitesh financiare të njëpasnjëshme, shërbime joaudituese të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 25, pika 2, të kësaj rregulloreje, tarifat totale për këto shërbime nuk duhet të tejkalojnë 70% të mesatares së tarifave të paguara gjatë tre vjetëve të fundit financiare të njëpasnjëshme për auditimin/et

ligjor/e të subjektit të audituar dhe, kur është e zbatueshme, të ndërmarrjes së saj mëmë, të ndërmarrjeve të saj të kontrolluara dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara të atij grupi ndërmarrjesh.

3. Në rastin kur totali i tarifave të paguara nga njësia ekonomike me interes publik çdo vit, për tre vitet financiare të fundit të njëpasnjëshme, është më shumë se 15% i totalit të honorarëve/tarifave të faturuara për shërbimet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të atyre viteve të kryera nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit, apo sipas rastit audituesit të grupit, duhet t'i komunikohet komitetit të auditimit të njësisë ekonomike të audituar apo në mungesë personave të ngarkuar me qeverisjen, për rrethanat e kërcënimit të pavarësisë dhe masat e marra për zbutjen e këtyre kërcënimeve. Komiteti i auditimit do të shqyrtojë nëse angazhimi i auditimit duhet t'i nënshtrohet një rishikimi të kontrollit të cilësisë së angazhimit nga një shoqëri tjetër audituese përpara lëshimit të raportit të auditimit.

Në rastin kur totali i tarifave të paguara nga njësia ekonomike me interes publik për shoqërinë audituese ose, sipas rastit, audituesit të grupit që kryen auditimin ligjor, vazhdojnë të kalojnë 15% të tarifave totale të paguar, komiteti i auditimit do të vendosë mbi bazën e arsyeve objektive nëse shoqëria audituese ose audituesi i grupit, i një entiteti ose grupi të tillë subjektesh, mund të vazhdojë të kryejë auditimin ligjor për një periudhë shtesë, e cila në asnjë rast nuk duhet të kalojë dy vjet.

4. Shoqëria audituese duhet të verifikojë dhe garantojë që edhe audituesit e angazhuar prej saj, përmes formave të ndryshme të nënkontraktimit të përmbushin kërkesat e këtij neni.

5. Mos zbatimi i kërkesave të këtij neni do të konsiderohen shkelje e pavarësisë dhe do të jenë subjekt i masave disiplinore në zbatim të nenit 55 të ligjit të auditimit dhe të rregullores për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

Neni 25

Ndalimi i ofrimit të shërbimeve joaudituese

1. Një shoqëri audituese që kryen auditimin ligjor të një NJEIP, ose çdo anëtar i rrjetit të cilit i përket shoqëria audituese, nuk do të kryejë për njësinë ekonomike të audituar, ndërmarrjes së saj mëmë apo të kontrolluar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shërbime joaudituese të ndaluara për:



a) periudhën ndërmjet fillimit të periudhës së audituar dhe lëshimit të raportit të auditimit; dhe

b) vitin financiar që i paraprin menjëherë periudhës së përmendur në shkronjën “a” në lidhje me shërbimet e renditura në shkronjën “e” të pikës 2 të këtij neni.

2. Për qëllime të këtij neni, shërbimet joaudituese të ndaluara janë:

a) shërbimet e konsulencës tatimore që kanë të bëjnë me:

i. përgatitjen e deklaratave tatimore;

ii. llogaritjen e detyrimeve tatimore të listë pagesave;

iii. detyrimet doganore;

iv. identifikimin e subvencioneve publike dhe lehtësirave tatimore (fiskale) përveç rasteve kur ofrimi i këtij shërbimi nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit vjen si rrjedhojë e kërkesës ligjore;

v. shërbime mbështetëse që lidhen me kontrollin tatimore nga autoritetet tatimore, përveç rasteve kur ofrimi i këtij shërbimi nga audituesi ligjor/shoqëria e auditimit vjen si rrjedhojë e kërkesës ligjore;

vi. llogaritja e tatimeve direkte dhe indirekte, dhe vlerës së tatimit të shtyrë;

vii. ofrimin e shërbimit të konsulencës në lidhje me legjislacionin tatimor;

b) shërbime që kërkojnë pjesëmarrjen në çfarëdo roli drejtues apo vendim marrjen e njësisë së audituar;

c) mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e regjistrave kontabël dhe të pasqyrave financiare;

ç) shërbime të llogaritjes së borderove të pagave;

d) hartimi dhe zbatimi i procedurave të kontrollit të brendshëm ose të menaxhimit të riskut në lidhje me përgatitjen dhe/ose kontrollin të raportimit financiar apo hartimin dhe zbatimin e sistemeve informatike të raportimit financiar;

dh) shërbimet e vlerësimit, duke përfshirë këtu vlerësime që lidhen me shërbime të aktuarit dhe proceseve gjyqësore;

e) shërbimet ligjore, që lidhen me:

i. kryerjen e këshillimit ligjor të përgjithshëm;

ii. negocimin në emër dhe për llogari të njësisë ekonomike të audituar; dhe

iii. shërbime të mbrojtjes në procese gjyqësore;

ë) shërbime që lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm të njësisë ekonomike të audituar;

f) shërbime që lidhen me financimin, strukturën dhe shpërndarjen e kapitalit, dhe strategjinë e investimit të njësisë ekonomike të audituar, përveç

ofrimin të shërbimeve të dhënies të sigurisë në lidhje me pasqyrat financiare, të tilla si lëshimi i letrave të sigurisë në lidhje me prospektet e lëshuara nga njësi ekonomike të audituar;

g) promovimin, tregtimin ose nënshkrimin e kuotave/aksioneve në njësinë e audituar;

gj) shërbimet e burimeve njerëzore, që lidhen me:

i. drejtimin në pozicione që ushtrojnë të rëndësishëm në përgatitjen e të dhënave të kontabilitetit apo raportimit financiar, të cilat janë subjekt i auditimit ligjor, kur këto shërbime përfshijnë:

- kërkimin apo përzgjedhjen e kandidatëve për këto pozicione; ose

- kryerjen e kontrollit të referencave të kandidatëve për këto pozicione;

ii. strukturimin e funksioneve organizative të njësisë; dhe

iii. kontrollin e kostove.

3. Lejohet ofrimi i shërbimeve joaudituese, të përcaktuara në shkronjat (a)(i), (a)(iv) deri në (a)(vii) dhe (dh), të pikës 2 të këtij neni, në rast se shoqëria audituese plotëson njëherësh kërkesat e mëposhtme:

a) këto shërbime nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë ose kanë efekt jo material, në zëra të veçantë apo së bashku, në pasqyrat financiare të audituara;

b) vlera e efektit që kanë në pasqyrat financiare të audituara është dokumentuar dhe argumentuar në mënyrë të qartë në raportin shtesë drejtuar komitetit të auditimit; dhe

c) parimet e pavarësisë të përcaktuara në këtë ligj respektohen nga shoqëria audituese dhe audituesit ligjorë të angazhuar prej saj.

4. Një shoqëri audituese dhe një auditues ligjorë i angazhuar prej saj, që kryen auditime ligjore të NJEIP-së dhe, nëse i përkasin një rrjeti, çdo anëtar i këtij rrjeti, mund t'i ofrojë subjektit të audituar, ndërmarrjes mëmë ose atyre të kontrolluara, shërbime joaudituese të ndryshme nga ato të ndaluara, me miratimin e komitetit të auditimit, pasi ai të ketë vlerësuar siç duhet kërcënimet ndaj pavarësisë dhe masat mbrojtëse të zbatuara, sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje. Komiteti i auditimit, aty ku është e zbatueshme, nxjerr udhëzime në lidhje me shërbimet e përmendura në pikën 3 të këtij neni.

5. Kur një anëtar i një rrjeti, të cilit i përket shoqëria audituese ose audituesi ligjor, i angazhuar prej saj në auditim ligjor të një NJEIP-je, ofron ndonjë nga shërbimet joaudituese, të përmendura në



pikën 2 të këtij neni, ndaj një ndërmarrjeje të themeluar në një vend të huaj, e cila kontrollohet nga NJEIP-ja, ata duhet të vlerësojnë nëse pavarësia e tyre do të rrezikohej nga ofrimi i këtyre shërbimeve nga anëtarë të rrjetit.

Nëse cenohet pavarësia, shoqëria audituese dhe audituesi ligjor i angazhuar prej saj, aty ku është e mundur, duhet të zbatojnë masa mbrojtëse për të zbutur kërcënimet e shkaktuara nga ofrimi i këtyre shërbimeve në një vend të huaj. Shoqëria audituese dhe audituesi ligjor i angazhuar prej saj mund të vazhdojë të kryejë auditimin ligjor të NJEIP-së, vetëm nëse ai/ajo mund të justifikojë, sipas parashikimeve të nenit 10 të kësaj rregulloreje, se ofrimi i këtyre shërbimeve nuk ndikon në gjykimin e tij/saj profesional dhe në raportin e auditimit.

6. Për qëllimet e këtij neni:

a) përfshirja në vendimarrjen e njësisë ekonomike të audituar dhe ofrimi i shërbimeve të përmendura në shkronjat “b”, “c” dhe “d” të pikës 2 të këtij neni, do të konsiderohet se ndikon në pavarësinë e tij/saj në të gjitha rastet dhe nuk mund të zbutet me asnjë masë mbrojtëse.

b) ofrimi i shërbimeve të përmendura në pikën 2, të këtij neni, përveç shkronjave “b”, “c” dhe “d” të tyre do të konsiderohen se ndikojnë pavarësinë dhe për rrjedhojë kërkohet marrja e masave mbrojtëse për të zbutur kërcënimet e shkaktuara prej saj.

7. Dispozitat e këtij neni vlejnë dhe mund të zbatohen sipas rastit edhe për audituesit ligjorë apo shoqëritë e audituese që ofrojnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të NJEIP-së.

Neni 26

Përgatitja për auditimin ligjor dhe vlerësimi i kërcënimeve ndaj pavarësisë

1. Përpara pranimit ose vazhdimit të kryerjes së angazhimit të auditimit ligjor të një NJEIP, shoqëria audituese dhe audituesi ligjor i angazhuar prej saj duhet të vlerësojë dhe dokumentojë, përveç sa parashikuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje; edhe:

a) nëse ai/ajo është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 24 dhe nenit 25 në lidhje me tarifat dhe shërbimet e ofruara ndaj njësisë ekonomike subjekt auditimi;

b) nëse janë përmbushur kushtet e nenit 42 të ligjit për auditimin, në lidhje me kohëzgjatjen e angazhimit;

c) integritetin e anëtarëve të organeve mbikëqyrëse, administrative dhe drejtuese të NJEIP.

2. Shoqëria audituese, duhet:

a) t'i konfirmojë çdo vit me shkrim komitetit të auditimit se, shoqëria audituese, audituesi/t ligjor/ë i/të angazhuar prej saj, dhe ortakët/aksionerët apo drejtuesit e saj që kryejnë auditimin ligjor, janë të pavarur nga subjekti i audituar;

b) të diskutojë me komitetin e auditimit kërcënimet ndaj pavarësisë dhe masat mbrojtëse të marra për të zbutur këto kërcënimet.

Neni 27

Parregullsitë

1. Kur shoqëria audituese ose audituesi ligjor i angazhuar prej saj që kryen auditimin ligjor të një NJEIP dyshon ose ka arsye për të dyshuar se kanë ndodhur ose mund të ndodhin parregullsi, përfshirë mashtrimin në lidhje me pasqyrat financiare të njësisë ekonomike të audituar, ai/ajo duhet të informojë njësinë ekonomike të audituar që të hetojë çështjen dhe të marrë masat e duhura me qëllim korrigjimin dhe parandalimin e tyre në të ardhmen.

2. Në rast se njësia ekonomike e audituar nuk e heton çështjen, shoqëria audituese ose audituesi ligjor i angazhuar prej saj duhet të informojë sipas rastit autoritetet kompetente të caktuara me ligj për hetimin e këtyre parregullsive. Njoftimi, në mirëbesim, i këtyre parregullsive, te këto autoritete, nuk përbën shkelje të ndonjë kufizimi kontraktual ose ligjor për dhënien e informacionit.

3. Dispozitat e këtij neni vlejnë dhe mund të zbatohen sipas rastit edhe për audituesit ligjorë apo shoqëritë e audituese që ofrojnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë të NJEIP-së.

Neni 28

Rishikimi i kontrollit të cilësisë së angazhimit

1. Para lëshimit të raportit të auditimit dhe raportit shtesë për komitetin e auditimit, të përcaktuara në nenin 29 dhe nenin 30 të kësaj rregulloreje, duhet të realizohet një rishikim i kontrollit të cilësisë së angazhimit për të vlerësuar nëse audituesi ligjor ose ortakë kryesor i auditimit kanë formuar në mënyrë të arsyeshme opinionin dhe konkluzionet e shprehura në draftin e këtyre raporteve.



2. Rishikimi do të kryhet nga një rishikues i kontrollit të cilësisë së angazhimit. Rishikuesi duhet të jetë një auditues ligjor, i cili nuk është i përfshirë në kryerjen e auditimit ligjor, subjekt i rishikimit.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, kur auditimi ligjor kryhet nga një shoqëri audituese dhe të gjithë audituesit ligjorë kanë qenë të përfshirë në kryerjen e auditimit ligjor ose kur auditimi ligjor është kryer nga një auditues ligjor, i cili nuk është ortak ose punonjës i një shoqërie audituese, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të marrë masat që rishikimi të kryhet nga një tjetër auditues ligjor. Për qëllimet e këtij neni, dhënia e dokumentacionit apo e informacionit rishikuesit të pavarur nuk përbën shkelje të dispozitave për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të sekretit profesional. Dokumentacioni apo informacioni që i ofrohet rishikuesit për qëllimet e këtij neni do t'i nënshtrohet sekretit profesional.

4. Gjatë kryerjes së rishikimit, rishikuesi duhet të paktën të dokumentojë të dhënat për sa më poshtë:

a) informacionin e siguruar, verbalisht dhe me shkrim, nga audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit në mbështetje të gjykimeve të rëndësishme, gjetjet kryesore nga kryerja e procedurave të auditimit, si dhe konkluzionet e nxjerra nga këto gjetje, pavarësisht nëse kërkohet apo jo nga rishikuesi;

b) opinionin e audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit, ashtu siç shprehen në draftin e raporteve të përcaktuara nenin 29 dhe nenin 30 të kësaj rregulloreje.

5. Rishikimi duhet të vlerësojë së paku elementet e mëposhtme:

a) pavarësinë e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese nga njësia ekonomike e audituar;

b) rreziqet e rëndësishme që lidhen me auditimin ligjor dhe që audituesi ligjor ose ortaku kryesor i auditimit ka identifikuar gjatë kryerjes së auditimit dhe masat që ai ka marrë për t'i adresuar në mënyrë të përshtatshme këto rreziqe;

c) gjykimin profesional të audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit, veçanërisht në lidhje me nivelin e materialitetit dhe rreziqet e rëndësishme të përcaktuara në shkronjën “b” të kësaj pike;

ç) çdo kërkesë për këshillim drejtuar ekspertëve të jashtëm dhe zbatimin e këtyre këshillave;

d) natyrën dhe përhapjen e anomalive, të korrigjuara ose jo, të identifikuara në pasqyrat financiare gjatë kryerjes së auditimit;

dh) çështjet e diskutuara me komitetin e auditimit dhe organet drejtuese dhe/ose mbikëqyrëse të njësisë ekonomike të audituar;

e) çështjet e diskutuara me autoritetet kompetente dhe, sipas rastit, me palë të treta;

ë) nëse dokumentacioni dhe informacionet e dosjes së auditimit, të përzgjedhura nga rishikuesi, mbështesin opinionin e audituesit ligjor ose të ortakut kryesor të auditimit të shprehur në draftin e raporteve të përcaktuara në nenin 29 dhe nenin 30 të kësaj rregulloreje.

6. Rishikuesi diskuton rezultatet e rishikimit me audituesin ligjor ose ortakun kryesor të auditimit. Shoqëria audituese vendos procedura për përcaktimin e mënyrës në të cilën do të zgjidhet çdo mosmarrëveshje ndërmjet ortakut kryesor të auditimit dhe rishikuesit.

7. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese dhe rishikuesi duhet të dokumentojnë rezultatet e rishikimit së bashku me gjykimin profesional në bazë të këtyre rezultateve.

Neni 29

Raporti i auditimit

1. Audituesi/it ligjor/ë ose shoqëria/të audituese paraqet konkluzionet e auditimit ligjor të njësisë ekonomike me interes publik në një raport auditimi.

2. Raporti i auditimit përgatitet në përputhje me nenin 37 të ligjit për auditimin dhe duhet të paktën:

a) të përmbajë nga kush ose nga cili organ u caktua audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese;

b) të përmbajë datën e emërimit dhe periudhën e angazhimit total të pandërprerë, duke përfshirë rinovimet dhe rimekimet e mëparshme të audituesve ligjorë ose shoqërive audituese;

c) të sigurojë, në mbështetje të opinionit të auditimit, sa vijon:

i. një përshkrim të rreziqeve më të konsiderueshme të vlerësuara të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit;

ii. një përmbledhje të reagimit të audituesit ndaj këtyre rreziqeve; dhe

iii. kur është e përshtatshme, vëzhgimet kryesore të identifikuara në lidhje me ato rreziqe.

Kur është e përshtatshme për informacionin e mësipërm të dhënë në raportin e auditimit në lidhje me çdo rrezik të konsiderueshëm të vlerësuar të anomalive materiale, raporti i auditimit duhet të



përmbajë një referencë të qartë për informacionet përkatëse në pasqyrat financiare.

ç) të shpjegojë deri në çfarë mase është konsideruar që auditimi ligjor mund të zbulojë parregullsitë, duke përfshirë mashtrimin;

d) të konfirmojë që opinioni i auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit të përmendur në nenin 30 të kësaj rregullore;

dh) të deklarojë se nuk janë dhënë shërbimet e ndaluara joaudituese të përmendura në pikën 1 të nenit 25 të kësaj rregullore dhe se audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese kanë mbetur të pavarura nga njësia ekonomike e audituar në kryerjen e auditimit;

e) të shpalosë informacionin për çdo shërbim, përveç shërbimit të auditimit ligjor, të cilat i janë dhënë njësisë ekonomike të audituar dhe ndërmarrjeve të saj të kontrolluara nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese, dhe që nuk është shpalosur në raportin e drejtimit ose në pasqyrat financiare.

3. Përveç siç kërkohet nga shkronja “e” e pikës 2 të këtij neni, raporti i auditimit nuk duhet të përmbajë asnjë ndërreferim në raportin shtesë për komitetin e auditimit të përmendur në nenin 30 të kësaj rregulloreje. Raporti i auditimit duhet të jetë në gjuhë të kuptueshme dhe të qartë.

4. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese nuk duhet të përdorin emrin e ndonjë autoriteti kompetent në një mënyrë që do të tregonte ose sugjeronte vërtetimin ose miratimin nga ai autoritet të raportit të auditimit.

Neni 30

Raporti shtesë për komitetin e auditimit

1. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese që kryejnë auditime ligjore të njësive ekonomike me interes publik duhet të dorëzojnë një raport shtesë komitetit të auditimit të njësisë ekonomike të audituar, jo më vonë se data e dorëzimit të raportit të auditimit të përmendur në nenin 29 të kësaj rregulloreje.

Nëse njësia ekonomike e audituar nuk ka një komitet auditimi, raporti shtesë i dorëzohet organit që kryen funksione të barasvlershme brenda njësisë ekonomike të audituar.

2. Raporti shtesë për komitetin e auditimit bëhet me shkrim. Ai shpjegon rezultatet e auditimit ligjor të kryer dhe të paktën:

a) përfshin deklaratën e pavarësisë të përmendur në pikën 2 të nenit 26 të kësaj rregullore dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 47 të ligjit për auditimin;

b) kur auditimi ligjor është kryer nga një shoqëri audituese, raporti duhet të identifikojë çdo partner kryesor auditimi të përfshirë në auditim;

c) Në rastet kur audituesi ligjor ose shoqëria audituese kanë deleguar kryerjen e disa aktiviteteve të një auditues ligjor ose shoqëri audituese tjetër që nuk është anëtare e të njëjtit rrjet, ose kur është përdorur puna e ekspertëve të jashtëm, ky fakt duhet të pasqyrohet në raport. Në raport duhet të konfirmohet gjithashtu se audituesi ligjor ose shoqëria audituese kanë marrë një konfirmim nga audituesi ose shoqëria audituese dhe/ose eksperti i jashtëm i angazhuar, lidhur me pavarësinë e tyre;

ç) përshkruan natyrën, shpeshtësinë dhe shtrirjen e komunikimit me komitetin e auditimit ose organin që kryen funksione të barasvlershme brenda njësisë ekonomike të audituar, organit drejtues dhe organit administrativ ose mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar, duke përfshirë datat e takimeve me ato organe;

d) përfshin një përshkrim të objektit dhe kohës së auditimit;

dh) kur janë emëruar më shumë se një auditues ligjor ose shoqëri audituese, përshkruan shpërndarjen e detyrave ndërmjet audituesve ligjorë dhe/ose shoqërive audituese;

e) përshkruan metodologjinë e përdorur, duke përfshirë cilat kategori të bilancit janë verifikuar drejtpërdrejt dhe cilat kategori janë verifikuar bazuar në testimin e sistemit dhe të pajtueshmërisë, duke përfshirë një shpjegim të çdo ndryshimi thelbësor në vlerësimin e sistemit dhe zbatimin e testimit kur krahasohet me vitin e kaluar, edhe nëse auditimi ligjor i vitit të kaluar është kryer nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese të tjerë;

ë) jep informacion për nivelin sasior të materialitetit të përdorur për kryerjen e auditimit ligjor për pasqyrat financiare në tërësi dhe kur është e zbatueshme për nivelin ose nivelet e materialitetit për klasa të veçanta transaksionesh, bilancet e llogarisë ose deklarata, dhe jep informacion për faktorët cilësorë që janë marrë parasysh për vendosjen e nivelit të materialitetit;



f) raporton dhe shpjegon gjykimet rreth ngjarjeve ose kushteve të identifikuar gjatë auditimit, të cilat mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar si vijimësi dhe nëse ato përbëjnë një pasiguri materiale, dhe siguron një përmbledhje të të gjitha garancive, letrave të sigurisë, ndërhyrjeve ose mbështetjeve nga institucionet publike apo ndihmat shtetërore dhe masave të tjera mbështetëse që janë marrë parasysh gjatë vlerësimit të vijimësisë;

g) raporton për çdo mangësi të konsiderueshme në sistemin të kontrollit të brendshëm financiar të njësisë ekonomike të audituar ose, në rastin e pasqyrave financiare të konsoliduara, të ndërmarrjes mëmë dhe/ose në sistemin e kontabilitetit. Për çdo mangësi të tillë të konsiderueshme, në raportin shtesë duhet të tregohet nëse mangësia në fjalë është zgjidhur apo jo nga niveli drejtues;

gj) raporton çdo çështje të rëndësishme që përfshin mospërputhje aktuale ose të dyshuar me ligjet dhe rregulloret ose statutet që janë identifikuar gjatë auditimit, për aq sa ato konsiderohen të rëndësishme për t'i mundësuar komitetit të auditimit të përmbushë detyrat e tij;

h) raporton dhe vlerëson metodat e vlerësimit të përdorura për zërat e ndryshëm në pasqyrat financiare vjetore ose të konsoliduara, duke përfshirë çdo ndikim të ndryshimeve të këtyre metodave;

i) në rastin e një auditimi ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara, shpjegon objektin e konsolidimit dhe kriteret e përjashtimit të përdorura nga njësia e audituar për njësitë ekonomike jo të konsoliduara, nëse ka ndonjë, dhe nëse këto kriteret të përdorura janë në përputhje me kornizën e raportimit financiar;

j) aty ku është e zbatueshme, identifikon çdo punë auditimi të kryer nga audituesi/it, audituesi/it ligjor i vendit të huaj, njësia/të ekonomike audituese ose shoqëria/të audituese e vendit të huaj në lidhje me një auditim ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara përveç nga anëtarët e të njëjtit rrjet të cilit i përket audituesi i pasqyrave financiare të konsoliduara;

k) tregon nëse të gjitha shpjegimet dhe dokumentet e kërkuara janë dhënë nga njësia ekonomike e audituar;

l) raporton:

i. çdo vështirësi të konsiderueshme që haset gjatë auditimit ligjor;

ii. çdo çështje të konsiderueshme që lind nga auditimi ligjor që është diskutuar ose ka qenë objekt korrespondence me nivelin drejtues; dhe

iii. çdo çështje tjetër që lind nga auditimi ligjor që sipas gjykimit profesional të audituesit, është i rëndësishëm për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Me kërkesë të një audituesi ligjor, një shoqërie audituese ose komiteti auditimi, audituesi/it ligjor ose shoqëria/të audituese diskuton çështjet kryesore që dalin nga auditimi ligjor, të përmendura në raportin shtesë për komitetin e auditimit, dhe veçanërisht në pikën “j” të nënparagrafit të parë, me komitetin e auditimit, organin administrativ ose, aty ku është e zbatueshme, organin mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar.

3. Kur më shumë se një auditues ligjor ose shoqëri audituese janë angazhuar njëkohësisht, dhe ndërmjet tyre ka lindur ndonjë mosmarrëveshje për procedurat e auditimit, rregullat e kontabilitetit ose ndonjë çështje tjetër në lidhje me kryerjen e auditimit ligjor, arsyet për një mosmarrëveshje të tillë shpjegohen në raportin shtesë për komitetin e auditimit.

4. Raporti shtesë për komitetin e auditimit duhet të nënshkruhet dhe të ketë datë. Kur një shoqëri audituese kryen auditimin ligjor, raporti shtesë për komitetin e auditimit duhet të nënshkruhet nga audituesit ligjorë që kryejnë auditimin ligjor në emër të shoqërisë audituese.

5. Me kërkesë të BMP-së, audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese do t'u vënë në dispozicion pa vonesë raportin shtesë për komitetin e auditimit.

Neni 31

Raportimi të mbikëqyrësit të NJEIP-së

1. Pa cenuar kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm, shoqëria audituese që kryen auditimin ligjor të një NJEIP-je, ka për detyrë t'u raportojë menjëherë, autoriteteve kompetente që mbikëqyrin atë NJEIP dhe BMP, çdo informacion në lidhje me atë NJEIP, për të cilin ka marrë dijeni gjatë kryerjes së atij auditimi ligjor dhe që mund të sjellë:

a) shkelje të konsiderueshme të ligjeve, rregulloreve ose dispozitave administrative të cilat përcaktojnë kushtet që rregullojnë autorizimin ose që rregullojnë në mënyrë specifike kryerjen e objektit të aktivitetit të njësisë ekonomike me interes publik në fjalë;



b) një kërcënim serioz ose dyshim në lidhje me funksionimin e vazhdueshëm të NJEIP-së;

c) një refuzim për të dhënë një opinion auditimi mbi pasqyrat financiare ose dhënien e një opinionit kundër ose të kualifikuar.

Shoqëritë audituese kanë gjithashtu për detyrë të raportojnë çdo informacion të përmendur në shkronjat “a”, “b” ose “c” për të cilin ato marrin dijeni gjatë kryerjes së auditimit ligjor të një njësie ekonomike që ka lidhje të ngushta me NJEIP-në për të cilën po kryejnë auditimin ligjor. Për qëllimet e këtij neni “lidhje të ngushta” do të nënkuptojë një situatë në të cilën dy ose më shumë individë ose persona juridikë janë të lidhur në një nga mënyrat e mëposhtme: a) pjesëmarrja në formën e pronësisë, drejtpërdrejt ose me anë të kontrollit, të 20% ose më shumë të të drejtës së votimit ose pjesëmarrjes në kapitalin e një njësie ekonomike; b) kontrolli; c) një lidhje e përhershme e të dyjave ose të gjithëve me të njëjtin person të tretë nëpërmjet një marrëdhënie kontrolli;

2. Dhënia në mirëbesim e çdo informacioni të përmendur në pikën 1, nga shoqëria audituese tek autoriteti kompetent mbikëqyrës i NJEIP-së, nuk do të përbëjë shkelje të ndonjë kufizimi kontraktual ose ligjor për dhënien e informacionit.

3. Shoqëritë audituese ose audituesit ligjorë që kryejnë auditimin ligjor të njësisë ekonomike të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, pika 23, e nenit 2 të ligjit të auditimit, do të komunikojnë zyrtarisht me autoritetet mbikëqyrëse përkatëse. Përgjegjësia për përmbushjen e këtij detyrimi është te palët e përfshira.

4. BMP-ja dhe autoritetet mbikëqyrëse të NJEIP-së të cituara në pikën 3 të këtij neni, do të organizojnë të paktën një herë në vit, një takim me shoqëritë audituese ose audituesit ligjorë, që kryejnë auditimin ligjor të këtyre NJEIP-ve, për të informuar autoritetet mbikëqyrëse për zhvillimet sektoriale ose të rëndësishme në ato NJEIP.

KREU VI

MBIKËQYRJA E AUDITUESVE LIGJORË DHE SHOQËRIVE AUDITUESE

Neni 32

Kompetencat e BMP-së

1. Pa cenuar zbatimin e neneve 38 dhe 39 të ligjit për auditimin, në kryerjen e detyrave dhe

funksioneve të veta, BMP-ja nuk mund të ndërhyjë në përmbajtjen e raporteve të auditimit.

2. BMP-ja ka të gjitha kompetencat mbikëqyrëse dhe investiguese që janë të nevojshme për kontrollin e ushtrimit të funksioneve sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi, ku përfshihen, të paktën, kompetenca, për:

a) aksesin në të dhënat, informacionin dhe dokumentacionin, që lidhen me auditimin ligjor dhe, ku është e zbatueshme me dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, ose dokumente të tjera të mbajtura nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese në çdo formë të mundshme për ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të veta mbikëqyrëse, si edhe të marrë apo t'i dërgohet kopja përkatëse;

b) të marrë informacion në lidhje me auditimin ligjor nga çdo person;

c) kryerjen e kontrolleve në vend pranë audituesve ligjorë ose shoqërive audituese;

ç) të referuar çështje për ndjekje penale;

d) të kërkuar nga ekspertët kryerjen e verifikimeve ose investigimeve të specializuara;

dh) marrjen e masave disiplinore të përmendura në nenin 55 të ligjit për auditimin dhe rregullores për procedurat e investigimit dhe marrjes së masave disiplinore.

3. BMP-ja ushtron kompetencat e përcaktuara në këtë nen vetëm ndaj subjekteve të mëposhtme:

a) shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë të angazhuar prej tyre që kryejnë auditimin ligjor të NJEIP-së dhe;

b) individët e përfshirë në aktivitetet e shoqërive audituese dhe audituesve ligjorë që kryejnë auditimin ligjor të NJEIP-ve dhe Jo-NJEIP-ve;

c) NJEIP-të e audituara, filialet/degët e tyre, dhe palët e treta të lidhura me to;

ç) palët e treta, të cilat janë kontraktuar për kryerjen funksioneve apo aktiviteteve të caktuara, nga shoqëritë audituese që kryejnë auditimin ligjor të NJEIP-së; dhe

d) persona të lidhur në një mënyrë tjetër me shoqëritë audituese dhe audituesit ligjorë të angazhuar prej tyre që kryejnë auditimin ligjor të NJEIP-së.

4. BMP-ja ushtron kompetencat mbikëqyrëse dhe investiguese në cilëndo nga format e mëposhtme:

a) drejtpërdrejtë;

b) në bashkëpunim me autoritete të tjera;



c) me anë të një kërkesë drejtuar autoriteteve gjyqësore kompetente.

Këto kompetenca do të ushtrohen në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Neni 33

Kompetencat e BMP-së në lidhje me bashkëpunimin me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të huaja

1. Me kërkesë të autoriteteve kompetente të një vendi të huaj, BMP-ja mund të vërë në dispozicion dokumentacionin e auditimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, bazuar në parimin e reciprocitetit, nëse:

a) ky dokumentacion ka lidhje me auditimin e shoqërive që kanë emetuar letra me vlerë në një shtet të huaj ose që janë pjesë e një grupi që harton pasqyra financiare të detyrueshme të konsoliduara në një shtet të huaj;

b) autoritetet kompetente të shtetit të huaj në fjalë plotësojnë kërkesat e përputhshmërisë të përcaktuara nga kuadri ligjor vendas;

c) BMP-ja ka lidhur marrëveshje me autoritetet kompetente të vendit të huaj bazuar në parimin e reciprocitetit;

ç) transferimi i të dhënave personale në një vend të huaj bëhet në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.

2. Marrëveshja e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të përfshijë:

a) detyrimin për të shpjeguar qëllimin e kërkesës në lidhje me dokumentacionin e auditimit;

b) detyrimin për të mbrojtur të dhënat konfidenciale për personat që janë ose kanë qenë të punësuar pranë autoriteteve kompetente të shtetit të huaj;

c) kërkesën që autoritetet kompetente të shtetit të huaj të përdorin dokumentacionin e auditimit vetëm për qëllime të kryerjes së mbikëqyrjes publike, sigurimit të cilësisë dhe investigimeve të krahasueshme me kompetencat e BMP-së.

3. BMP-ja ka të drejtë të refuzojë kërkesat e autoriteteve kompetente të vendeve të huaja lidhur me dokumentacionin e auditimit në rastet kur:

a) dhënia e këtyre shkresave ose dokumenteve të punës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë;

b) në Republikën e Shqipërisë ka nisur procedimi gjyqësor për të njëjtat vepra dhe ndaj të njëjtëve persona.

Neni 34

Sistemet e dhënies së sigurisë për cilësi

1. Sistemi për sigurimin e cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit. Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin:

a) sigurimin e cilësisë, që organizohet brenda audituesit ligjor ose shoqërisë audituese dhe është objekt i mbikëqyrjes publike;

b) sigurimin e cilësisë, që organizohet nga BMP-ja. BMP-ja mund të delegojë tek organizata profesionale e audituesve ligjorë kryerjen e kontrollit për sigurimin e cilësisë së njësisë ekonomike, që nuk janë me interes publik. Kur BMP-ja i delegon organizatës këtë detyrë, e mbikëqyr këtë proces dhe mund të rimarrë kompetencat e deleguara, kur e vlerëson të nevojshme, rast pas rasti.

2. Sistemi i sigurimit të cilësisë, që organizohet nga BMP-ja, duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) sistemi për sigurimin e cilësisë duhet të organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë dhe nga shoqëritë audituese;

b) financimi për sistemin e sigurimit të cilësisë duhet të jetë i sigurt dhe i lirë nga çdo ndikim i mundshëm dhe i papërshtatshëm nga audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese;

c) sistemi për sigurimin e cilësisë duhet të mbështetet në burime dhe në kapacitete të mjaftueshme;

ç) individët që kryejnë kontrollin e sigurimit të cilësisë duhet të kenë arsimin përkatës profesional dhe përvojën e duhur në auditimin ligjor, raportimin financiar dhe, ku është e zbatueshme, në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë apo shërbime të lidhura me të, të kombinuar me trajnime të posaçme për rishikimin e cilësisë në lidhje me auditimin ligjor.

3. Sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë, që kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nëpërmjet delegimit, organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë apo shoqëritë e auditimit, të cilat kontrollohen.

4. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, që kryejnë auditime ligjore të njësisë ekonomike me



interes publik, si dhe të njëjstëve ekonomike që nuk janë me interes publik, janë objekt i kontrollit të cilësisë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike apo nga organizata profesionale e audituesve ligjorë në rastet kur kryerja e kontrollit të cilësisë i delegohet kësaj të fundit.

Neni 35

Kontrolli për sigurimin e cilësisë

1. Për qëllime të këtij neni:

a) “kontroll” do të thotë kontrole të sigurimit të cilësisë së audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat drejtohen nga një inspektor;

b) “inspektor” nënkupton një kontrollues që plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni dhe që është i punësuar ose i kontraktuar në formë të tjera nga BMP-ja;

c) “ekspert” do të thotë një individ i cili ka ekspertizë specifike në tregjet financiare, raportimin financiar, auditimin ose fusha të tjera të rëndësishme për kontrollin, duke përfshirë audituesit ligjorë.

2. BMP-ja ngre një sistem efektiv të kontrollit të sigurimit të cilësisë së auditimit ligjor dhe cakton burimet e nevojshme për sistemin e sigurimit të cilësisë.

3. BMP-ja do të kryejë kontrole të sigurimit të cilësisë së shoqërive audituese që kryejnë auditime ligjore mbi bazën e një analize të rrezikut dhe:

a) në rastin e shoqërive audituese që kryejnë auditime ligjore të NJEIP-së të paktën çdo tre vjet; dhe

b) në raste të tjera nga ato të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike, dhe, ku është e zbatueshme për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë, të paktën një herë në gjashtë vjet.

4. BMP-ja organizon sistemin e sigurimit të cilësisë në mënyrë të pavarur nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të kontrolluar. BMP-ja do të sigurojë që janë vendosur politikat dhe procedurat e duhura në lidhje me pavarësinë dhe objektivitetin e inspektorëve dhe ekspertëve të angazhuar në kontrollin e sigurimit të cilësisë.

5. Inspektorët e angazhuar nga BMP-ja duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të kenë jo më pak se 7 (shtatë) vjet përvojë pune në fushën e auditimit

ligjor e të raportimit financiar dhe në raportimin e qëndrueshmërisë, si dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë apo shërbime të tjera të lidhura të qëndrueshmërisë, kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së cilësisë, kur kjo e fundit është e zbatueshme;

b) të mos jetë auditues ligjor praktikues ose i punësuar ose i lidhur në formë tjetër me një auditues ligjor ose shoqëri audituese;

c) nuk do të kryejë kontroll për sigurimin e cilësisë, të një auditues ligjor ose shoqëri audituese, derisa të kenë kaluar të paktën 3 (tre) vjet që kur ai individ ka përfunduar marrëdhënien si ortak ose punonjës i atij audituesi ligjor ose shoqërie audituese ose çdo formë tjetër lidhjeje me atë auditues ligjor ose shoqëri audituese;

ç) të deklarojnë se nuk ka konflikt interesi ndërmjet tyre dhe audituesit ligjor dhe shoqërisë audituese që do të kontrollohet.

Përveç shkronjës “b”, të pikës 1, BMP-ja mund të kontraktojë ekspertë për kryerjen e kontroleve specifike kur numri i inspektorëve brenda autoritetit është i pamjaftueshëm. BMP-ja mund të asistohet gjithashtu nga ekspertë kur kjo është thelbësore për kryerjen e duhur të një kontrolli. Në raste të tilla, BMP-ja dhe ekspertët do të respektojnë kërkesat e kësaj pike. Ekspertët nuk duhet të përfshihen në qeverisjen e, ose të punësohen ose të kontraktohen ndryshe nga shoqatat dhe organizatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, por mund të jenë anëtarë të këtyre shoqatave apo organizatave.

6. Objekti i kontroleve duhet të mbulojë të paktën:

a) një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë në zbatim nga shoqëria audituese ose audituesi ligjor;

b) një testim të përshtatshëm për pajtueshmërinë e procedurave dhe kontrollin e dosjeve të angazhimit të auditimit, për të verifikuar efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë;

c) në kuadrin e gjetjeve të kontrollit sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, një vlerësim të përmbajtjes së raportit vjetor më të fundit të transparencës të publikuar nga një shoqëri audituese ose audituesi ligjor.

7. Kontrolli duhet të mbulojë të paktën politikat dhe procedurat e mëposhtme të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë audituese ose të audituesit ligjor, për:



a) pajtueshmërinë e shoqërisë audituese ose audituesit ligjor me standardet ndërkombëtare të zbatueshme të auditimit dhe të menaxhimit të cilësisë, si dhe kërkesat mbi etikën dhe pavarësinë, dhe, kur është e zbatueshme, me standardet e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, sipas përcaktimeve të ligjit për auditimin dhe kësaj rregullore;

b) sasinë dhe cilësinë e burimeve të përdorura, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat e edukimit të vazhdueshëm profesional;

c) pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 36 të ligjit për auditimin, nenit 14 dhe nenit 24 të kësaj rregulloreje për tarifat e zbatuara të auditimit dhe, ku është e zbatueshme, tarifat për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

Për qëllime të kontrollit të pajtueshmërisë, dosjet e angazhimit të auditimit do të zgjidhen në bazë të një analize të rrezikut të dështimit për të kryer një auditim ligjor në mënyrë të përshtatshme.

BMP-ja gjithashtu do të kontrollojë periodikisht metodologjitë e auditimit, të përdorura nga shoqëritë audituese për të kryer auditimet ligjore.

8. BMP-ja vendos një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve në raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë. Kjo periudhë nuk duhet të kalojë 12 muaj në rastin e rekomandimeve për sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë audituese.

9. Nëse rekomandimet dhe afatet e caktuara, e parashikuara në pikën 8 të këtij neni, nuk ndiqen për zbatim, audituesi ligjor ose shoqëria audituese do të jetë subjekt i masave disiplinore të përcaktuara në nenin 55 të ligjit për auditimin dhe rregulloren për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

10. Afati i përfundimit të procedurave të kontrollit të cilësisë është deri në 6 muaj nga data e njohfimit për fillimin e procedurave të kontrollit.

11. Afati, sipas pikës 10 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim të BMP-së jo më shumë se 6 muaj në rast se kërkohej procedura të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.

12. BMP-ja do të kryejë kontrole të sigurimit të cilësisë së audituesve ligjorë, që kryejnë auditime ligjore mbi bazën e një analize të riskut dhe:

a) në rastin e audituesve ligjorë, që kryejnë auditime ligjore të njëjësive ekonomike me interes publik të paktën një herë në 3 (tre) vjet; dhe

b) në raste të tjera nga ato të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike, dhe, ku është e zbatueshme për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë, të paktën një herë në gjashtë vjet.

13. BMP-ja duhet të jetë transparent dhe të publikojë të paktën:

a) raporte vjetore të aktiviteteve të kryera në zbatim të kësaj rregulloreje;

b) programet vjetore të punës të realizuara në lidhje me detyrat e realizuara në zbatim të kësaj rregulloreje;

c) rezultatet e përgjithshme të sistemit të sigurimit të cilësisë në baza vjetore, ku përfshihet informacioni mbi rekomandimet e nxjerra, ndjekjen e rekomandimeve dhe llojin e masave të marra nga BMP-ja. Ai do të përfshijë gjithashtu informacion sasior dhe informacione të tjera kyçe të performancës mbi burimet financiare dhe personelin, si dhe efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë;

ç) informacionin e përmbledhur mbi gjetjet dhe përfundimet e kontroleve të përmendura në pikën 3, të nenit 40, të kësaj rregulloreje.

Neni 36

Mënyrat e realizimit të kontrollit të cilësisë

5. BMP-ja kryen kontrollin e sigurimit të cilësisë nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

a) kontroll me vizitë në vendin ku ushtron aktivitetin audituesi ligjor ose shoqëria audituese;

b) kontroll në distancë nga zyra e BMP-së;

c) kontroll i kombinuar me vizitë në vendin ku ushtron aktivitetin audituesi ligjor ose shoqëria audituese dhe në distancë nga zyrat e BMP-së.

6. Kontrolli i sigurimit të cilësisë mund të jetë:

a) kontroll i plotë i sigurimit të cilësisë;

b) Kontroll tematik i sigurimit të cilësisë së audituesit ligjor ose shoqërisë audituese.

Neni 37

Dorëzimi vjetor i informacionit

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të regjistruara në regjistrin publik ose që kanë qenë të regjistruara në regjistrin publik përgjatë periudhës së raportimit, duhet të dorëzojnë pranë BMP-së brenda datës 30 janar të çdo viti pasardhës, Raportimin e angazhimeve me informacionin në



lidhje me shërbimet e kryera në periudhën e raportimit, si më poshtë:

- a) të gjitha angazhimet e auditimit ligjor;
- b) të gjitha angazhimet e tjera të dhënies së sigurisë, shërbimet e kontabilitetit shërbimet e rishikimit dhe shërbimet e tjera profesionale;
- c) honorarët e faturuar për shërbimet e përcaktuara në shkronjën “a” dhe “b” më sipër;
- ç) të ardhurat nga shërbimet joaudituese të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 2 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, të cilat kërkohen nga legjislacioni në fuqi; dhe
- d) të ardhurat nga shërbimet joaudituese të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 2 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, të cilat nuk kërkohen nga legjislacioni në fuqi.

2. Format i raportimit të angazhimeve do të përmbajë të gjitha të dhënat, që kërkohen nga BMP-ja, për mënyrën sesi audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese i përmbushin detyrimet e tyre, gjatë auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, në kuadër të kontrollit të sigurimit të cilësisë.

3. Në rast se audituesi ligjor ose shoqëria audituese refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për mënyrën sesi i përmbushin detyrimet e tyre gjatë auditimit ligjor dhe raportimin e qëndrueshmërisë do të jenë subjekt i masave disiplinore të përcaktuara në nenin 55 të ligjit për auditimin dhe në rregulloren për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

Neni 38

Procesi i përzgjedhjes

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, të angazhuar në auditimin e njësive ekonomike me interes publik dhe të njësive të tjera jo me interes publik, renditen sipas nivelit të riskut, të përcaktuar mbi bazën e analizës së vlerësimit të riskut.

2. Vlerësimi i nivelit të riskut është i kategorizuar në tri nivele, i ulët, i mesëm, i lartë për faktorët e riskut si më poshtë:

a) Faktorët e vlerësimit të riskut të angazhimit të auditimit:

i. industria: banka, institucione jo banka të licencuara nga Banka Shqipërisë, shoqëri Financiare të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shoqëri prodhimi, tregtimi, shërbimi, të tjera;

ii. klasifikimi i njësive ekonomike me interes publik, sipas pikës 23, të nenit 2 të ligjit për auditimin dhe vendimit të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre;

iii. forma juridike e njësive ekonomike;

iv. lloji i opinionit: opinion pa rezervë, opinion me rezervë, një opinion kundër ose një refuzim për të dhënë opinion;

v. çështje të identifikuar nga kontrollet e mëparshme të sigurimit të cilësisë lidhur me auditimin ligjor dhe raportimin financiar dhe, ku është e zbatueshme dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe raportin e qëndrueshmërisë;

vi. shkelje ose sjellje të papajtueshme të identifikuar nga procesi i investigimit;

vii. informacione të siguruar nga burime të tjera të hapura.

b) Faktorët e vlerësimit të riskut për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e audituese:

i. treguesit e kapaciteteve, burimeve dhe angazhimeve të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese: Pjesë e një rrjeti, numri i audituesve ligjorë të regjistruar dhe, ku është zbatueshme numri i audituesve ligjorë të regjistruar për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, numri i personelit të angazhuar në auditimin ligjor dhe, ku është e zbatueshme në dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, numri i angazhimeve të auditimit të njësive ekonomike me interes publik, numri i orëve të auditimit të njësive ekonomike me interes publik, tarifa mesatare e auditimit të njësive ekonomike me interes publik, numri i angazhimeve të auditimit të njësive ekonomike jo me interes publik, numri i orëve të auditimit të njësive ekonomike jo me interes publik, tarifa mesatare e auditimit të njësive ekonomike jo me interes publik;

ii. organizimi dhe funksionimi i sistemit për sigurimin e cilësisë së audituesit ligjor dhe shoqërisë audituese: vlerësimet e mëparshme nga kontrolli i sigurimit të cilësisë, pajtueshmëria me kërkesat e standardeve të menaxhimit të cilësisë.



Neni 39

Kryerja e kontrollit të sigurimit të cilësisë

1. Njoftimi për kontrollin e sigurimit të cilësisë bëhet në formë shkresore, ku përfshihet, por pa u kufizuar në, objektin dhe programin e kontrollit, periudhën që mbulon kontrolli, listën e dokumenteve dhe afatin për dorëzimin e tyre, për të mundësuar përgatitjen e inspektorëve për kryerjen e kontrollit. Komunikimi përgjatë kontrollit realizohet në formë shkresore dhe/ose elektronike në adresat e zyrës dhe/ose të postës elektronike të publikuara në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të audituese.

2. Procesi i kontrollit të sigurimit të cilësisë realizohet kryesisht sipas hapave në vijim:

d) Takim me shoqërinë audituese/audituesin ligjor subjekt kontrolli, i cili ka qëllim prezantues dhe realizohet me audituesin ligjor dhe/ose përfaqësuesin e shoqërisë audituese, personelin kryesor të audituesit ligjor/shoqërisë audituese. Inspektorët në këtë takim konfirmojnë aksesin në informacion, dokumentacion, sistemet e brendshme në zbatim për kryerjen dhe dokumentimin e shërbimeve profesionale, sistemeve të menaxhimit të cilësisë etj., për realizimin e objektit të kontrollit të sigurimit të cilësisë.

e) Kontrollin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë në zbatim nga shoqëria audituese ose audituesi ligjor dhe pajtueshmëria me standardet e menaxhimit të cilësisë;

f) Kontrollin e dosjeve të anagzhimit të auditimit për testimin e përshtatshëmërisë dhe pajtueshmërisë së procedurave e shoqërisë audituese ose audituesit ligjor me standardet ndërkombëtare të zbatueshme të auditimit dhe të menaxhimit të cilësisë, si dhe kërkesat mbi etikën dhe pavarësinë, dhe, kur është e zbatueshme, me standardet e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, sipas përcaktimeve të ligjit për auditimin dhe kësaj rregulloreje;

ç) Takimin përmbyllës, për diskutimin e mangësive të identifikuara, realizohet me ortakun kryesor të auditimit, ekipin e auditimit dhe/ose personelin përgjegjës përfaqësues të shoqërisë audituese/audituesin ligjor, përgjigjet që do të sigurohen për zbatimin e rekomandimeve për adresimin e mangësive të identifikuara gjatë kontrollit, si edhe afatin për zbatimin e tyre. Ky takim dhe diskutimet e realizuara do të

dokumentohen në formë të regjistruar në pajisjen e regjistrimit të BMP-së.

Neni 40

Raporti i kontrollit për sigurimin e cilësisë

1. Inspektori/ët harton/jnë draftaportin e kontrollit të cilësisë sipas formularit D për Raportin e Kontrollit dhe shtojcës D.1 për Planin e Veprimit, si pjesë përbërëse e draftaportit të kontrollit për sigurimin e cilësisë.

2. Draftaporti i kontrollit i dërgohet audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit të kontrolluar, i/e cili/a brenda 10 (dhjetë) ditë pune, nga marrja e tij duhet të paraqesë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve për adresimin e mangësive të identifikuara gjatë kontrollit, si edhe afatin për zbatimin e tyre.

3. Plani i veprimit do të jetë objekt diskutimi në takimin përmbyllës, me qëllim sigurimin e përgjigjeve për zbatimin e rekomandimeve për adresimin e gjetjeve dhe mangësive të identifikuara gjatë kontrollit, duke përfshirë edhe gjetjet dhe konkluzionet mbi raportin e transparencës të përcaktuar në nenin 45 të ligjit për auditimin, si edhe afatin për zbatimin e tyre.

4. Në rast se audituesi ligjor ose shoqëria audituese për shkaqe të paarsyeshme nuk paraqet, planin e veprimit sipas pikës 2 të këtij neni apo refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë nga BMP-ja, do t'u nënshtrohet masave disiplinore të parashikuara në nenin 55 të ligjit për auditimin dhe rregullores për investigimin dhe procedurat e marrjes së masave disiplinore.

5. Raporti i përfundimtar kontrollit të sigurimit të cilësisë do të përfshijë:

a) Vlerësimin dhe mangësitë e konstatuara gjatë kontrollit, të:

- pajtueshmërisë me Kodin e Etikës;
- pajtueshmërisë me standardin/et e menaxhimit të cilësisë;
- pajtueshmërisë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit; dhe
- pajtueshmërisë me kuadrin ligjor për auditimin dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

b) Mangësitë e konstatuara nga kontrollet e mëparshme dhe akoma të pakorrigjuara nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese.



c) Komentet e bëra nga shoqëria e auditimit/audituesi ligjor i kontrolluar në lidhje me mangësitë.

ç) Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve për adresimin e mangësive të identifikuar gjatë kontrollit, si edhe afatin për zbatimin e tyre, i cili duhet të ketë këto elemente:

- identifikim të veprimit për zbatimin e rekomandimeve;

- caktimin e personit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve;

- afatin për zbatimin e rekomandimeve, por jo më shumë se 12 muaj nga data e raportit përfundimtar të kontrollit, në rastin e rekomandimeve për sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë.

6. Raporti përfundimtar i kontrollit do të hartohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së planit të veprimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

7. Raporti përfundimtar i kontrollit të sigurimit të cilësisë dhe vendimin për vlerësimin të miratuar nga BMP-ja do të dërgohet brenda 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e hartimit të:

- a) audituesi ligjor/ partneri/ partnerët e shoqërisë së kontrolluar;

- b) të tjerë në përputhje me ligjin për auditimin.

Neni 41

Vlerësimi i raportit përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë

1. Vlerësimi për raportin përfundimtar të kontrollit të sigurimit të cilësisë kategorizohet në tri nivele, bazuar në kontrollin e dosjeve të angazhimit:

- i. “Kënaqshëm”;

- ii. “Pjesërisht kënaqshëm”;

- iii. “Jokënaqshëm”.

2. Inspektori/ët, i/të angazhuar në kontrollin e sigurimit të cilësisë në audituesin ligjor ose shoqërinë audituese të kontrolluar, i propozojnë BMP-së vlerësimin bazuar në metodologjinë e brendshme për vlerësimin, të miratuar nga BMP-ja.

3. Në rast të shkeljeve ose sjelljeve të papajtueshme të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese të konstatuara në raportin përfundimtar të kontrollit të cilësisë, propozimi për vlerësimin do të përmbajë edhe masën disiplinore në përputhje me nenin 55 të ligjit për auditimin dhe rregullores për

investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

Neni 42

Shkaqet e ndërprerjes së kontrollit

1. Procesi i kontrollit të sigurimit të cilësisë mund të ndërpritet, në rastet kur:

- a) inspektorët e kontrollit identifikojnë rrethana të përcaktuara në aktet nënligjore të miratuara nga BMP-ja;

- b) audituesi ligjor ose shoqëria audituese refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacionet për realizimin e qëllimit të kontrollit të sigurimit të cilësisë.

2. Pezullimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarisë apo fshirja e përkohshme nga regjistri publik i audituesit ligjor/shoqëria audituese, pas marrjes së njoftimit për kontrollin e sigurimit të cilësisë, nuk përbën shkak për mos fillimin apo ndërprerjen e realizimit të këtij kontrollit.

3. Në të gjitha rastet kur audituesi ligjor/shoqëria audituese e përzgjedhur për realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë refuzon, ndërpret, pengon, nuk bashkëpunon dhe/ose nuk siguron informacion për realizimin e qëllimit të kontrollit, do të jenë subjekt i masave disiplinore të përcaktuara në nenin 55 të ligjit për auditimin, rregulloren për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

Neni 43

Kontrollet pasuese

1. Shoqëritë audituese ose audituesit ligjorë të kontrolluar janë objekt i kontrolleve pasuese nga BMP-ja.

2. Kontrolli pasues ka për qëllim verifikimin e zbatimit të rekomandimeve dhe afateve përkatëse sipas planit të veprimit të raportit përfundimtar të kontrollit të cilësisë.

3. Në bazë të rezultatit të këtij kontrolli, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, BMP-ja mund të shqyrtojë dhe vendosë mbi rishikimin e vlerësimit, sipas pikës 1 të nenit 41 të kësaj rregulloreje, të raportit të kontrollit të sigurimit të cilësisë, për subjektet në fjalë.

Neni 44

Delegimi i detyrave

1. BMP-ja nuk mund të delegojë kompetencat që lidhen me:



a) kontrollet që lidhen me sistemin e sigurimit të cilësisë të NJEIP-së; dhe

b) vendosjen e masave disiplinore që lidhen me kontrollet e sigurimit të cilësisë dhe/ose procedurave të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore.

2. Çdo delegim i kompetencave në autoritete ose organe të tjera do të bëhet me vendim të BMP-së. Delegimi duhet të specifikojë kompetencat e deleguara dhe kushtet në të cilat ato do të kryhen. Kur BMP-ja u delegon kompetenca autoriteteve ose organeve të tjera, ka të drejtën t'i rimarrë këto kompetenca rast pas rasti.

3. Përgjegjësia përfundimtare për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për auditimin dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, i takon BMP-së.

Neni 45

Dispozita kalimtare

1. Kontrolli i sigurimit të cilësisë për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë do të zbatohet për periudhat e raportimit të mbyllura më 31.12.2028.

2. Kontrollet e sigurimit të cilësisë, të filluara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do t'u nënshtrohen dispozitave të rregullores nr. 7/2018 dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga BMP-ja në zbatim.

3. Detyrimi për dhënien e informacionit vjetor sipas dispozitave të kësaj rregulloreje do të zbatohet për herë të parë më 30 janar 2026.

VENDIM

Nr. 57, datë 1.10.2025

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE (TË TËRTHORTË) NË KAPITALIN AKSIONAR TË “BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE” SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “g”, të pikës 1, të nenit 24 dhe nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave

dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të tërthortë) në masën 23.68% të shoqërisë “MOSCOPELE IP” L.L.C, SHBA, në kapitalin aksionar të “Bankës Amerikane të Investimeve” sh.a.

2. Ngarkohet Banka Amerikane e Investimeve të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e transaksionit të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Gent Sejko**

KËRKESË

Shtetasi Safet Mustafaraj kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, shpalljen të vdekur të shtetasit Zenel Mustafaraj, me atësi Muço dhe amësi Mynevere, i datëlindjes 1.6.1964.

**KËRKUES
Safet Mustafaraj**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë

